

BIBLIOTEKA

81432

1998

BIBLIOTEKA E NIVE DASHURIE

*L'Amorosa e
nfe
dashurie*

IRGJIL MUÇI

Novelë

85H-32

M 98

2670 / 34
225

68

85

68

170

(

Virgjil Muçi

ZHVARROSJA

E NJE

DASHURIE



Novelë

Shtëpia Botuese
«Naim Frashëri»

13 tetor, ora 8.35

— Siç më kishte porositur në darkë, në orën gjashtë e gjysmë e mora në telefon që të zgjohej, por Diana, centralistja, më tha se në atë dhomë nuk përgjigjej njeri. I thashë të mos e shkëpuste sinjalin, duke menduar se plaka mund ta kishte gjumin të rëndë, por pas dy-ttri minutash Diana ma preu shkurt: s'ka njeri dhe pikë. Atëherë lashë Kujtimin, ashensoristin, në sportel se mos zbriste ndonjë klient për të lënë çelësin dhe u ngjita me vrap deri në dhomën e saj, treqind e katra. Trokita, por as gëk, as mëk nga brenda. Trokita përsëri, kuptohet, këtë herë pak më fort, megjithatë hiçgjë. Vura veshin te dera, por veç frymëmarrjes sime të shpeshtuar nga vrapit s'dëgjova gjë tjetër. Kur sesi më shkoi bërryli te doreza, t'ju them të drejtën padashje, dhe dera u hap. Ngela një çast në mëdyshje: të hyja apo jo? Se ç'më cyti diçka ndjellakeqe dhe kjo ma prishi mendjen; të dalë ku të dalë, thashë me vete. Plakën e gjeta shtrirë,

në anë të krevatit, me një rën këmbë përtokë, sikur po bëhej gati të ngrihej, me sytë e hapur, të çakërritur, aq sa s'merrej vesh nga shikonin, ndërsa nga cepi i gojës së çapëlyer, si t'i ngërdheshej njeriu, i kish dalë një pizgë gjaku, që qe mpiksuar. E kuptova menjëherë që kishte vdekur. T'ju them të drejtën, në fillim e humba toruan, sepse ishte hera e parë që më rastiste të ngelesha tek e tek me një të vdekur, por e mora shpejt veten. Ndërkohë më ra ndër mend se nuk duhej prekur asgjë me dorë...

(Sportelisti pa nga hetuesi)

— ...E di kaq gjë, se kam parë nëpër filma... I zbrita me vrap shkallët, ngaqë ashensori se nga kishte ngecur, i pushtuar nga një alarm marramendës, se s'ishte gjë e vogël. Erdha në vete vetëm kur pashë Kujtimin, ashensoristin. I thashë me dy fjalë ç'kishte ndodhur dhe e lashë të ruante dhomën se mos na dilte ndonjë problem më pas, ku i dihej. Pastaj ju mora juve në telefon, shoku drejtor, dhe...

(Sportelisti ngriti supet)

— ...kjo është gjithë ç'kisha për të thënë.

— Po, po, — tha drejtori i hotelit, duke tundur kokën.

Sportelisti lëpiu buzët e përthara me gjuhën që i qe rreshkur dhe ia nguli sytë termosit, mbi tryezën e drejtorit. E tundonte veten më kot, sepse nuk ishte nga ata tipa moskokëçarës që e lypin diçka pa u shtëll-disur,

— Jeni i sigurt? — e pyeti funksionari i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Hija e një reje frike u nder në fytyrën e sportelistit dhe pak nga pak u tkurr, derisa prej saj ngelën dy njollëza të errëta te bebëzat e syve.

— Për çfarë? — tha sportelisti zëlëmekur.

— Që ora ka qenë fiks, gjashtë e tridhjetë minuta?

— As që e diskutoj, më kujtohet shumë mirë, së pak më parë më kishte pyetur Kujtimi, ashensoristi i turnit tim.

— Kjo ka rëndësi primare, — tha funksionari, duke i mëshuar fjalës së fundit dhe u kthye nga hetuesi, për të parë përshtypjen që duhej të kishte bërë vërejtja që ai vetë e konsideronte të hollë, madje mund të thoshe edhe profesionale.

Mos kujtoni se jemi profanë dhe nuk marrim erë nga ato punët tuaja, thoshin sytë e tij, ose, të paktën, ashtu iu duk hetuesit.

Dhuntinë për të përçar mendimin nëpërmjet vështrimit funksionari besonte se e kishte kultivuar e përsosur në kohën kur kish qenë profesor (në të vërtetë i jashtëm) dhe jepte leksione në universitet.

Hetuesi po luante me tufëzën, e çelësave sikur të ishin tespihe.

Funksionari u kollit lehtë për t'i tërhequr vëmendjen (një tjetër zakon i mbetur nga shkolla) dhe vijoi të fliste:

— Për vetë faktin se, në raportin që do të përpilojmë ne si dikaster, një kopje e të cilit nëpërmjet kanaleve diplomatike do t'i përcillet ministrisë së jashtme të vendit, shtetësinë e të cilit ka turistja e vdekur, gjithçka duhet të paraqitet jashtëzakonisht saktë, sikur të ketë dalë nga një ordinator.

Funksionari bëri një pauzë.

Drejtori i hotelit rrëkëlleu nga termosi në një gotë të bardhë plastike një curril lëngu të kuqërremtë dhe e ktheu njëherazi.

Sportelisti u gëlltit dhe e ndoqi vështrimzhuritur, derisa tjetri e shkulloi gotën dhe ia rراسi termosit, si kapuç.

— Mjekët më kanë këshilluar të pi sa më shumë lëngje frutash, — tha ai, pa iu drejtuar njeriu.

Përkthyesi po pinte cigare dhe ndiqte me sy fjollat e tymit, të cilat, në çastin kur bashkoheshin me rrëkajën e rrezeve të diellit që hynin pjerrtazi prej grilave, ndërronin ngjyrë dhe bëheshin të kaltëreme, sikur me to të ndodhte një reaksion i vrullshëm kimik. Befas, pa ndryshuar pozicion, ai e shmangu vështrimin, pa shkarazi nga drejtori dhe nuk u habit aspak që provoi të njëjtën ndjesi që kishte provuar edhe herën e parë, kur qe takuar me atë njeri, gusha majmoke e të cilit varej sikur i depozitonte aty të gjitha ushqimet, për ti kapërdirë më nge, pak nga pak.

Hetuesi vazhdonte të merrej me tufëzën e

çelsave që tringëllinin e argaliseshin sikur gishtat e atij që i mbanin, i gudulisin paturpësisht.

— Le të shpresojmë që të ketë qenë vdekje e natyrshme, — tha funksionari, duke u orvatur të zhbironte ndonjë gjë mbrapa «maskës memece», siç e quajti me vete fytyrën e hetuesit. Thellë në shpirt dëshironte që ai djalosh të tregonte më tepër respekt për të, duke pasur parasysh faktin se vetëm ai ishte aty funksionar ministrie.

Drejtori i hotelit u ngrys. Fjala «vdekje» i ndikoi sakaq në sistemin nervor dhe e irritoi, i shtyrë jo dhe aq nga mendimi se kjo ngjarje mund ta cënonte sadopak reputacionin e hotelit, por ngaqë e kishte ende të freskët në kujtesë atë periudhë kohe kur pati kaluar një infarkt të miokardit, dhe ajo, vdekja, kishite qenë e pranishme për çdo ditë në jetën e tij, tok me mjekët, si një kronikane skrupuloze.

— Përndryshe një gjë e tillë (ai nuk e përdori fjalën «vrasje», e cila i tingëlloi në vetvete disi makabre) mund të jetë me pasoja serioze...

— S'është çudi të bëhet shkas që të shpërthejë lufta e tretë botërore, — i pëshpëriti për-kthyesi hetuesit.

— ...Duhet ta keni të qartë se këto punë janë jashtëzakonisht delikate. Duke pasur parasysh relatat midis dy shteteve, ecurinë e marrëdhënieve, sidomos vitet e fundit, dhe për më

tepër faktin që kemi të bëjmë me një vend, për mbarëvajtjen dhe miqësinë reciproke me të cilin shteti ynë ka qenë e është i interesuar, duhet të tregohemi prudentë.

Kishte qenë një dëshirë e fshehtë e kahe-rshme e funksionarit që, sa herë ndodhej në shoqëri, ndonjë nga të pranishmit ta pyeste për probleme të situatës ndërkombëtare.

— Sa vjeç ishte? — pyeti drejtori.

— Gjashtëdhjetë e ca, nuk më kujtohet me saktësi, — tha përkthyesi. — Megjithëse ngjante më e re, që e mbajtur.

— Kështu duken të huajat, — tha sporteli-sti. — Ndoshta ngaqë nuk vishen me të zeza, si plakat tona.

Por u pendua që hapi gojë, se pikasi në shikimin e funksionarit një qortim të heshtur.

Drejtori nxori nga xhepi i xhakëtës paketën e cigareve dhe ua zgjati të gjithëve sa ishin në zyrë. Veç më parë kishte bërë me mend një përlogaritje të shpejtë se sa cigare mund t'i kushtonte kjo mirësi. Për vete e vuri në buzë, po nuk e ndezi.

— Kam një jetë të tërë që merrem me hotelet, — tha drejtori. — Kam qenë fëmijë atëherë, dhjetë a njëmbëdhjetë vjeç, kur e nisa këtë punë si mbajtës bagazhesh, në një hotel që qe pronë e një shoqërie anonime italiane...

(Atij ia kishte ënda ta përmendte këtë gjë sidomos në sy të atyre me të cilët porsa ishte

njohur, sepse, siç i pëlqente të shprehej, «lartësitë vlerësohen nga baza».)

— ... Nuk është hera e parë që në një hotel ndodh një vdekje, kjo është më se e natyrshme...

(Dhe, për t'ua bërë të qartë të pranishmëve opinionin e tij për sa i takonte çështjes, e ndjeu të nevojshme të shtonte aty për aty:)

— ... këtu nuk ka asgjë në kundërshtim me ligjet e natyrës. Mund t'ju numëroja disa raste që më bien ndër mend tani. Sigurisht nuk mund të them që s'më bën përshtypje, pavarësisht nga fakti se personi që ndërroi jetë është një e huaj. Nuk e di pse, por çdo vdekje për ne të moshuarit...

(Ai pa nga funksionari, që bëri sikur nuk e vuri re.)

— ... ndjell njëfarë trishtimi, zë e zgjon kujtime të largëta pothuaj të harruara. Ja, për shembull, tymi i cigareve këtu në zyrë më ngjan si reja dehëse e temjanit që shpërndate prifti në kishë dikur. Ju jeni të rinj dhe s'ju ka qëlluar të shihni skena të tilla se vetëm atëherë do ta kuptonit se si makthi të injektohet dalëngadalë si narkotik e krijon një atmosferë mbytëse, që pak nga pak të asfikson. Nuk thotë më kot Marks: «Feja është opium për popullin.»

Drejtori nxori shaminë dhe përthau bulëzat e djersës në ballë. Kishte njëfarë hutimi e lodhjeje në lëvizjet e tij. Fillimisht kishte dashur të shprehte diçka tjetër dhe tani as vetë nuk arrinte ta kuptonte se si e kish humbur

fillin e mendimit dhe kishte kaluar në të tjera shina.

— E ç'hyn Marksi këtu? — i tha hetuesi përkthyesit, i cili ngriti supet.

Njëloj si në mbledhje, tha me vete sportelisti që vazhdonte të rrinte më këmbë, si një nxënës që e kanë nxjerrë para klasës ngaqë ka bërë faj. Po s'e lidhi një çikë të sotmen me të kaluarën dhe po nuk përmendi ndonjë citat nga të klasikëve, sikur s'ka pikë kuptimi për të ajo që thotë?

Hetuesi e prishi me ngut heshtjen që u krijua, si të druhej se mos drejtori fillonte sërish me kujtimet dhe funksionari me tonin e atij që e ndien për detyrë të të sqarojë (ndonëse pa ia kërkuar) rëndësinë e çështjes dhe të japë udhëzimet e duhura për çastin.

— Ju e patë kufomën? — e pyeti ai përkthyesin.

Tjetri, para se të përgjigjej heshti një grimë, ngaqë fjalët iu dukën të veshura me një ton zyrtar, të papranueshëm për shoqërinë që kishin me njëri-tjetrin.

— Po, — tha përkthyesi, — isha bashkë me përgjegjësën e grupit të turistëve. M'u duk diçka... shokante. Ndoshta kjo ndjesi m'u krijua ngaqë mbrëmë, kur u ndava me të, ajo ishte për bukuri, të paktën mua nuk m'u ankua për asgjë.

— Si ishin marrëdhëniet e plakës me turistët e tjerë të grupit?

— S'di si t'ju them, ose, më saktë, mund t'ju flas vetëm për atë që lundronte mbi sipërfaqe. Përshtypja ime është që ajo i shpërfillte bashkatdhetarët e vet, për të mos thënë i injoronte. Kështu që vetvetiu marrëdhëniet ishin të ftohta, distancuese. Megjithëse, për mendimin tim, këtu nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Në njëfarë mënyre, një grup turistësh shëmbëllen më tepër me ishujt e një arkipelagu, kup-tohet, ku banorët flasin të njëjtën gjuhë, sesa me truallin kompakt të një vendi të caktuar...

— Ka pasur konflikte në grup?

— Me sa di unë, jo.

— A ke vënë re ndonjë kontakt të turistës me të huaj të tjerë, e kam fjalën, jashtë grupit?

— Jo.

— Po me shqiptarë?

— Po pati mundësi, do doja të të përgjigjesha kur të mbetemi vetëm.

Pa qenë nevoja të kthente kokën, përkthyesi ndjeu ta brimonin si tyrjela, pa mëshirë, shikimet zhbiruese të drejtorit dhe funksionarit, të etur për të zbuluar të fshehtën e tij. Por për habinë e tyre, ajo që panë ishte gjëja më e thjeshtë dhe e papërfytyrueshme, aq sa i shastisi: një buzëqeshje pafajësie. Por kjo nuk e shpëtoi përthyesin, përkundrazi me veprimin që bëri, ai i ngjau atij tipit që i ka marrë furnela flakë dhe i çoroditur, në hutim e sipër, në vend që t'i hedhë ujë, i zbraz një bidon plot me vajguri.

Hetuesi e kundroi pa folur.

— Do t'ju sugjeroja, — tha funksionari, — që të porositen punonjësit e hotelit që ngjarjen e sotme, të mos e bëjnë objekt bisede në rrugë.

Vështrimi i tij paralajmërues shigjetoj sportelistin që s'e përballoi dot as një sekondë dhe uli kokën, si i zënë në faj e sipër.

— S'do mend — u hodh drejtori. — Besoj se është e vetëkuptueshme. — Në të vërtetë, sa po matej të thoshte pikërisht këtë gjë, kur tjetri ia rrëmbeu nga goja, ndaj s'i erdhi hiç mirë, po nuk e dha veten. — S'janë muhabetë këto për t'u bërë poshtë e përpjetë.

— Sa kohë mund të zgjatë shqyrtimi? — pyeti funksionari.

— Të presim se ç'do të thonë eksperti kriminalist dhe mjeku ligjor pas ekspertizës, — tha hetuesi. — Në fund të fundit, pothuajse gjithçka varet nga konkluzioni që do të arrijnë ata të dy.

— Nga përvoja e deritanishme, edhe në këtë rast s'besoj të ketë ndonjë gjë të jashtëzakonshme, — tha drejtori. — Për mendimin tim; plakës iu sos filli dhe vdiq.

Përveç sportelistit, që u mundua të tregoj sa më i zellshëm në gazin e tij, askush tjetër nuk e quajti të arsyeshme të bashkohej në kor me të qeshurën e drejtorit.

— Të shpresojmë, të shpresojmë, — tha funksionari, skeptik. — Përndryshe do të ketë një acarim të pashmangshëm të marrëdhënieve...

Përkthyesi pa njëherë nga hetuesi, pastaj

nga sportelisi (që bënte ç'bënte dhe i hidhte nga një sy vjedhurazi orës së dorës) me gazin që sa s'po i shpërthente me presion nga të gjitha vrimat e fytyrës. Pa ç'pa nxori shaminë dhe shfryu hundët. Veç harroi se e tradhtonin sytë e rrëmbushur nga lotët, që shkëlqenin tinëzisht.

— Më ngjan se ka ndodhur aty nga viti 1936 apo 37, s'më kujtohet me saktësi, nejse...

(Drejtori bëri një lëvizje me dorë, si për ta përforcuar atë që dita s'kishte dhe aq rëndësi.)

— ... Unë asokohe punoja në hotel «Pallas». Isha kamerieri më i ri dhe shërbeja nëpër dhoma. Rrogë s'më jepte pronari për punën. Ç'nxirrja ndonjë gjë nga bakshishet që më linin klientët, hiq këtu «taksën» që isha i detyruar t'i lija kryekamerierit, katandisej kokoshi një thelë. Në hotel, përveç klientëve që kalonin një natë ose dy dhe të nesërmen largoheshin, kishte edhe një kategori tjetër klientësh që ne, domethënë personeli i shërbimit, i quanim «kokoshët» ose «kokashkat», ngaqë i kishin paratë me thasë. Këta ishin klientë të përhershëm. Zakonisht prenotonin një apartament dhe e mbanin të zënë me muaj. Banonin apo nuk banonin aty, për pronarin s'kishte shumë rëndësi: atij i mjaftonte që pagesa bëhej në rregull. Lloj-lloj maskarallëqesh e fëlliqësirash më kanë parë sytë nëpër ato dhoma. Nejse, një nga këta «kokoshët» ishte edhe një oficer i gardës mbretë-

rore, mbaj mend kish gradën kapiten, një djalosh simpatik, trupgjatë, me mustaqet pis të zeza, allazogçe, siç qe moda atëherë. Më datën njëzet e pesë të çdo muaji vinte dhe banonte me të, vetëm pesë ditë, një zonjë e huaj, që me ç'më kishin zënë veshët nga thashethemet e sportelistëve, ishte italiane, gruaja e një bankieri. Ditën e gjashtë në mëngjes, para se të largohej, ajo nuk harronte të bënte pagesën me çek, për muajin pasardhës. Gjatë kohës që rrinin bashkë, pothuaj s'dilnin fare nga dhoma, veç për ndonjë nevojë të ngutshme, më tepër ai se ajo. Ishte në dhjetor hera e fundit kur ajo erdhi për ta takuar. Si gjithmonë e përpiktë, më njëzet e pesë. Por nuk ndenji si herët e tjera, veç se tri ditë, të katërtën në mëngjes mbledhi bagazhet, një qerre, dhe u largua me një zallamahi të paparë. Për çudinë e të gjithëve nuk e pagoi çekun për muajin tjetër dhe nuk i dha askujt bakshish. Dy ditë radhazi askush nga personeli nuk e pa kapitenin të dilte nga dhoma. Nuk porosiste asgjë tjetër, veçse shishe me verë dhe kova me akull, që ia lija para derës. Përveç kësaj, çdo pasdite në orën pesë ai e kishte zakon ta pinte në dhomë kafën të shoqëruar me një gotë liker. Më kujtohet si tani, ishte data tridhjetë dhjetor, një ditë para Vitit të Ri, në orën pesë fiks, kur me tabakanë në dorë trokita në derë dhe, pa prituri të më thoshte njeri hyr, u futa në dhomë. Merreni me mend si mund të ishte një dhomë hoteli ku banonte një be-

qar dhe për më tepër i dehur. Nejse, hodha sytë nëpër dhomë, xhanxhin. Krevati dopio ishte i shkatërruar sikur në të të kishte ndodhur ndonjë kacafytje. Mbi jastëk nxinte një revolver që më ngjau me një korb të vrrarë. Kur u afrova te tryeza të lija tabakanë pashë një çek, ku ishte shkruar me gërma të mëdha shtypi: «PËR SHPENZIMET E VARRIMIT». Pranë çekut ishte një zarf, ku qe shkruar emri i italianes. I bëra një zë kapitenit, por s'm'u përgjigj njeri. Hyra në dhomën tjetër që shërbente si vend ndenjjeje, por edhe aty këmbë njeriu. Ndërkaq një forcë e brendshme disi e frikshme më ngucte drejt banjës. Dera e saj ishte e mbyllur. Iu afrova dhe në çastin që e shtyva, vetvetiu bëra dy hapa mbrapa. Kapiteni kishte varur veten me një rrip meshine që e kishte kapur te ujëshkarkuesi i WC... Versioni zyrtar për vdekjen e kapitenit ishte tepër lakonik; vetëvrasje për motive pasionante. Si argument sillej letra që kishte lënë kapiteni, disa fragmente të së cilës u botuan nga gazetatat qeveritare. Ca kohë më vonë një gazetë e opozitës e hidhte poshtë versionin zyrtar, madje e quante të gënjeshtërt. Mbrapa vdekjes së kapitenit, që ajo e cilësonte krim me nuanca politike, fshihej një korrupsion i pashembullt qeveritar, që i përgatiste terrenin ndërhyrjes ushtarake të një fuqie të huaj. Artikullin e pasoi një skandal i madh. Ç'është e vërteta, atë kohë

marrëdhëniet e Zogut me Italinë u ftohën, të paktën kështu dukej në sy të botës...

Dera trokëlliu dhe, kur u hap, u duk një kokë me leshra të kuqërremta, si të përshkënditura nga zjarri, aq sa për një hop, të gjithë e mbajtën frymën pezull dhe pritën që tjetri të thërriste: «Ndihmë, zjarri!» Por flokëkuqi zbardhi dhëmbët dhe tha:

— Shoku drejtor, ka ardhur një diplomat i huaj dhe iu kërkon.

— Mirë, mirë, — tha drejtori. — Tani do të zbresim.

Koka u zhduk.

Drejtori u ngrit. Fill pas tij brofi në këmbë edhe funksionari.

— Duhet të jemi korrektë, — tha ai, duke sheshuar rrudhat e xhaketës dhe iu afrua pasqyrës. Ndreqi nyjen e kravatës dhe u kaloi një krehër flokëve rrallacukë.

— Sigurisht, — tha nga ana e vet drejtori, rëndë-rëndë.

Përkthyesi uli kokën dhe u kollit.

— Ne po ju presim në bar — i tha drejtori, hetuesit. — Ndërkohë, sa të mbarojnë punë shokët, mund të rrini këtu... Ke në plan për të bërë ndonjë vizitë me grupin? — Ai u kthye nga përkthyesi.

— Po, më nëntë e gjysmë; në Muzeun Historik Kombëtar.

Hetuesi pa orën.

— Tani që të zbres, po e porosit kameri-

erin t'ju sjellë nga një kafe, — tha drejtori. — Veç, ta dini, këtu te ne kushton ca si shtrenjtë, — shtoi me të qeshur.

Përkthyesi u sforcua dhe ia doli të sajonte një buzëqeshje për t'i lënë të kuptonte që ia kishte kapur shakanë.

— Kur bën shaka shefi, duhet qeshur me çdo kusht, edhe atëherë kur të vjen për të qarë, — i pëshpëriti hetuesit, i cili e gjeti me vend vërejtjen e shokut.

— Shoku drejtor, po unë? — tha sportelisti me gjysmë zëri, sikur të druhej mos zgjonte ndokënd nga gjumi. Fytyra i kishte marrë shprehjen e një njeriu të kapitur që, pasi ka mbërritur deri në njëfarë vendi, as që e ka idenë se çfarë duhet të bëjë më tej.

— Ti... çfarë?

Drejtori i hodhi një shikim sikur s'po arrinte kurrsesi ta sillte ndër mend për ç'arsye gjendej ai njeri në zyrën e tij.

— Mund të iki?

Vështrimi përgjërues i sportelistit e nervozoi përkthyesin.

— Ku?

Dhe në të njëjtën kohë drejtori ktheu kokën dhe pa nga hetuesi. Ai po bisedonte zëshuar me përkthyesin dhe nuk e vuri re.

Sportelistit iu duk sikur të gjithë sa ishin në atë zyrë po komplotonin heshturazi kundër tij. Ai vazhdonte të rrinte në këmbë (si hu, tha me vete) dhe asnjeri s'po ia vërshëllente

STRAZHEVA E JEBELI
BIBLIOTEKA
46052

hallit të tij. E gjithë kjo histori tanimë po i dukej pa pikë kuptimi, aq më tepër nëpërmjet imazhit flu të një nate pa gjumë.

Para syve i doli Irena. Në orën dhjetë e kishin lënë të takoheshin te Teatri i Kukullave. O zot, sa e kishte pritur këtë çast (atij i ngjante sikur një jetë të tërë kishte jetuar vetëm për të ngjëruar kënaqësinë e atij çasti) Sot do ta shpinte për herë të parë (legalisht) në shtëpi.

Mendimi se po e «burgosnin» për një ngjarje që nuk kishte të bënte me të, e marrosi me absurditetin e vet. Aty për aty vendosi që me rastin e parë t'ia mbathte; po të mos i jepnin leje të ikte. Megjithatë nuk ishte dhe aq i sigurt në kokëkrisjen e vet dhe për këtë i vinte të hante veten me dhëmbë. E dinte fare mirë se do të vinte një moment kur gjaku do t'i ftohej, mendja t'i kthjellohej dhe atëherë do t'i shihte gjërat me sy tjetër, më të arsyeshëm.

— Në asnjë mënyrë, — ndërhyri funksionari. — Për çdo eventualitet, dëshmitarët okularë duhet të jenë këtu.

Hetuesi u ngrit dhe iu afrua drejtorit.

— Mundësisht dua të shoh regjistrin me emrat e atyre që kanë fjetur mbrëmë në hotel, të huaj a shqiptarë qofshin.

— Punë që bëhet, — tha drejtori. — Eh, or bir, hoteli është si një shtëpi e madhe ku s'mbarojnë ndonjëherë andrallat. Ditë e natë rri dyerhapur, pret e përcjell njerëz, të më-

dhenj e të vegjël, të mirë e të ligj. Megjithëse mund t'ju duket çudi, u bënë dyzet vjet që merrem me këtë punë dhe s'e di ç'është leja e zakonshme. Vetëm atë vit që u martova dhe kur u shtrova në spital nga zemra...

Funksionari iu afrua drejtorit dhe i pëshpëriti diçka pranë veshit.

— Po, po, ke të drejtë, — i tha drejtori.
— Ikim. Do të na falni?

Në kohën që ata dolën nga zyra, hyri sportelisi me regjistrin nën sqetull.

— ...nuk e di pse, por gjithmonë i kam përfytyruar hetuesët mesoburra; me vetulla kaleshe, tipa të zyrtë, — po thoshte përkthyesi.

— Ohu, e kam dëgjuar edhe nga të tjerë, — tha hetuesi. — Për mendimin tim, është një klishe anakronike nga leximet e një letërsie skematike.

Sportelisi u kollit po zhurma u mbyt, pa mbërritur ende tek ata të dy.

— Ma ha mendja se nuk janë pa interes këto që do të them, — tha përkthyesi.

— E di si është puna, — tha hetuesi; — po të jap një këshillë që në fillim, jo aq nga përvoja ime modeste sesa e atyre që janë më të vjetër se unë në këtë profesion: përpiqu të kujtosh çdo gjë, qoftë edhe hollësira që të janë dukur pa asnjë vlerë. Në punën tonë ka një paradoks të lezetshëm; pikërisht gjërat që bien në sy, «shkëlqejnë» themi ne, kur i sho-

shit, zhvlerësohen dhe, e kundërta, ato që duken si çikërrima, nganjëherë përmbajnë çelësin që zbërthen krejt çështjen. Edhe diçka tjetër: mos të të vijë zor të më thuash edhe ndonjë hamendje tënden, le të të duket si budallallëk, s'ka gjë.

Sportelisti përfitoi nga pauza dhe iu afrua tryezës, ku tanimë po rrinte hetuesi.

— Solla regjistrin, — tha.

— Falemnderit, lëre mbi tryezë, — tha hetuesi pa e parë.

Sportelisti u mat të thoshte edhe diçka tjetër, por, kur pa që s'ia kishte ngenë njeri, e la regjistrin ku i thanë dhe doli nga zyra.

Në holl, të gatshëm si zhgani i gazetarëve që pret viktimën me padurim; ishin grumbulluar kamerierë, ashensoristë; pastruese; kuzhinierë, shkurt gjithë personeli i hotelit: Sapo u zuri syri sportelistin, të shtyrë prej kureshtjes që i gërryente përbrenda, iu turrën dhe të gjithë njëherësh nisën ta bombardonin me pyetje nga më naivet, deri te më të fandaksurat që mund të jashtëqiste truri njerëzor.

Tek ai s'depërtonte pothuaj asgjë: Veç ca fjalë të shkëputura e të cungëta që s'i lidhte dot me njëra-tjetrën, edhe sikur të donte. Tanimë kishin perënduar çastet e lavdishme të të qenurit në fokus të vëmendjes, kur atij i dukej privilegj që shefat i thërrisnin dhe gati i luteshin (madje njeri i kishte ofruar edhe kafe) t'u rrëfente atë që kishte ngjarë dhe që ai kishte pasur

fatin ta shihte i pari. E gjithë kjo histori i kishte ardhur në majë të hundës dhe tani në kokë i rrihte veç një mendim, i shndërruar në ide fikse: si e qysh t'ia bënte për të dalë jashtë kësaj vorbulle.

Vetëm blicat e aparateve fotografikë dhe mikrofonat para turirit mungojnë që të më duket vetja si ndonjë personalitet që përgatitet të japë konferencë shtypi, mërmëriti nëpër dhembë dhe, i pezmatuar siç ishte, vetëm një ngërdheshje pa të keq i dhuroi masës amorge, para se të zbriste shkallët, duke i lënë të gjithë të zhgënjyer e të indinjuar me sjelljen e tij.



Glida



Katër ditë më parë. Pasdite e vonë

Autobusi ndaloi para hyrjes së hotelit, të ndriçuar nga drita hënore e llambave me neon, në formë kërpudhash. Dalëngadalë dhe pa ndonjë ngut, me ca lëvizje të plogështa, prej tij zbritën turistët e huaj, pjesa më e madhe e të cilëve ishin të moshuar. Shpinëkërrusur (ishte disi e vështirë të përcaktoje nëse qe rëndesa e viteve, pesha e bagazheve apo ndoshta të dyja bashkë shkak u që qenë përthyer ashtu) ata i hidhnin këmbët me një ndjenjë të papërcaktuar midis kujdesit dhe druajtjes. Ndoshta pasiguria e tyre (nëse do ta quajmë kështu) mund të vinte nga ndjesia që i lind çdo njeriu kur shkel për herë të parë dhe çapitet në dhe të huaj.

Në holl i priste fytyra e qeshur e sportelistit (që në njëfarë mënyre u kujtonte turistëve pllakatat e reklamave që servirnin agjencitë turistike), e cila farfurinte ashtu si abazhurët e kris-

taltë, pllakat prej mermeri e lustra e mobiljeve dhe në të njëjtën kohë rrezatonte mirësjellje, ëmbëlsi, mirëkuptim e gjithçka tjetër që lipsej për t'u garantuar çehreve të lodhura e të hutuara të turistëve një çast prehjeje mbi tokë. I ngërthyer në kornizën sugjestionuese të kostumit të tij të zi elegant, që dukej sikur ia bënte më të përsosura lëvizjet, tek të cilat edhe sikur të nguleshe e të vrojtoje me syrin e një kritizeri nuk mund të kapje gjë të tepërt e ngatharaqe, sportelisi merrte pasaportat dhe u shpërndante çelësat sipas dhomave. Një shaka me takt e bërë në çastin e duhur për meshkujt xhentilë që duhet të respektojnë femrat dhe buzëqeshjet që u shpërndante grave sikur të qenë lule (pavarësisht nga mosha dhe hiret) i bëri turistët e kapitullit, fytyrëvrugët të çelen e të qeshin, madje t'i bëjnë edhe ndonjë kompliment këtij «djaloshi sharmant», — siç u shpreh jo pa njëfarë koketërie njëra prej femrave; — i cili, si resto; u kthente batuta të kripura me humor.

Iliri kishte mbështetur bërrylat në banakun e sportelit dhe po e ndiqte këtë skenë që e zbaviste dhe e bënte të harronte për një grimë lodhjen e nervozizmin e asaj dite. I erdhi keq kur mori fund, dhe turistët, duke tërhequr pas vetes bagazhet; u drejtuan për nga ashensorët: Atëherë u kujtua që ishte për t'i kumtuar diçka.

— Pas gjysmë ore darka, — thirri, pa luajtur nga vendi. — Restoranti në katin e dytë.

Turistët u përgjigjën me një mërmërimë të

zgjatur zërash të ngjirur që përtojnë t'i shndërronjë tingujt në fjalë.

— S'po më dukesh në qejf sonte, — i tha sportelisti, kur mbetën vetëm.

Fytyra e tij tani i ngjante asaj të aktorit që ka fshirë grimin menjëherë pas shfaqjes.

— Jam i dërrmuar, — tha Iliri. — Në mëngjes përcolla një grup holandezësh, kur më njoftuan të nisesha urgjent për të pritur grupin tjetër në kufi.

— Do që të vish në formë, ëë? Dëgjo vëllanë tënd. Ngjitu në dhomë pa humbur kohë, futi një dush sa për të shplarë lodhjen dhe ke për ta ndier veten gjeth.

— Më beso që s'kam fuqi të ngjitem deri në restorant dhe jo më në dhomë dhe, për më tepër, të zbres prapë.

— S'e paske gjë këtë grup. Ca plakaruqër që dukeshin sikur ia kishin mbathur nga azili.

Iliri mblodhi shpatullat.

— Do shkosh në stadium të dielën?

Për pak desh bëri gafën që ta pyeste «Pse, kush luan?»; por e kapi frazën në ajër dhe në çastin që u largua nga sporteli tha:

— S'diskutohet.

Në të vërtetë, nuk ishte aspak tifoz; megjithatë një pjesë e të njohurve e mbanin për të tillë, meqënëse dikur kishte luajtur futboll me një nga skuadrat e kryeqytetit. Sikur të mos i kishin dalë probleme për punën e syve, ndoshta do të kishte vazhduar të merrej me sport.

Iliri hyri në kabinën e ashensorit, shtypi butonin ku ishte stamposur gërma «R» dhe një kohë para se kanatat metalike të mbylleshin e të puthiteshin mirë e mirë, ai pa edhe një herë fytyrën e sportelistit sipas «variantit zyrtar». Atë çast u kujtua që duhej t'i kishte telefonuar Lindës.

S'ka gjë, e marr pas darkës, tha me vete. U kthye me fytyrë nga paret tjetër, ku ndodhej pasqyra dhe shkërbeu buzëqeshjen e sportelistit. Por në vend të saj u sajua një ngërdheshje e shpifur. I nxori gjuhën fytyrës përballë dhe i ktheu kurrizin.

Ashensori u troshit dhe ngeli pezull. Dyert u çelën hapëkrah dhe brenda vërshuan dy fëmijë që po kacafyteshin me shoshoqin se kush do ta shtypte i pari butonin.

Iliri kishte dalë dhe po bariste në holl, duke pritur turistët që ende s'kishin zbritur.

Zakonisht mbrëmjeve turistët janë në një gjendje shpirtërore të shkëlqyer. Është koha kur alegria mbërrin pikën më të lartë të kurbës dhe, në kundërshtim me logjikën e thjeshtë që pas një dite të lodhshme e të potershme njeriu ka nevojë për qetësi dhe mezi pret të shtrihet e të prehë kockat, darkat e tyre janë të zhurmshme e të hareshme si ditëlindje adoleshentësh, para se të gremisen në honin e natës.

Sidoqoftë, duke dalë jashtë kësaj skeme e cila në të vërtetë gjëllonte vetëm në kokën e Ilirit, me grupin e tij të ri nuk ndodhi ky lloj

spektaklit. Pas darkës — ajo u hëngër pothuaj në heshtje të plotë, po të mos përmendim tringëllimat e thikave, të lugëve e pirunëve mbi enët e porcelanta, si dhe fëshfërimat e hapave të kamerierëve mbi parket, — turistët, çifte çifte, hipën në ashensorët dhe firuan. Iliri pati ndjesinë sikur ata fluturuan në drejtim të ca planetëve të panjohur e misteriozë dhe që nga ai çast s'kishte për t'i parë kurrë më. Atëherë iu kujtuan fjalët e sportelistit të cilat kishin përkuar me mendimin e parë që i kishte lindur atij, ndërkohë që po priste turistët të mbaronin punë me kontrollin doganor. Kjo gjë, kushedi pse, bëri t'i shpifej një trishtim që dalëngadalë u shndërrua në një inat të paadresë.

Mendimi që pas ca do të fliste me Lindën, shërbeu si një purgativ i përsosur që të shkarrohej nga makthet e pakmëparshme dhe ta ndiente veten të lehtësuar. Gjithsesi ai nuk mund të shpëtonte (madje sikur e bëri më shqetësuese, ndonëse pa dashje) edhe nga njëfarë brejtje ndërgjegjeje (si dreqin e kishte shtyrë deri tani telefonatën, kur ajo ishte gjëja e parë që kish menduar të bënte, me të mbërritur në Tiranë?!) që e shoqëroi deri në çastin kur ngriti receptorin dhe formoi numrin. Pasi hamendësoi që nga ana tjetër zilja duhej të kishte rënë jo më shumë se dy herë, Iliri e uli menjëherë receptorin. Nuk priti as një minutë, e ngriti sërish dhe formoi të njëjtin numër.

— Alo, Liri?

— Linda? Seç kam një ndjenjë pasigurie, një si dyshim se mos e kanë zbuluar kodin tonë dhe prit, them me vete, kur të më dalë ndonjë nga prindërit e tu... Sidomos këto dy-tri herët e fundit që të kam telefonuar...

— Prandaj s'u bëre i gjallë sot?

— ...

(Gjatë kohës që priste telefonatën e tij i kishte thënë vetes se sido që të vinte puna, këtë frazë nuk duhej ta nxirrte kurrsesi nga goja. Pastaj ia kishte përsëritur e stërpërsëritur këshillën vetvetes sa që lodhur, dhe në një çast e kish harruar dhe s'qe kujtuar më për të).

— Ndoshta duhet ta vrasim mendjen të gjëjmë ndonjë kod të ri, më të sofistikuar.

— ...

(Duke e njohur tipin e tij, ajo e dinte që pak sekonda pas pauzës së parë ai duhej t'ia mbyllte telefonin, pa thënë asnjë fjalë, por çuditërisht nuk e bëri një gjë të tillë. Ndonëse as nuk foli dhe vetëm atë çast ajo e ndjeu se sa meskine kishte tingëlluar pyetja para asaj që po provonte ai.)

— Nga po flet?

— Hoteli.

— Më beso, Liri, kam gjithë pasditen që s'kam lëvizur nga shtëpia... të kam pritur si...

— Më ngecën krejt papritur një grup të ri.

— Liri...

— Eëë...

— Më ka marrë malli... do të doja të të kisha tani, këtu pranë.

— Edhe unë.

— Vërtet? Nuk më ke marrë inat?

— Mos u bëj me fiksasione tani.

— Më thuaj «të dua» që të të besoj.

— Sonte jo.

— ...

(Atij nuk i erdhi mirë që, ndonëse pa dashje, fjalët morën një nuancë hakmarrjeje, dhe, duke e ndier që çdo zgjatje e pauzë mund ta rriste dozën e mërisë në atë keqkuptim, shtoi shpejt e shpejt:)

— Linda.

— Fol, të dëgjoj.

— Vetëm je?

— Pse bën pyetje kot më kot!

— Ku janë ata të shtëpisë?

— Ç'të ka hipur sonte në kokë? Në kuzhinë, po shikojnë televizor.. Do ta dish edhe çfarë po shohin? Është një film idiot, gjoja me heronj të lashtësisë, me ato butaforitë me të cilat mund të rresh vetëm ndonjë kalama kokëdruth, si vëllai im. Alo, Liri, më dëgjon? Mos ke gjë temperaturë?

— Je e sigurt që nuk të përgjon njeri?

— Ky është kulmi.

— Alo, Linda...

— Po pse, si ta ha mendja ty? Që im atë e ka mbushur shtëpinë me aparatura përgjimi që tëurvejorë bisedat telefonike a çfarëdo lloj qo-

fshin, ngaqë ka një vajzë të pafejuar dhe ka frikë se mos i del nga shinat...

— Linda.... prit, nuk më kuptove... jo, unë të dua... Alo?

Iliri e largoi receptorin nga veshi dhe, një hop para se ta ulte, e kundroi me naivitetin e atij që ende s'e ka marrë vesh ç'ka ndodhur. Edhe pasi e lëshoi dorezën mbi aparat, sinjali vijoi t'i tingëllonte në kokë, çuditërisht i amplifikuar, si sirena e një zjarrfikseje që s'ka veçse pak që të ka kaluar pranë.

Në hollin e zbratur e ndjeu veten të braktisur, fillikat. Akrepat e orës së murit i shembëllyen me patericat e një paralitiku. Ku të shkonte të përplasej? Mendjeprishur që nuk e kishte pranuar ftesën e të vetmit çift të rinjsh që ishte në grup (ata bënë udhëtimin e muajit të mjaltit) për t'i shoqëruar në tavernë, u plandos në kolltuk dhe ndezi një cigare. Ku të shkonte të...? Pyetja filloi ta bezdiste, si zukama e një mize që të sillet e përsillet, dhe ti, nervangritur, e ndien veten të pafuqishëm ta përzësh. Në shtrat? Nuk e kuptoi as vetë pse iu duk aq pavend ideja e të fjeturit, ndonëse e ndiente se si i qe ngërthyer lodhja pas çdo pjese të trupit dhe i thëthinte dalëngadalë, pa u ngutur, edhe atë pak energji që mund t'i kishte mbetur. Të zbriste në tavernë? Të dy ftesëbërësve, edhe po qe se nuk do t'u ngelej qejfi, me siguri që s'do t'u vinte mirë. Vërtet mbetej varianti që pa e çarë

kokën të shkonte e të ulej së tryezën e tyre (për në tjetër as bëhej fjalë) dhe duke u buzëqeshur ëmbëlsisht, madje pa u kursyer, të sajonte aty për aty diçka për të përligjur vajtjen, sado absurde që të ishte, kjo nuk kish kurrfarë rëndësie. Por, të gjitha këto ishin hamendje të kota. Ai e dinte fare mirë se, nuk ishte aq i paskrupull që ta luante një rol të këtillë me vërtetësinë që lypej. Shoi cigaren në tavllën e pastër dhe në çast, iu ndërmend se në katin e tretë ishte një bar i vogël, që nuk mbyllej para dhjetës. Pa orën. Kishte ende kohë. Nuk ndenji të priste ashensorin, po mori nga shkallët, duke i ngjitur, siç e kishte zakon, dy e nga dy.

Kur kish hyrë për të parën herë në atë bar, kishte qenë me Lindën. Të dy ishin mrekulluar atëherë me zbulimin që kishin bërë dhe e quanin një të drejtë të padiskutueshme ta konsideronin si «barin e tyre».

Si zakonisht, Iliri u ul në tryezën ku rrinte me Lindën. Ndenjësja ende e ngrohët i kalli një krupë të lehtë, të pleksur me një ndjenjë të turbullt ndërmjet xhelozisë dhe hatërmbetjes. Tryeza ishte pak si mënjanë, në një vend ku s'binte dhe aq në sy. Me një buzëqeshje joshëse, kamerierja (ishte po ajo që i kishte shërbyer edhe herët e tjera) iu qas dhe, pasi e përshëndeti, si, një të njohur të vjetër, e pyeti se çfarë do të porosiste. Iliri i nguli sytë dhe u mendua një hop, sido që vetmevete e kishte ndarë me-

ndjen që më parë se çfarë do të merrte.

— Kafe tortë, ponç, limonadë, konjak...

Ajo e vuri re se si shikimi i tij rrëshqiti nga sytë dhe veç kur e ndjeu tek iu ngjit te buzët, si një masë e ngrohtë, viskoze, nëpër trup i kaluan drithërima. Sikur atë çast atij t'i shkreppte në kokë të ngrihej e ta puthte, ajo përfytyroi e tmerruar që s'do të ishte në gjendje të bënte asnjë lëvizje për ta kundërshtuar.

Iliri nuk u besoi syve, kur i kuqi me të cilin ajo kishte lyer buzët, nga ngjyrë trëndafili u bë all dhe ndërkaq iu kujtua reklama që kishte lexuar rastësisht dikur për ca artikuj kozmetikë, ndërmjet të cilëve edhe për një të kuq buzësh, që e rriste intensitetin e ngjyrës kur femra që e kishte përdorur ndiente afeksion për mashkullin që kish kundruall.

— Konjak, — tha Iliri dhe e shqiti i pari shikimin.

Ndezi një cigare, por i shastisur siç ishte, kunjin e shkrepëses e filu dhe e futi në xhep, ndërsa kutinë e hodhi në tavllë.

Kamerierja buzëqeshi sikur t'u bënte reklamë dhëmbëve (i kish vërtet të përsosur), u rrotullua me elegancë dhe e largua. Iliri e ndoqi me sy deri sa mbërriti te banaku. Në çastin që ndaloi, ajo ktheu kokën gjoja rastësisht nga tryeza e tij dhe, kur vështrimet e tyre u puqën, harkoi vetullën e majtë dhe kafshoi buzën e poshtme. Për Ilirin atë grimë toka e ndërpreu rrotullimin dhe krejt papritur ai ngeli kokëngulthi. Atë-

herë ndjeu gjakun t'i vërshonte gurgulltazi në kokë dhe përfytyroi se si pas pak, fytyra e tij do t'i shembëllente një domateje të pjekur për bukuri.

Dera e barit u hap pa zhurmë dhe në prag u fanit figura elegante e një gruaje, me një çantë sportive në sup. Një pjesë e klientëve kthyen kokat dhe pastaj, pa kurrfarë shprehjeje në fytyrë, sikur dera të ishte hapur dhe mbyllur vetvetiu, vijuan muhabetin. E kujdesshme sikur të druhej se mos ndotej gjëkund, ajo kaloi përmes rruginës së tryezave dhe ul pranë banakut. Iliri e njohu. Ishte njëra prej turistëve të grupit të tij. Për to ai kishte stampuar në kujtesë një portret kolektiv në të cilin, ajo, e porsaardhura, kishte zënë vend në rreshtin e parë. Çuditërisht, përkundër sigurisë së tij të deriatëhershme, emri i saj nuk iu kujtua, sado që rrëmoi në skedat e trurit. Gruaja hodhi një sy nëpër bar, si të kërkonte ndonjë të njohur, me të cilin kishte lënë takim në atë vend. Kur vështrimi i saj panoramoi nga Iliri, ai shfryu nga goja gulçetymi të kaltër, për t'u maskuar pas tyre, si oktapodi kur i kanoset rreziku. Gruaja porositi skoç uiski dhe ndezi një cigare në kohën që kamerierja i shpuri gotën dhe ia la mbi tryezë. Ajo filloi ta gjerbte me gllënjka të vogla, po të shpejta, ndërsa ërvatej ta nguliste shikimin diku në murin përballë, veç pas ca, pa mundur të mbahej në atë pjerrësirë tejet të lëmuar, ai i rrësh-

qiti dhe u zhyt në gotën gjysmë të zbrazur.

Dhe ti kujtoje që plakushët e tu të urtë do të ishin tani të gjithë duke gërhitur, si tromba të dala jashtë përdorimit, i tha Iliri vetes, duke kundruar ndërkohë profilin e bukur të së huajës.

Gruaja e shkulloi gotën dhe porositi një të dytë.

Pa shih, pa shih, qenka e fortë gjyshja! S'ke ç'i thua!

Ajo bëri një gjysmë rrotullimi të kokës majtas, me një lëvizje të beftë, sikur ta ndiente që po e përgjonin, dhe shikimet e tyre u përplasën me një krismë qelqi të thyer. I ngelur keq, Iliri u ngut t'i buzëqeshte dhe veç kësaj ta përshëndeste edhe me kokë. Ajo ia ktheu buzëqeshjen, veçse sytë i shprehnin diçka tjetër. Për një grimë mendoi se ashtu do t'i qe dukur atij, por jo, në vështrimin e saj lexohej qartë ftesa për t'i bërë shoqëri. Me një farë sikleti që buzëqeshja s'e kishte shkarkuar dot, Iliri përfytyroi deri në detaje, se si do të ngrihej, rruqën që do të përshkonte dhe pastaj, si do të ulej në tryezë dhe të gjitha këto vetëm për hir të të ashtuquajturit, takt i të sjellurit.

Dreqi e mori! Ç'jam unë, damë shoqërimi për plakat e vetmuara që s'dinë si të shtyjnë netët e pagjuma. S'ka gjë më absurde dhe qesharake se kjo kortezi kalorësiake që kushedi ç'idiot e ka shpikur, dhe ti, kundër çdo dëshire, e pranon e ia imponon vetes. E pse? Që të dukesh i njerëzishëm në sytë e botës...

Duke recituar mendimin, Iliri ndërkohë ishte ngritur dhe me çapa të vegjël e të ngathët iu afrua tryezës së të huajës.

— Besoj se nuk ju shqetësoj? — tha Iliri, duke uruar me vete për të kundërtën.

Më tepër se mirënjohëse, e mrekulluar që ai djalosh kishte ditur t'ia interpretonte saktë shikimin e pakmëparshëm dhe pa ngurruar i qe përgjigjur trillit të saj (fjalën «dëshirë» e përçmonte ngaqë i dukej e denjë vetëm për ata që ishin të varfër shpirtërisht e materialisht), ajo i buzëqeshi. Atij iu duk edhe më e bukur se kur e kish parë nga larg.

Sa vjeç mund të jetë?

Rrudhat në fytyrën e saj, për fat të keq, s'mund të shërbenin si rrathët e një trangu për t'i numëruar vjeçët.

E ç'rëndësi ka për mua që e kërkoj me kaq ngulm, iu përgjigj vetes. Ajo është një femër pak a shumë e moshuar, me të cilën nuk më lidh asgjë veç rastësisë dhe, si për gjithçka të rastësishme që mund të hasësh përditë, s'ia vlen të merresh me të e t'i bësh të tilla teste trunit.

— Oh, përkundrazi! — tha ajo. Kur ia dëgjoje zërin, sidomos për herë të parë, të lindte ndjesia sikur e zonja e përdorte gjithnjë e më rrallë, si ndonjë gramafon të vjetër të dalë prej kohësh jashtë mode dhe të harruar diku, në ndonjë cep të cergosur të shtëpisë. — Të vetmet

gjëra që njerëzit e moshës sime i kanë ca si shpesh me vete, aq sa u janë bërë të padurueshme dhe u janë pështirosur ngaqë nuk janë në gjendje t'i përzënë, janë dy: vetmia dhe heshtja.

— Ûnë po mendoja se mos kishit dëshirë të rrinit vetëm dhe s'do t'ju pëlqente shoqëria...

Gruaja bëri një lëvizje me dorë sikur po përzinte diçka që e bezdiste dhe Iliri e la pambarruar atë që po thoshte. Në të vërtetë e ndjeu veten të lehtësuar. Gjithë ato fjalë kishin qenë të panevojshme, si shfajësimi i ndonjë adoleshenti.

Një valë herë ata nuk shkëmbyen asnjë fjalë, të fundosur në kolltukët e heshtjes që ishin aq komodë për të dy, por pas një casti të vetëm që erdhi pa u ndier, heshtja u bë alergjike, duke shkaktuar një alarm të brendshëm që reflektohej në buzëqeshjet e sikletshme që jepnin e mernin (si letra kredenciale, kishte thënë Iliri më vonë) me sho-shoqin.

— Cigare? — tha Iliri, me një zë sikur të shkundej e të dilte nga ajo gjendje hipnoze, duke i zgjatur paketën.

— Jo, faleminderit, e kam zakon të tymos vetëm nga të miat, — tha ajo dhe nxori një cigare nga paketa e vet, me puro të holla të errandshme, që përfundonin me një pipëz të bardhë. — Kohët e fundit në botë ka shpërthyer një fushatë kundër duhanit që, me histerinë e saj më duket një nga kryqëzatat më absurde që ndërmarrë ndonjëherë njerzimi. C

sytë të shohin vetëm pllakate gjigantë antireklamë. Kam të fiksuar sidomos njerin prej tyre, me një fushë të bardhë, në mes të së cilës është një paketë e zezë, e zgjatur në formë arkivoli dhe cigaret, sikur të jehë gozhdë, kanë mbërthyer kapakun.

— Mjekësia ka qenë gjithmonë pragmatiste,
— tha Iliri.

— Ndërsa mjekët sharlatanë, — tha gruaja.
— Oh, më mirë të ndërrojmë temë, ju lutem.

— Si të dëshironi.

Iliri ngriti supet.

— Është ogur i keq, thoshte im shoq, kur dy të njohur ndodhen në të njëjtin bar dhe rrinë në tryeza të ndryshme... Nuk e di, po ndoshta është moshë që i bën njerëzit supersticiozë.

— S'e besoj, — tha Iliri. — Njoh pleq që tallen me paragjykimet, si dhe të rinj që i respektojnë me një frikë të pashpjegueshme.

— Të dy palët qenkan për të ardhur keq,
— tha ajo dhe shtoi shpejt e shpejt: — Po ju jeni?

— Për fat, jo.

Ajo vuri buzën në gaz dhe një vel trishtimi i ra mbi fytyrë.

— Dikur edhe unë i quaja kotësira dhe i injoroja këto gjëra. Sidoqoftë, në një mënyrë ose tjetër, njerëzit besojnë diku, kanë nevojë të besojnë diku, sepse s'mund të bëjnë dot ndryshe. Edhe ju ateistët besoni në ateizmin tuaj.

Sikur të përfitoste nga pauza e gruas, Iliri u orvat dëshpërimthi t'i sillte ndër mend emrin që, si një bumerang i flakur, sillej e përsillej diku dhe po vonohej t'i shfaqej.

— Pse nuk porositni diçka për të pirë? — e pyeti ajo.

— Ah, jo, faleminderit, sapo e piva një konjak, — tha Iliri.

— Atëhere merrni një kafe. Ju siguroj që nuk më rëndoni aspak nga ana financiare.

Iliri ngeli në mëdyshje. S'ishte aspak e këndshme të të luteshin, të paktën atij nuk i qe dukur asnjëherë e tillë.

— Mirë, — tha Iliri dhe shtoi me vete; Një femre të bukur, pavarësisht nga mosha, nuk i thua dot jo, kur të propozon diçka.

— Çdo mbrëmje unë për vete pi rregullisht një gotë skoç. Veç, kur jam e mërzitur dhe ndiej se si vetmia më thëthnin në vorbullën e saj, ia lejoj vetes edhe ndonjë gotë tjetër, si ai mjeku liçencioz që e bën një sy qor për çdo trill të pacientit të tij, mjaft që të jetë rahat dhe të mos ketë kokëçarje.

— Sonte duhet të jeni e pikëlluar, zonjë.

— Pse? Ku e dini ju? — Gruaja ngriti kokën rrëmbimthi dhe pa e tromaksur sikur ato fjalë t'i kishin zbulur diçka intime, që e fshihte me xheloz. Dalëngadalë fytyra iu shtendos dhe sytë i shkëlqyen nga një shkulum ngazëllimi i brendshëm që fryu dhe ia largoi velin e trishtimit, duke i dhënë portretit të saj ca nuanca të

reja bukurie. — Oh, më paskeni përgjuar si një detektiv skrupuloz. Nuk ju vjen ndopak zor?

Iliri u skuq.

— Jo, jo... rastësisht... mos më keqkuptoni...

— Bëra shaka, mos u prekni, — tha ajo me të qeshur dhe vuri dorën e vet mbi të Ilirit. Çuditërisht ai pati të njëjtën ndjesi që kishte provuar edhe atëherë kur, i shtyrë nga kuresh-tja, i kishte prekur një e nga një (jo pa njëfarë neverie të lehtë) të gjithë eksponatet e Muzeu-mit të Shkencave të Natyrës, ku punonte Lin-da. — Çfarë po ju thosha? — Gruaja ndenji një hop sypicërruar, vështrimngulur diku në lartësinë e kokës së Ilirit, si për të lidhur fillin e mendimeve dhe vijoi. — Ah, po, këshillën e tim shoqi, që unë i jap vlerë universale. Një gotë uiski pas darke është sedativ njëqind herë më i efektshëm se ato ndyrësirat, më falni për shprehjen, që rekomandojnë mjekët. Kjo ishte e para, tani e dyta. Pak më parë thatë që dukem e trishtuar, në mos gaboj. — Jeni vëzhgues i mprehtë, miku im... besoj se më lejoni t'ju thërras kështu...

(Iliri pohoi me kokë)

— ... Jo, jo, mos e merrni për kompliment, thatë një të vërtetë. Do të bëj një pyetje, së cilës do t'i përgjigjem vetë Ç'janë Vetmia, Më-kati, Dhimbja apo, të kalojmë në krahun tjetër, Dashuria, Dëlirësia, Lumturia? — E huaja ndezi një cigare. Zakonisht ajo i shuante më gjysmë, me ca lëvizje nervoze. — Ndoshta nga ana letra-re figura ime do të tingëllojë vulgare, sidoqoftë,

nga ana logjike nuk çalon. Përfytyroi si pije magjike, që i kanë shtënë në një kupë të stërmadhe, si ato ku pinin nektarin perënditë pagane të Olimp, duke sajuar kësisoj njëfarë kokteili. Një pjesë e njerëzve s'kanë guxuar ta prekin, kuptohet, për arsye të ndryshme, më kryesorja e të cilave, për mendimin tim, është Frika. Të tjerët, që në thelb nuk ndryshojnë shumë nga të parët, sa e kanë afruar te buzët dhe ngjëruar pak, e kanë zbrapsur menjëherë, ngaqë shija i ka disgustuar dhe pas këtyre vjen elita e racës njerëzore, ajo e martirëve të purifikuar, ku bëj pjesë edhe unë, që e kanë rrëkëlyer kupën me stoicizëm dhe tani nuk u ka mbetur veçse pakëz nga fundi, si skoçi që sheh në gotën time.

Ajo e ngriti gotën, po nuk e ktheu. I hodhi një shikim lëngut që, pas qelqit dukej i turbullt. Befas, krahu iu këput e i ra mbi tryezë, sikur të qe i ndonjë statujë prej allçie të skaduar me kohë. Pa ia shqitur sytë gotës, ajo rinisi të fliste:

— Përderisa njeriu është një krijesë që lind e vdes midis dhimbjeve, jeta e tij nuk është veçse një fill i stërzgjatur vuajtjesh, i kush-tëzuar në mënyrë të pashmangshme nga këto dy kahe, prandaj sa më shumë çaste kënaqësie ti rrëmbëjmë jetës aq më mirë është për ne. Oh, më falni për këtë ton moralizues. Për fat të keq, ja dhe një tjetër shenjë plakjeje, më sa duket. — Ajo vuizi buzën në gaz, me atë ndjenjë

të lehtë trishtimi që ia shoqëronte përherë buzëqeshjen. Papritur tha: — A nuk ngjan fati i njeriut me atë të mizës? Çfarë, denigruese? Jo, jo, miku im, s'më duket aspak ashtu. Në fund të fundit, a nuk janë dy organizma biologjikë vetëqenien e të cilave e kushtëzon lëvizja e pareshtur? Dhe në këtë lëvizje të ethshme rreken t'i shkëputin Fatit atë që nuk është gjë tjetër veçse ekzistenca e tyre. Ndonëse do të vijë një ditë, dhe kjo është e pashmangshme, kur do kërkojnë për një çast të vetëm Prehjen, por pas petkut të saj as që ua merr mendja se mund të jetë fshehur Vdekja. E di, mos më thuaj që tingëllon si retorikë e zbrazët, megjithatë kjo është e vërteta bruto.

Iliri dëgjonte si i përhumbur. Fjalët i hynin në kokë me zukamë si shrapnela dhe aty pëlçisnin zhurmshëm, duke pështjelluar e çoroditur gjithçka. Sytë (mbrapa xhameve të syzeve ata ngjanin fare të vecërr) përpinin çdo gjë, madje ishin ata që ua jepnin kuptimin fjalëve, sipas lëvizjeve të buzëve dhe se mesazhet e nxjerra nga këto informacione të pazëshme, thitheshin nga truri e skedoheshin me saktësi.

Thonjtë, të gjatë, prerë në formë bajameje, i kishte lyer me manikyr të kuq:

(Për një hop, Iliri pati para syve imazhe blannash gjaku të porsampiksuar.)

Duart nazike kishin zënë t'i flashkeshin. Vilarët e damarëve, ngjanin të xhamtë aq sa mund të vëreje rrjedhjen e rryeshme të gjakut, si një magmë që po zë të ngurtësohet.

(Dikur kishte dëgjuar që vdekja e nis ekspansionin nga gjymtyrët).

Unazat (ato ishin katër, dy në çdonjërën dorë) dhe byzylykët (tri, vetëm në dorën e majtë) me reflekset e befta, të herëpashershme, duke shin sikur shkëmbenin sinjale të fshehta, me llambadarin e kristaltë të barit.

(Kurora e gurëve të çmuar, shkëlqimbjerrur prej shikimit të tij të shfokusuar, i ngjau me kokërdhokë të verbër.)

Fytyra e patinuar nga një shtresë kremi të kujtonte një geishë të plakur, për të cilën s'interesohet më njeri, ndonëse ajo shpreson dhe pret e pret atë që nuk ka për t'u kthyer kurrë më.

(Bardhësia jo e zakonitë sikur ia kishte ngrirë portretin, që, në mjegullën e përfytyrimit të tij, shëmbëllente me një maskë të për-mortshme.)

Flokët ishin ndoshta gjëja më e mrekullueshme, ashtu të shkapërderdhur si ujëvarë mbi supe, me njëfarë shkujdesjeje dhe elegance njëkohësisht.

(Befas mahnitja u zhvlerësua dhe ia la vendin një ndjesie të turbullt dyshimi se mos ishin parukë. Në ngasje marroke dhe e paturp që të shtrinte dorën e t'i prekte e kaploi, dhe atij iu desh t'i hakërrehej vetes që ta tulaste tundimin. Por u duk sheshit që ende i trembej forcës që e shtinte në ngasje, kur me marifet e mbështeti dorën e majtë mbi të djathtën.

dhe nisi ta kruante lehtë sikur të qe ndonjë maçok që donte ta përgjumte. Sikur të mos mjaftonte edhe kjo, pak më pas e tërhoqi dalëngadalë pa rënë në sy, dhe e futi në xhep. Tashmë që të pabindurës dorë e djathtë i kishte veshur këmishën e forcës, u qetua. Teksa rrekej të shkulte mendimin e mbrapshtë nga koka, sytë i shkuan te ca pikla të kafta mbi llërët lapucere, që i sollën ndër mend gjyshen dhe duart e saj të kryqëzuara, në kohën që po i vinin kapakun qivurit.)

— Erozioni i pleqërisë...

— Më falni, por nuk ju kuptova, — tha e huaja.

— Hiçgjë — tha Iliri dhe e shkuli vështrimin prej saj.

Që pak më parë ai kishte folur në gjuhën e vet, ajo as që e diskutonte, por nuk mund t'ia lejonte vetes të tregojë kureshtare më tepër se ç'duhej, ndaj, duke shpërfillur gjithçka, madje edhe vëmendjen e bashkëbiseduesit, ndërroi temë.

— S'besoj të ketë njeri pa një hobi, — tha ajo. — Ka disa vjet që udhëtimet nëpër botë janë bërë hobi im i vetëm. Më duket e pakonceptueshme se si mund të ikësh nga kjo jetë pa i rënë kryq e tërthor kuvlisë ku gjallon. Dhe është për t'u çuditur se Shqipëria ishte i vetmi vend ku s'kisha shkelur, ndonëse për të më kishin folur kur nuk isha veçse një çupëlinë që s'dija asgjë për botën, përveç asaj që na

kishin mësuar në orën e gjeografisë, në shkollë. Asokohe unë shëtisja nëpër botë me gishtin mbi hartë. Nuk e di në e keni dëgjuar atë shprehjen e njohur të turistëve për Romën, që thotë: «Shih Romën dhe vdis.» Unë për vete e kisha zëvendësuar fjalën Romë me Shqipëri. Përditë ecim drejt vdekjes me një hap që sa vjen dhe përshpejtohet. Kështu që vdekjen mund ta hasim çdo çast, natyrore apo aksidentale qoftë, pak rëndësi ka kjo. Një gjë dihet, fundi është gjithmonë skematik, një «mortus ex machina». Sipas opinionit tim, njeriu është krijesa më e koklavitur dhe kontradiktore që ka planeti ynë. Nuk është se të tillë e krijoi Perëndia. Në fillësën e vet ai u gatua me materjen më të thjeshtë dhe jo pa qëllim, me baltën, pas-këtaj dalëngadalë nisi të përsosej dhe, për fat të keq, pa mbaruar ende ky proces, filloi një tjetër, ai i sofistifikimit. Ndërsa i pari ishte vepër e Birit të Kreatorit, ideatori dhe zbatuesi i procesit të dytë është Satanai. Kjo ka bërë që njeriu të jetë përherë i mjerë të mos e njohë dhe të mos e provojë kurrë lumturinë, përveçse atëherë kur autosugjestionohet. Më thuaj të drejtën, të ka rastisur të njohësh ndonjë njeri që të ketë qenë i kënaqur me atë që ka mbërritur në jetë? Të kuptohemi, nuk e kam fjalën për eremitët, që në njëfarë mënyre janë kthyer në fillësën e njerëzimit...

(Gruaja e ndërpreu një grimë të folurën, për të ndezur një cigare. Iliri pati ndjesinë sikur ajo po kthente nga ana tjetër kasetën.)

— ... Për mendimin tim, kënaqësia ka një limit dhe, kur e mbërrin, është e kuptueshme që për çastin ngopesh e s'mendon për gjë tjetër, por më pas të hipën në kokë dalldia të kapësh një limit tjetër, më të largët dhe, kur sos tek ai, atëherë synon drejt një të riu, kështu që jeta të kalon në këtë maratonë lumturie, që, pa u kuptuar, shndërrohet në maratonë brengash. Me sa duket, qenka në natyrën e njeriut të synojë atë që s'e ka, ose, siç do të shprehej im shoq, të kafshojë thembrën.

Sado që u përpoq, aty për aty Iliri nuk gjeti mënyrë tjetër më të saktë sesa përkthimi ijalë për fjalë, për ta shqipëruar shprehjen e mësi-përme.

— Më falni, zonjë, — tha Iliri, — nuk po më kujtohet t'ju kem parë me burrin.

— Ajo e mbështeti majën e ndezur të cigares në tavëll dhe peshoi mbi të derisa prej saj nuk doli më asnjë dredhëz tymi. Dhe tha:

— Im shoq ka shtatë vjet që ka vdekur.

— Oh, të më ndjeni!

— S'ka gjë, ai ishte plak dhe vuante prej kohësh nga një sëmundje e pashërueshme, kështu që Zoti u tregua shpirtgjerë dhe bëri një mirësi, atij edhe mua, kur vendosi ta thërriste pranë vetes.

Sytë e Ilirit u zhgapërryen prapa qelqeve të syzave, sikur papandehur ato të ishin shundërruar në lente zmadhuese.

— Ju duken cinike fjalët e mia?

(Ajo shpiku goten dhe e pa shkarazi. Ilirit nuk i erdhi hiç mirë që ajo kishte mundur të lexonte diçka në portretin e tij)

— E shoh, ju jeni idealist si gjithë gjenarata juaj...

(E huaja qeshi hidhur. Për Ilirin kishte qenë më tepër një ngërdheshje tallese, të cilën ajo e kish maskuar me marifet, që të mos iynej bashkëbiseduesi.)

— ... Të mbetesh vejushë duke e pasur burrin gjallë, është e llantarshme. Eshtë pak a shumë si të bashkejetosh me një vampir me të cilin je dhe s'je gjallë. E dini, vjen një ditë në jetën tënde, kur zgjohesh një mëgjes dhe papritur e sheh veten të braktisur, njeri pa njeri dhe atëherë, në çdo qelizë ndien të vërtetën ngjethëse, që deri më atë kohë ishe orvatur ta injoroje me mendjelehtësi, se edhe ti mund të plakeshe. Por mesohesh, ju siguroj unë që mesohesh edhe me këtë mënyrë të ekzistuarit e për vdekjen zë të mendosh si për një mikeshë me të cilën je grindur dikur, kurse tani pothuaj i servilosesh e kërkon të pajtohesh me të dhe (ç'absurditet!) ta ftosh për një vizitë kortezie në shtëpi. Unë kam vdekur, po jam ringjallur, si zoti ynë Jezu Krisht.

Iliri u tkurr. Ndjeu që po rikthehej në gjendjen e pakmëparshme, veç këtë herë fjalët e humbisnin kumbimin metalik dhe dëgjoheshin sikur të vinin nga fundi i terrtë i një korridorit pafundësisht të gjatë. Tiparet e gruas u mjegu-

lluan dhe ca nga ca u shpërbënë, sikur midis tyre të qe vendosur një xham akulli. Iliri hoqi syzet dhe i fshiu me fundin e mbulesës së tryezës.

— E keni gabim në qoftë se mendoni që varri, ajo gropë tmerrkallëse në të parë, është banesa e fundit e njeriut, përkundrazi, ajo s'është gjë tjetër veçse porta që të hap Ati ynë që është në qiell, drejt amëshimit dhe paqtimit. Mbaj mend tim shoq që thoshte: Lindja është Ferri, Gjallesa është Purgatori dhe Vdekja është Parajsa...

(Ndërkohë Iliri po niste të shqetësohej seriozisht për gjendjen psikike të bashkëbisedueses.)

— ... Arkitekti më tha se do të kushtonte jashtëzakonisht, por unë ia preva shkurt: është diçka që s'më merakos hiç fare. Paratë s'kanë ç'më duhen me vete në mbretërinë e Perëndisë. Imagjino, ne shpenzojmë pa u kursyer për kënaqësitë e kësaj bote, ku nuk jemi veçse vizitorë, përkujdesemi kaq shumë për trupin që, në fund të fundit, ç'është, baltë e përdhosur, dhe jemi aq të marrë sa shpërfillimin shpirtin. Ndaj doja që banesa ime e përjetshme të ishte një tempull origjinal, sfidë e shenjtë për mëkatën dhe lapërdhitë njerëzore...

(Me majat e gishtërinjve Iliri ngriti syzet, që i rrëshqitnin vazhdimisht mbi hundë.)

— ... Më mungonte vetëm epitafi. Nuk po mundja të gjeja diçka të denjë. Kam paguar

poetë, dhe jo dosido, por të lauruar me çmime, megjithatë asgjë s'më hynte në sy. Shijet e mia janë tepër të holla, dhe kjo për mua është fatkeqësi, sepse, në vend të më lumturojnë me finesën e tyre, më bëjnë të vuaj kur shoh se gjithçka që më rrethon është aq vulgare! Ç'paradoks! Shpirti i ndjeshëm është mallkim i Zotit për atë që e ka, thotë diku në një vend Cvajgu. Megjithatë nuk më kujtohet me saktësi. E njihni si autor? Keni lexuar ndonjë gjë prej tij?

— Po, — tha Iliri.

— Kisha përshtypjen që në Shqipëri për-ktheheshin vetëm shkrimtarë komunistë...

(Ajo bëri një pauzë të shkurtër, sikur po priste të shihte reagimin e tij, por befas ndërroi mendje dhe vijoi:)

— ... Përse po ju flisja? Ah, po, për epitafin. Më në fund e gjeta vetë. Ku, do të pyesni ju? Në shkrimet e shenjta, miku im. Ishte një shprehje lakonike, fare e thjeshtë, por, sa më shumë që mundohesha ta zbërtheja për t'i gjetur thelbin, aq më e thellë bëhej, diçka që nuk mund ta pillte kurrësi mendja e një vdekëtari, qoftë ky edhe një gjeni. O VARR! KU ËSHTË FITIMI YT?

(Ajo heshti dhe e pa tjetrin ngultas në sy.)

— O Jezu Krisht, pse më shikoni ashtu? — tha e huaja e tromaksur dhe kryqëzoi duart në gjoks sikur u orvat të mbulohej.

— Si? — tha Iliri dhe sakaq u skuq.

— E tmerrshme! M'i kishit ngulur sytë sikur të isha hije dhe jo qenie me mish e kocka. Shikimi juaj po më depërtonte. Është hera e dytë në jetën time që më lind një ndjesi e tillë nga vështrimi i një njeriu. Herën e parë, ka qenë në një kishë, menjëherë pas përshpirtjes prifti m'u afrua dhe nga mënyra se si m'i hodhi sytë atë moment e besova edhe vetë që nuk ekzistoj. Atë herë dola nga kisha dhe zura të endem rrugëve si e marrosur nga ajo që unë e quaja me vete lehtësia e pahonephshme e mosqenies. Më kish dalë nga mendja që veturën e kisha parkuar në sheshin para kishës. Lundroja në një det fytyrash të panjohura, duke kërkuar dëshpërimthi ndokënd që të më përmendte nga Letargjia e Hiçit. Hyra në një bar me shpresën absurde se mund të hasja ndonjë të njohur, qoftë ky mik apo armik, pak rëndësi kishte, në mos të krijoja një lidhje të re, isha gati të bëja dashuri me këdo, mjaft që ai askushi të më përceptonte. Por në atë vorbull duhmash që qelbeshin erë alkool, asnjëri s'më qasej, madje as që merrte mundimin të më vinte re. E dehur, jo dhe aq nga uiski sesa nga pikëllimi, dola sërish në rrugë. Papritur që të ndizej drita e gjelbër e semaforit për kalimtarët, u lëshova si e çekuilibruar mes lumit të rrëmbyer të makinave që çanin përpara dhe uturinin me histerizëm, por çuditërisht pa më cakitur. Atëherë, e lebetitur, fillova të ulërij gjëra pa kuptim, idiotizma, por më kot e mundoja

veten, kurrkush s'dëgjonte të kthente kokën, madje as polici që s'ndodhej veçse disa këmbë larg meje. Që nga ai çast, nuk e mbaj mend se si sosa në shtëpi. Mendimi i parë që më shkrepri në kokë mëngjesin e së nesërmes, ishte që atë që nuk arrita ta vërtetoja me të gjallët e mi ta vërtetoja me vdekjen time. Në kohën që kisha rrëkëllyer një grusht barbiturikësh në një gotë me ujë dhe po e trazoja ngadalë-ngadalë, me të njëjtën ndjesi që një i dënuar me vdekje çapitet, këmbëzvarrë, për në vendin e ekzekutimit, ra zilja e telefonit. Thjesht kureshtja se kush mund të qe ai person në botë që më në fund i kishte rënë ndër mend për mua, më shtyu deri te telefoni dhe më dha atë çikë fuqi, sa për të ngritur receptorin. Kishte qenë avokati im. «Zonjë, nuk e kisha ditur që politika paskësh qenë pasioni juaj më i zjarrtë», më thotë. Dhe unë iu përgjigja: «Zotëri, deri më sot nuk e kisha ditur që pasioni juaj më i zjarrtë paskësh qenë të recitoje gjepura pa kripë, që pa gdhirë.» Zëtronditur, ma ktheu: «Zonjë, më falni, por nuk po bëj shaka, të paktën me ju nuk mund t'ia lejoj vetes një gjë të tillë. Në qoftë se s'më besoni, hidhini një sy numrit të sotëm të «Kasnecit të mëngjesit» ...zonjë... zonjë:» E mbylla telefonin dhe ashtu siç isha, dola për të blerë gazetën. Në faqen e parë ishte një fotografi, ku unë dallohesha shkoqur, në plan të parë, me duart e drejtuara nga qielli, mes zhganit të makinave, që ngjanin sikur qenë

vërsulur të më shqyenin. Poshtë saj ishte dëçitura «Lutja e fundit e një ekologjisteje». E lexova me zë dhe ia plasa gazit. Dhe atë çast ndodhi mrekullia, njerëzit që kalonin pranë kthenin kokat dhe më shikonin të habitur, disi të trembur, ndërsa unë vazhdoja të qeshja, pa e prishur terezinë. Kur u ktheva në shtëpi, gotën me tretësirën e barbiturikëve e gjeta të përmbytur dhe Xhesin, qenushin tim të dashur, që po bënte gjumin e madh.

Ajo nxori nga gjoksi një kryq të vogël, të florinjte dhe e puthi.

Iliri ktheu kokën mbrapa, i persekutuar nga një kompleks faji e turpi, që në mënyrë të pashpjegueshme lidhej me gjestin e së huajës. Por askush në bar s'e kishte mendjen tek ata. Ndërkohë që po vriste mendjen se si t'ia bënte për t'u larguar pa lënë përshtypje të keqe te bashkëbiseduesja, ajo rinisi të fliste me zë monoton e të lodhur.

— Duke huazur nga Cvajgu metodologjinë me të cilën ai analizon dhe zbërthen psikologjinë e femrës, si njohës i shkëlqyer që është, dhe duke e modifikuar për qëllimin tim, mund të them se meshkujve shqiptarë u mungon ai sharmi që të bën tërheqës në sytë e femrave, ndonëse, po t'i njohësh nga afër, zbulon diçka që në aparençë duket sikur ato e shpërfillin, madje e përçmojnë, ndoshta nga frika sugjestive e së panjohurës. Është një virilitet, një ashpërsi që të ngjall neps, që mposht çdo skru-

pull e etiketë, të cilat, në zjarrminë e pasionit, i flak si të linjtat, në një kënd të dhomës. Frika e dhembjes shndërrohet në kënaqësi primitive, që ngjall instinkte të harruara prej kohësh ose të paprovuara kurrë ndonjëherë. Dhe atëherë, me nuhatjen e hollë femërore, ti e ndien se të gjithë meshkujt që ke njohur nuk kanë qenë veçse manekinë të pispillosur e të lëpirë, që tanimë jo vetëm nuk të tërheqin, por të kallin krupë me delikatesën dhe manierat e stërholuara, si të ndonjë hermafroditi. Nga ai çast shijet e tua janë pasuruar, janë bërë më të holla, kurse shumë kujtime të mëparshme janë zbehur dhe klasifikuar në kategorinë e përvojave pa vlerë, aq sa ndien një farë keqardhjeje për gjithë atë kohë të shpenzuar më kot.

— Vëzhgim i hollë, zonjë. Singërisht ju them që po më habitni.

— Për çfarë, ju lutem?

— Të jemi realistë, nuk mund ta bëjë kushdo. S'keni veçse pak orë në vendin tonë dhe...

Gruaja qeshi, por e frenoi shumë shpejt duke e nxjerrë pëllëmbën para gojës së hapur. Në të qeshurën e saj ishte e njëjta gërvimë që i gërricte zërin edhe kur fliste.

— Ju pandehni se është impresion i një çasti? Oh, sa naiv që bëheni. Më falni, nuk e thashë për t'ju fyer. Do t'ju besoj një sekret, si shenjë të besimit që kam ndaj jush dhe miqësisë sonë.

(Ajo e uli zërin. Për një grimë u shty pas me gjithë karrige dhe picërroi sytë, për ta

vëzhguar më mirë efektin e fjalëve të saj. Pas-këtaj u afrua dhe u përkul nga Iliri.)

... Para se të shpërthente Lufta e Dytë Botërore kam qenë e fejuar me një shqiptar... Ju lutem, të paguajmë?

Ajo i hodhi një sy orës dhe shoi cigaren e saponisur.

— Si, po ikni? Kaq shpejt? — e pyeti Iliri, teksa po priste që ajo t'i rrëfente romancën e vet të dashurisë.

— Do të më falni, po për mua u bë vonë, Im shoq thoshte gjithmonë një proverb, më duket indian: «Shko herët në shtrat të jetosh sa më gjatë».

Paguan dhe dolën, Iliri e përcolli deri tek ashensori. Para se të ndaheshin, ajo i zgjati dorën dhe i tha:

— Jeni përkthyesi më i sjellshëm...

(Dhe më durimbudallai, shtoi Iliri me vete)

— ... që kam njohur ndonjëherë. Faleminderit për shoqërinë dhe natën e mirë!

— Natën e mirë, zonjë!

Pas atyre fjalëve Iliri pati ndjesinë sikur ata të dy i kishin dhënë lamtumirën njëri-tjetrit dhe nuk do të shiheshin në mëngjes, si zakonisht, në restorant.

Para kanatave metalike të mbylluar të ashensorit ai mbajti këmbët, ia kërciti ballit me gje-stin klasik të njeriut që i kujtohet me vonesë diçka dhe sa s'thirri:

— Maria — Luiza de F! Si dreqin s'më ra ndër mend, pak më parë?

Ora 9.10

— Interesant, — tha hetuesi, tek vejevinte nëpër zyrë. — Do t'i hedhësh në letër të gjitha këto që më the tani, pa ndryshuar asnjë presje. Ka rëndësi edhe ky rend faktesh që më parashtrova.

— Mund ta bëj që sonte, — tha përkthyesi.

— Nesër në mëngjes e ke gati.

Pas një pauze të shkurtër përkthyesi brofi në këmbë dhe tha:

— Po dal. Më duhet të takoj përgjegjës in grupit të turistëve për të saktësuar punën e vizitës.

— Ndoshta mbaroni shpejt dhe shihemi përsëri, — tha hetuesi, pa qenë fort i sigurt në do të kishte kohë t'i bënte shoqëri tjetrit.

— Mbase, — tha përkthyesi, duke mbledhur supet, me mosbesim. — Sidoqoftë, mirupafshim!

Hetuesi ngriti dorën, po nuk foli. U ul në kolltuk dhe gogësiu. Vetmia s'po i pëlqente hiç

fare, ndonëse kishte gjithato punë për të bërë. Në të vërtetë, kjo gjë e çorodiste dhe e nervozonte, ngaqë s'dinte nga t'ia niste. U hodhi një sy shkresave të hapura mbi tryezë, pa ndonjë rregull dhe shfryu.

Ky djalë është si ai kau i ri, megjithëse e ka kularin në zverk, s'i shtrohet që s'i shtrohet punës, kishte thënë njëherë shefi i seksionit për të, mbase pa të keq, duke pasur parasysh natyrën e tij që, «i lëshonte fjalët, si lopa bajgën», siç shprehej ai për veten.

Atij i erdhi për të qeshur, kur iu kujtuan këto fjalë, të shqiptuara me atë aksentin e theksuar jugor, ndonëse atëherë qe fyer dhe kishte varur buzët.

Turistët kishin zbritur në holl. Fytyrat e tyre çehrezbehta e thithnin si oksigjenin atë ndriçim sylëbyrës që rrëkëllehej me bollëk dhe i bënte të dukeshin të ngazëllyera, si fytyra fëmijësh. Gjithsecili kishte dëgjuar për «diellin e mrekullueshëm dhe natyrën magjepsëse» të këtij vendi «të paprekur nga bacilet e civilizimit perëndimor» qoftë nga reklammat e agjencive turistike (të cilave pak ishte për t'iu besuar, siç qe shprehur një turist i moshuar), qoftë nga të njohurit e tyre që e kishin vizituar më parë (më entuziastët e kishin cilësuar «këndin më të qetë në botë»), por ishte tjetër gjë të vije vetë dhe ta përjetoje emocionin të gjallë, tej iluzionit që krijonin fjalët.

Sikur të mos kishte ndodhur kurrfarë gjëje

(ç'është e vërteta, mikroboja e çdonjërit s'që cënuar aspak nga lajmi që kishin marrë në mëngjes, në restorant për vdekjen e papritur të bashkëatdhetares së tyre) turistët endeshin në holl dhe në lulishten para hotelit, mospërfillës dhe shendeverë në të njëjtën kohë. Ekuilibri dhe qetësia shpirtërore që reflektonin fytyrat, e dëshmonin këtë gjë dukshëm.

— Mami dhe babi, ju përshëndesin nga Tirana...

— Mund të më shpjegoni ju lutem, sa është kursi i shkëmbimit të dollarit me lekun?

— ... do të doja të isha lakuriq dhe të lahesha në këtë ujëvarë drite marramendëse...

... në të ritë tonë njerëzit nuk ishin kaq të shthurur...

— Zhvendosuni pak më djathtas që në sfond të duket hoteli.

— Është i vetmi kryeqytet i Lindjes, ku ruhet ende shtatorja e Stalinit.

— Do të flirtoja me gjithë qejf me një shqiptar...

— Thonë që është themeluar në shekullin e shtatëmbëdhjetë nga një pasha turk...

— ... elementët e primitivizmit në punimet artizanale dëshmojnë për shpirtin konservator...

— Më vjen keq, e dashur, por mbrëmë isha tmerrësisht i lodhur... Seksi ka nevojë për një

predispozitë reciproke, pastaj, në moshën time duhet të jem i përkorë...

— Idiot ngele gjithë jetën...

— Botëkuptimi i tyre, do të thosha, ka diçka të përngjashme me dogmat e krishtëritimit...

— Në të vërtetë, gjen një pikë takimi në faktin se çdo filozofi që lind si forcë udhëheqëse e të shtypurve, në çastin që bëhet ideologji zyrtare, tjetërsohet dhe shndërrohet në një instrument shtypës në duart e aparatit burokratik shtetëror...

— Më falni, por mendoj që ka një lajthitje në arsyetimin tuaj. Në qoftë se do të kishit lexuar qoftë edhe një libër të filozofisë marksiste, gjykimi juaj nuk do të ishte kaq i sipërfaqshëm...

— Ah, politika është një e keqe e domosdoshme, pa të cilën ne njerëzit e civilizuar ja që s'bëjmë dot, ndërsa politikanët janë si priftërinjtë, parazitë dhe parangrënës.

— Sikur të mos ndiqej kjo politikë absurde çmimesh nga Akademia Suedeze, që është kthyer në strehë vorfnore për disidentët, me siguri që ai do ta kishte marrë me kohë çmimin Nobel...

— E kam lexuar dhe pa dyshim është një nga shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë...

— ... Kuzhina e tyre është tipike orientale...

— Ju lutem, ku mund të gjej kuti shkrepëseje të llojeve të ndryshme, se më duhen për koleksion?

Në njëfarë mënyre këto skena dhe dialogë ishin bërë të rëndomtë deri në mërziti për përkthyesin. Për të, turistët ishin të gjithë njëfarësh (siç shprehej ngandonjëherë me të qeshur, pa dallim kombësie, feje dhe moshe) një shoqëri fëmijësh të llastuar e moskokëçarës, që vinin për t'u zbavitur në «Qytetin e lodrave». Por këtë herë monotonia ishte shndërruar në një ndjesi të paprovuar, diçka që e deformonte realitetin, e bënte të dukej anormal. Ai i mbajti këmbët te shkallina e fundit dhe papandehur u drithërua kur në tërë atë pështjellim dhe «eufori idiote» (siç ia ngjiti me vete) pa një turiste plakë që po dëneste prajshëm dhe të shoqin kërrusur mbi të, që i çuquriste pranë veshit duke i përkëdhelur flokët e hirtë.

— Më falni që po ju shqetësoj. — tha përkthyesi. — Me se mund t'ju ndihmoj?

— Jo, faleminderit, — tha burri pa e kthyer kokën, — nuk ka gjë, do t'i kalojë.

Përkthyesi i ktheu shpinën dhe u largua. U drejtua për nga sporteli, ndonëse do të kish dashur të shkonte në një vend ku të mos kish njeri rreth e rrotull, të mos dëgjonte asgjë, qoftë dhe një copë herë të vetme, sido që e dinte fort mirë se kjo; dëshirë më se e logjikshme ishte po aq e realizueshme sa edhe kokëkrisja më e papërfytyrueshme, si bie fjala, për t'u nisur në Hënë.

— Janë në barin e vogël, — i tha sportelisti i turnit të paradites.

— E di, — tha përkthyesi, pa e patur mendjen tek ai.

— Më zunë veshët se ajo gruaja ishte spiune dhe e kishin helmuar, — tha sportelisti duke zhvendosur tinëzisht, sa majtas-djathtas, bebëzat që i shkëlqenin si të ndonjë maçoku në errësirë.

— Me gjithë ata veshë llapushë si llakatorë që ke ti, s'më duket donjë çudi ajo që ke dëgjuar, — tha përkthyesi nëpër dhëmbë.

Dhe shtoi me zë:

— Informacioni që ke marrë, është shumë i saktë, madje do të shtoja që i kishin prerë edhe veshët. Ç'tmerr! Dhe ia kishin rrasur në gojë, ndërsa sytë, pasi ia kishin nxjerrë... e gjen dot se në ç'vend ia kishin futur? Po deshe, mund t'ia futësh edhe kot, të jesh i sigurt që ke për ta gjetur.

— E pse tallesh? — tha sportelisti, pasi e kishte ndjekur gojëhapur e syçapëlyer pjesën e parë të rrëfimit dhe menjëherë vari turiçkat sikur atë grimë të mos i kish mbetur asnjë dhëmbë në gojë.

— Më vjen shumë keq, — tha përkthyesi, — por unë kam respekt të veçantë për njerëzit që merren me spiunazh,

Sportelisti e ndoqi me sy derisa tjetri hyri në bar dhe shfryu:

— Një copë përkthyes është dhe çoç i duket vetja!

Përgjegjësi i grupit turistik, fytyrëqeshur e në qejf si përherë ia bëri me dorë. Përkthyesi iu afrua tryezës ku po rrinin edhe drejtori i ho-

telit, funksionari i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe përfaqësuesi i ambasadës (sekretari i dytë, siç qe prezantuar). Diplomati ishte veshur sportiv, sikur të kish ardhur fill prej fushës së tenisit dhe jo nga kancelaria. Prapëseprapë mustaqet e holla të tipit spic (përkthyesi përfytyroi se si ai u përkushtojë atyre mëngjes për mëngjes me gërshërë e krëhër në duar, para pasqyrës së tualetit, në banjë) dhe syzet e errëta fotokromatike i hidhnin një hije fshehtësie dhe misteri fytyrës së tij, që pa dashje të ngjallte imazhin e vjetëruar të agjentit sekret klasik.

Përkthyesi u ul në krah të përgjegjësit të grupit.

— Erdha t'ju pyes nëse jeni të predispozuar për të bërë vizitën e programuar në Muzeun Historik Kombëtar.

— Natyrisht, — tha ai, buzagaz, — Nuk shoh ndonjë arsye për ta anuluar, të paktën, nga ana jonë, veç në qoftë se keni ju...

Përgjegjësi pa nga diplomati, që u shtir sikur nuk e kishte mendjen dhe nuk e vuri re. Dukej sheshit që gjithë kjo nuk e zbaviste, përkundrazi, mezi priste të mbaronin formalitetet dhe të largohej (ndoshta për të përfunduar lojën e tenisit, sipas impresionit që pati përgjegjësi i grupit.)

— Njohja me historinë, traditat dhe kulturat reciproke do të shërbejë për të forcuar më tej miqësinë ndërmjet dy vendeve dhe popujve tanë, — tha funksionari.

Sakaq diplomati stisi një buzëqeshje dhe tundi kokën në mënyrë aprovuese.

Etiketë profesionale, — tha përkthyesi me vete.

Drejtori i hotelit i kishte ngritur duart dhe po i mbante para gjoksit që për çdo rast të mos kapëj në befasi, por të qe gati për të duartrokitur.

Përgjegjësi i grupit dhe përkthyesi, në rezonancë me njëri-tjetrin, kërkuar ndjesë, u ngritën dhe dolën nga bari.

— Po më ngjan si një sindromë kolektive kjo indiferencë ndaj fatkeqësisë së tjetrit, — tha përkthyesi kur ishin në holl, pothuaj i sigurt që tjetri do të ishte i një mendjeje me të:

Përgjegjësi i grupit qeshi.

— Nuk ju duket pak si tepër subjektiv ky gjykim? — tha ai. — Një piktori i mjaftojnë dy-tri penelata që pikat e shiut në tablonë e tij t'i shndërrojë në njolla gjaku dhe, po t'i shkrepet, njollat e gjakut mund t'i shndërrojë në petale trëndafili. Kollaj fare, apo jo?

— Jo, për mendimin tim këtu nuk ka subjektivizëm, as ndonjë lajthitje sentimentale. Do të ishte një padrejtësi që s'do t'ia lejoja vetes. Thënë troç, kjo është shprehje flagrante e filozofisë së individualizmit më ekstrem.

— Ndoshta, — tha përgjegjësi i grupit, pa e shqitur buzagazin nga fytyra. — Unë thashë vetëm mendimin tim, jo më pak subjektiv nga i yti.

— Në çfarëdo rrethane qoftë, — vijoi të fliste përkthyesi, duke dashur ta kornizonte më në fund mendimin, — kësaj filozofie nuk mund t'i bëhet kurrfarë apologjie.

— Njeriu i qytetëruar e ka stërvitur veten me një disiplinë spartane që të fshehë në skutat më të thella të shpirtit ndjenjat e veta ndaj të tjerëve. Kjo nuk është veçse një edukatë e shkëlqyer vetëkontrolli, që koha moderne në të cilën jetojmë, u jep bijve të saj, përveç të tjerash edhe si kusht ekzistence... Ju lutem t'i fiksoni mirë dy fjalët e fundit. Shpërthimet patetike, impulset e gjaknxehëtisë, euforia e pakontrolluar janë të pakonceptueshme për Homo Modernissimus, të papranueshme për temperamentin e tij të kultivuar, — të kuptohemi, atavizma ka dhe do të ketë, — i cili i konsideron ato ose si një romantizëm anakronik ose ekzotikë antropologjike të Botës së Tretë. Duke u nisur nga ligji darvinian i seleksionimit, që unë e respektoj jashtëzakonisht për saktësinë shkencore me të cilën mund të aplikohet jo vetëm në shkencat e natyrës, por edhe në ato shoqërore, madje do të thosha me kompetencë, duke pasur parasysh jo thjesht përvojën vetjake, e cila na censuron, se banorët e vendeve të nxehta nuk mund të mbijetojnë në klimën tonë të akullt ku pasionet njerëzore janë konservuar dhe ruhen si eksponate në vitrinat e veprave artistike të shekujve të kaluar. Ndërsa ne kemi privilegjin që mund të shkojmë për turizëm në vendet e tyre, ku klima është e mrekullueshme. Ju lutem, s'dua të më keqkuptoni dhe të krijoni ndonjë opinion të deformuar për mua. Mendimet e pakmëparshme s'janë reminshenca të teorive raciste të fabrikuara në vitet tridhjetë prej sistemeve totalitariste që udhëhiqe-

shin nga qenie delirante me simptoma maniako — depressive. Faktin që, unë si person nuk kam paragjykime për racat, jua kam provuar me një shembull mjaft sinjifikativ nga jeta ime, besoj se ju kujtohet? Martesa,,

— Ah, po, — u ngut të ndërhynte përkthyesi.

Përgjegjësi i grupit u orvat të buzëqeshte, por sajoi një zgërdheshje që përkthyesi e quajti me vete: skarco të një roboti, me vetëkontroll të çakorduar.

— Më falni, po,, dëshiroj t'ju bëj një pyetje që mund të tingëllojë disi indiskrete.

— S'ka gjë,

— Sa kohë keni që punoni si guidë?

— Pak, jo kushedisesa.

— Miku im, — befas përgjegjësi i grupit u tregua i dashur, ndonëse, ç'është e vërteta ai që i sjellshëm, madje tepër i sjellshëm me të gjithë, — motoja ime dhe e të gjithë turistëve që brendhin sot nëpër botë është: «Jeta është e shkurtër, prandaj ta gëzojmë». Dhe më vjen për të qeshur kur kujtoj që ky është vargu i një poezie që na mësonin dikur në shkollë. Epikurianizëm, do të thoni ju. Ashtu është vërtet. Unë e adhuroj filozofinë e antikitetit. Mund të them që e kam lexuar në origjinal pjesën më të madhe të veprave. Dhe a e dini çfarë më ka bërë iashtëzakonisht përshtypje në to? Më kuptoni drejt, është thjesht një impresion, ajo që ne e konsideroimë vecanësi, gati-gati dhuntinë që e ashtuquajtura shoqëri e konsumit na ka injektuar, sensin praktik. Filozofia e lashtë me thelbin e saj na ofron

dy përvoja primare: e para na mëson si të jetojmë dhe e dyta na mëson si të vdesim. Përgjatë këtij segmenti që e mbajnë në duart e tyre Mojrat, hasim edhe dy përvoja të tjera që le t'i quajmë sekondare; e para prej tyre na mëson si të lexojmë alfabetet e mësipërme, ndërsa e dyta na mëson si të dialogojmë dhe monologojmë me to. Vlerat e vërteta njerëzimi i ka kultivuar në dy epoka; Antikitët dhe Kohë Moderne. Në të parën produkti i vlerave ka qenë nga ana mendore, kurse në të dytën nga ana materiale. Periudha ndërmjetëse ka qenë zbaticë, eremitizmi i njerëzimit. Për mendimin tim, s'është kurrsesi rastësi që edhe zhvillimit i turizmit lidhet me këto dy epoka. E dini që në shekullin e parë para Krishtit romakët shkonin për turizëm në Egjipt? Çfarë mrekullie! Më falni se u zgjata pak dhe ju mërzita me gjithë këtë ligjëratë. Mos më thoni jo, ju lutem, e di edhe vetë që e kam këtë cen, sepse ma vë gjithmonë në dukje ime shoqe.

— Mos harroni vetëm një gjë, që për dhjetë minuta nisemi, — tha përkthyesi.

— Kam përshtypjen që te shqiptarët kompleks i vdekjes është tepër i fortë, — i tha përgjegjësi i grupit një mikut të vet turist, që e hasi pasi u nda nga përkthyesi. — Thanatosi nuk është për ta një akt biologjik, por mistik. Është fatalitet që i ndjek hap pas hapi që nga origjina e tyre si komb, mādje edhe më parë, si racë,

— Kam lexuar gjëra interesante për këtë problem në një libër sociologjie të shkruar nga një prift katolik që ka jetuar pesëmbëdhjetë vjet

pranë një tribuje malësorësh, — tha tjetri. — Po të shprehësh me gjuhën time, do të thosha se vlefta e aksioneve të jetës së një individi çmohej vetëm në çastin e vdekjes, në kuptimin që aty ose rriteshin ose binin përfundimisht. Aq rëndësi kishte ky çast sa në libër jepeshin shembuj se si persona të ndryshëm, në pamundësi të vdisnin në sheshin e betejës, kur vdekja u vinte në rrugë natyrore, i bënë sfidë dhe e prisnin atë në këmbë deri në grahmën e fundit, vetëm e vetëm që të mos falimentonin nga pikëpamja e nderit kanunor, që unë do ta quaja fondin e tyre valutor. Aq e gjithëpushtetshme ishte kjo bursë që luhej me jetë njerëzish, sa aty përmendeshin femra që, me aktin e vdekjes, e kapërcenin paragjykimin social për inferioritetin e seksit dhe në kurset e këmbimit vlerësoheshin jo si monedha të dobëta në raport me monedhat e forta, domethënë meshkujt.

— Pak i koklavitur ky arsyetimi yt, mik i dashur, ashtu si vetë profesioni juaj, — tha përgjegjësi i grupit, me zë të ngjirur nga lodhja.

— Dua të më bësh një nder, — i tha sportelisi i turnit të natës përkthyesit, duke i mbirë para syve.

— Si e ke hallin? — tha përkthyesi jo pa njëfarë bezdie, që e kishin ndaluar tamam kur qe nisur për të dalë nga hoteli.

— Hidhi një llaf hetuesit për mua. Po s'më lanë të iki, më fikën derën...

Përkthyesi i hodhi një sy orës. 9 e 25. Për pesë minuta duhej të ishin para Muzeut.

— Bjeri shkurt, se s'kam kohë.

— E 'di si është puna? Në orën dhjetë...

U dëgjuan dy të rëna borie. Autobusi kishte ndaluar para hotelit.

— Më beso, më vjen keq...

(Atë çast, kur ë pa të katandisur ashtu si një lypës, i erdhi vërtet keq.)

— ... po s'të bëj dot gjë, — tha përkthyesi dhe me një ndjesi padurimi mori për nga porta e xhamtë e daljes, i ndjekur nga sportelisti. — Më duhet të largohem se kam për të bërë një vizitë me grupin. Le që s'kam ndonjë shoqëri kushediçë me hetuesin që të shkoj t'i kërkoj të më bëjë ndere...

Thuaj më mirë troç, hiqmu sysh dhe mos më gërric tepër, tha sportelisti me vete; fytyrëngjeshur pas vetratës, që, i parë ballazi nga jashtë, shëmbëllente me një bazoreliev të përcudnuar.

— Tri ditë më parë. Mëngjes

Më në fund, shpresëhumbur, kur po fillonte të nervozohej ngaqë koha po i shkapërderdhej më kot, Iliri e gjeti përgjegjësin e grupit të turistëve dhe të dy u hoqën mënjanë, nga fundi i hollit, për të diskutuar planin e vizitave të asaj dite.

Përgjegjësi ishte një tip i gjatë, pak i kërrusur, miop, me hundën petashuqe, ngjyrë tulle, si sqep pate. Mbathte një palë këpucë të stërmëdhaja që të bënin të lije mendjen, sikur, thua ti, ia kishte marrë hua ndonjë klouni.

Është një humbamento i lezetshëm, do të thoshte Iliri për të.

Gjatë gjithë kohës që bisedonin, Iliri do të vinte re se ai buzëqeshte dhe për çdo gjë që i thoshte, pohonte me kokë «me mirësjelljen proverbiale të një diplomati kinez», siç qe shprehur për veten. Një ditë më parë, nuk kishin veçse pak që qenë njohur, ai i kishte thënë me një

sinqeritet që, për një hop Ilirit i qe dukur shtirak. «Më pëlqen fakti që kam të bëj me një përkthyes që mban syze.» Dhe kur Iliri e kishte pyetur «Mund ta di cila është arsyeja?», ai qe përgjigjur me një shpjegueshmëri që e kishte detyruar Ilirin ta besonte: «Ushqej një paragjykim për ata intelektualë që nuk përdorin syze.»

Tamam sipas psikologjisë së një aziatiku, kishte menduar Iliri.

Dhe nuk ishte befasuar aspak, përkundrazi, i qe dukur më se e natyrshme kur ai i kish treguar se bashkëshortja e tij ishte kineze, e bija e një shkrimtari disident që kishte emigruar në Evropë.

Shumë shpejt kishin rënë dakord për të gjitha pikat e programit të vizitave dhe u ndanë në mirëkuptim e të kënaqur me shoshogin si dy afaristë që, pasi kanë nënshkruar marrëveshjen, janë të sigurt dhe i bëjnë qejfin vetes se në biznesin e sapopërfunduar leverdia ka qënë e tij dhe jo e partnerit.

Po ta shikosh hollë-hollë këtë punë, për ty, si përkthyes është më mirë të kesh përgjegjës grupi një tip të tillë sesa ndonjë mistrec e provokator, që i duket vetja si Henri Kisingeri dhe ta nxin jetën, kishte menduar Iliri.

Lavdi Zeusit (të cilin, përgjegjësi e kishte emëruar edhe perëndi të turizmit) që ky djalosh e njihka për mrekulli profesionin dhe nuk ka nevojë për dado.

Tani për Ilirin i vetmi problem i pazgjidhur mbetej autobusi. Shoferi e kishte marrë në telefon që pa gdhirë, për t'i thënë se duhej ta shpinte makinën në park medoemos, për shkak të një defekti që ai vetë nuk kishte ç't'i bënte, Patën bërë fjalë, pastaj nervat u kishin rënë e qenë pajtuar, kur ai i kishte dhënë fjalën «Mos preksha kurrë më femër me dorë» që s'do të vonohej dhe, para se të nisej, do ta merrte në telefon nga parku.

Tani që kishte ngelur vetëm, nisi ta përndjekë sërish ndjesia (e cila prej disa orësh i qe kthyer në obsesion) sikur kish harruar apo humbur diçka që kurrsesi s'arrinte ta sillte ndër mend.

Një dorë e preku në sup aq lehtë sa, po të kishte qenë në rrugë, do të kish pandehur se, ajo nuk mund të ishte gjë tjetër, veçse një gjethë që qe këputur nga dega dhe po pikonte mbi asfalt.

— Ktheu kokën.

Ajo ishte më këmbë, para tij, vetëm në këmishë nate. Sido që e dinte fort mirë se ajo kishte rënë prej kohësh në letargjinë e menopauzës, prapëseprapë atij iu duk jashtëzakonisht ngashnjyese. «Ti më je si një lule e vyshkur që ende e ruan aromën... As ai vetë nuk e mori vesh se si iu kujtua ky varg i një kënge ev-

gjitësh. Pa thënë asnjë fjalë, vështrimqepur mbi të, ajo iu afrua shtratit dhe me ca lëvizje tërë ojna, torturuese, sikur po bënte strip — tease, uli nga supet rripat e këmishës së natës. Paskëtaj, duke u spërdredhur për ta eksituar, ajo e la rrobën e mëndafshhtë t'i rrëshqiste nga trupi, por ... në vend të linjave epshndjellëse iu shfaq një skelet fosforeshent. Pa e kuptuar pse, prej tmerrit apo farfurimës sylëbyrëse të kokallave, ai i zuri sytë me duar dhe kur i largoi, vuri re i çmerituar se ajo qe zhdukur pa u ndier, si hije. Nuk ndjeu as gërvimën e derës që u mbyll, as zhurmën e hapave të saj, po ç'rëndësi kishte, ajo i qe fanitur tani, një lloj si në ëndrrën e një nate më parë.

— Mirë ... dita, — tha ajo shqip.

— Oh, zonja de F., po më befasoni.

— Mund të më thërrisni Maria — Luiza, — tha ajo me një buzagaz ëngjëllor.

Gjithçka e përjetuar mbrëmjen e shkuar në bar u distancua me shpejtësi dhe tani po i dukej një e kaluar e largët. Po i ngjante një mrekulli çudibërëse se si atë proces të rryeshëm plakjeje, që vitet e kishin nisur me kohë, një natë e vetme, më se e zakonshme, jo vetëm e kishte ndaluar, por e kish zhvendosur kushedi sa vjet mbrapa. Maria — Luiza vazhdonte t'i buzëqeshte, por lehtazi ajo po venitej, për t'i lënë vendin stepjes, pastaj pak nga pak fyerjes, duke parë shastisjen dhe gojëkryçjen e tij.

— Pushuat mirë mbrëmë? — tha Iliri, duke

iu marrë goja nga ngutja, si të donte të shuante nga kujtesa e gruas përshtypjen jo të mirë që mund të kishte lënë syngulfësia e tij.

— ...(?)

— Më falni, por kam qenë aq i mbytur me punë, sa rrezik nuk do të njihja as gjyshen, po të më shfaqej kaq papritur, kështu si ju.

— Të paktën sensi i humorit nuk ju është mpirë, — tha Maria — Luiza pa e shqitur buzagazin sikur ta kishte vënë në mëngjes para pasqyrës, bashkë me të kuqin e preferuar të buzëve. — Jeni i lirë ta pimë bashkë kafën e mëngjesit? — Dhe shtoi shpejt e shpejt, kur kapi me intuitën e femrës njëfarë ngurrimi tek ai: — Arsyeja është se dua të bisedoj me ju në një vend të qetë... për të qënë më e saktë, t'ju rrëfej diçka.

— Mua? — Iliri vuri dorën në gjoks dhe ktheu kokën sikur të priste të shihte dikë tjetër mbra-pa vetes. — Mos keni gabuar adresë zonjë? Unë s'mbaj mend të kem qenë ndonjëherë prift.

Buzëqeshja e Maria — Luizës u vyshk. Ai e ndjeu veten ngushtë. Shakaja i kishte plasur në duar, si një tullumbac i fryrë tej mase.

— Ju lutem, më thoni, në qoftë se ju bezdis...

— Nuk besoj se e morët seriozisht një shaka pa të keq.

— Atëherë më ndihmoni që t'ju kuptoj. Mos pandehni se jeni tip i lexueshëm. Në fillim të lini përshtypjen e njeriut me të cilin mund të merresh vesh pa ndonjë vështirësi, por mjafton

capak kohë dhe vë re që kjo është gjëja më e sikletshme për të arritur. Femrat dashurohen lehtësisht me natyra si juaja, megjithatë si zor që lidhja të rezistojë për një kohë të gjatë.

— Faleminderit, zonjë, se përmes analizës suaj më dhatë mundësinë të njoh një pjesë të paeksploruar të vetvetes. S'të rastis çdo ditë të puqesh me njerëz kaq dashamirës.

— S'është nevoja të shpenzoni më kot gjithë këto mirënjohje. Im shoq thoshte: «Të dish, s'është asgjë; të përfytyrosh, është gjithçka.»

— Pranoj, veç me një kusht: mbrëmë paguat ju, sot është radha ime.

— Oh, sido që këtë vogëlsirë mund ta linim për në fund.

Iliri iu avit sportelit dhe la porosi se ku mund ta gjenin, po qe se do ta kërkonin.

Shkuan në barin e katit të tretë. Lokali sapo ishte hapur. Në të s'kish këmbë njeriu. Ilirit i pëlqeu kjo gjë. Kamerierja e banakierja po bisedonin kokë më kokë dhe pëshpërma e tyre shkrihej me shushurimën e aparatit të ekspresit dhe Iliri përfytyroi se si tok me filxhanin e kafes, ato të servirin në pjatëz edhe një biskotë thashethemesh. Ndoshta këmbët i shpunë pa vetëdije dhe ata u ulën në të njëjtën tryezë të një nate më parë. Maria — Luiza i zgjati paketën e cigareve.

— Jo, faleminderit. E kam zakon që pi vetëm nga të miat.

Për habinë e Ilirit, ajo nuk reagoi.

Pasi ndezën nga një cigare dhe i kishin tymosur deri në gjysmë (ndërkohë kamerierja u kishte prurë kafet), Iliri pati ndjesinë sikur atë natë e kishin gdhirë aty, duke tymosur e shikuar njëri-tjetrin në heshtje. Tani që e kish aq pranë dhe mund ta këqyrte me vëmendje e nge, vuri re se mrekullia që kish ndodhur në fytyrën e Maria — Luizës nuk ishte veçse një truk i rëndomtë-kozmetik. Lëkura e saj ishte hekurosuar nga kremërat.

Heshtja po zvargej.

— Për fat të keq, kohën e kemi të kufizuar. Nga çasti në çast mund të vijë autobuzi dhe ...

E la pa mbaruar atë që kishte ndërmend të thoshte, kur pa që Maria — Luiza s'e kish mendjen tek ai. Ajo thithte cigaren e përhumbur, me një vështrim të tretur, ëndërrues, si një vajzë që shkërben në sytë e të dashurit aktoren e zemrës. Befas, në një kohë që Ilirit po i shteronte durimi nga kjo heshtje e pakuptimtë, Maria — Luiza, si të qe çliruar nga ajo gjendje hipnoze, shoi cigaren (pa e shpurë në fund, si gjithë herët e tjera), ndezi një të dytë dhe tha:

— Unë jam supersticioze. Në mos gaboj, jua thashë edhe mbrëmë, apo jo? — Dhe pa pritur që ai të pohonte, vijoi: — Ëndrrat nuk janë imazhe morboze, pjella kapriçoze të trurit, si ca sekuenca të ndonjë filmi syrealist të Bunjuelit. Para së gjithash, ato janë mesazhe providenci-ale, sigurisht jo për këdo. Vetëm qeniet me arsye të kulluar, intelekt të ngritur dhe, ç'është

më e rëndësishmja, me shkëndijën hyjnore në shpirt mund t'i kapin, zbërthejnë e interpretojnë këto sinjale që t'i dërgon perëndia. Unë e kam përdorur ëndrrën si një aparat për të verifikuar të vërtetën dhe gënjeshtren, për gjithçka që lidhet me realitetin, në të cilin gjallojmë fizikisht. Jam krenare me shpikjen time dhe mund të them se deri më sot ky aparat ka funksionuar përsosmërisht. Do t'ju shpjegoj më me hollësi që ta keni të qartë.

— Nuk keni frikë se mund t'ju vjedh patentën?

— Përkundrazi, do të isha e lumtur po qe se do t'i shërbente sadopak njerëzimit. — Maria — Luiza nxori shaminë nga çanta dhe shfryu hundët pa zhurmë. — Në rast se fakti jetësor riprodhohet besnikërisht sipas origjinalit, domethënë ëndrrës, atëherë rezultati do të jetë njëqind për qind negativ, pra përfundimi është i gënjeshtërt. Dhe anasjelltas, po qe se origjinali s'përputhet me faktin jetësor, rezultati është pozitiv. Nuk e di në shprehem qartë dhe a po më kuptoni?

Me lëvozhgën e brishtë të heshtjes ajo kishte mbështjellë dëshirën për një «po» të thënë nga ai.

Në qoftë se më ka ftuar të më thotë të tilla broçkulla, — këtë fare mirë mund ta bënte me ndonjë nga plakat e grupit, — padyshim që s'është në rregull nga trutë, mendoj Iliri, duke kujtuar, ndërkohë, bisedën e një nate më parë.

Iliri nxitoi të buzëqeshte, i cytur nga frika se mos Maria — Luiza i lëçiste mendimet që i kishin rendur nëpër kokë.

— Në qoftë se ju kujtohet, mbrëmë ju thashë që para dyzet vjetësh kam qenë e fejuar me një shqiptar. Pas kaq e kaq kohësh që e kemi humbur njëri-tjetrin, e pashë sërish Xhanin, veçse këtë herë në ëndërr. E pabesueshme, shiheshim sy më sy, por pa folur e pa u prekur, Pas çdo hapi që hidhja drejt tij, ai tretej si një re, derisa u bë i tejdukshëm, si fantazmë, dhe në çastin që e kisha fare pranë, kur zgjata duart për ta përqafuar, u zhduk, më humbi përgjithmonë nga sytë. Klitha e lebetitur dhe u zgjova e mbytur në djersë. M'u desh një copë herë e mirë për të ardhur në vete dhe të sjell ndër mend që jam në Shqipërinë e aq shumë-dëshiruar të Xhanit tim. Ja pra; ky është mesazhi hyjnor që perëndia më dërgoi mbrëmë natën...

(Nëpërmjet engjëllit Gabriel, shtoi Iliri me vete, pa iu shqitur ndjesia që fjalët e saj vinin era myk, si fletët e ndonjë libri të moçëm.)

— ... Më besoni, duhet ta takoj patjetër. E ndiej që Xhani ka nevojë për mua, më kërkon si një i etur ujin, po thirrjet e tij nemiten si lutjet e eremitit në shurdhësinë e shkretëtirës. Ora ishte katër. S'mund të flija dot më. Ænkthi më ligështonte aq sa mezi ngopesha me frymë, si astmatike. Me një padurim të paprovuar kurrë më parë prisja e prisja të zbardhte që t'ju tako-

ja. Diçka më shtrëngonte rreth qafës, ndërsa mendimet më kacavareshin si merimanga dhe më kallnin datën, në vend që të më qetësonin dhe të më kthjellonin trurin.

Maria — Luiza heshti. Ilirit iu duk aq e lodhur dhe e zbehtë, sa me keqardhje mendoj se nuk do të ishte në gjendje ta shpinte deri në fund atë që kishte nisur. Megjithatë ajo foli rishtas, me një zë që nuk tingëllonte si i saj.

— Nuk jam aq mendjelehtë sa të mos e di që këto hapje zemrash e shfrime patetike ndjenjash janë një idiotizëm me brirë. Singeriteti është një grackë ku bien naivët dhe të dobëtit. Unë s'jam e tillë, për këtë të jesh i sigurt. Sidoqoftë nuk duhet të harroni një gjë; çdo femër, kur dashuron, dhe kjo s'ka moshë, është shpirtgjerë dhe e zonja të sakrifikojë. Shpjegohet shumë thjeshtë. Vetëm kur dashuron dhe dashurohet, njeriu ndien që ekziston, sepse atëherë perceptohet shpirtërisht se ai nuk është gjë tjetër veçse shpirt. Çdo mënyrë tjetër e gjalluari për mua s'është veçse vegjetim. Nuk është aspak e tmerrshme kur s'e ke diçka që dëshiron, por kur e ke dhe e humbet. Uroj që të mos ju ndodhë një fatkeqësi e tillë.

Ilirit iu kujtua Linda dhe zënka e një nate më parë në telefon. Mos vallë edhe unë jam duke humbur diçka pa e kuptuar? U drodh dhe pa rreth e qark vetes. Në një pikë hasi në shi-

kimin e Maria — Luizës që ngjante sikur po lyp-
te pa kurrfarë skrupulli.

— Nuk e di, zonjë, çfarë mund të bëj për
ju?

— Më ndihmoni të gjej Xhanin, ju lutem.

Si në dialogët e romaneve të Barbara Kartlan-
dit, tha ajo me vete dhe u orvat të hamendë-
sonte se kujt prej personazheve të saj mund t'i
ngjante.

— Çfarë? Talleni?

Iliri qeshi me zor.

Maria — Luiza ngriti kokën pak më lart nga
pozicioni normal dhe lapat e gushës iu drodhën.
Ajo sikur e ndjeu në çast këtë gjë dhe u kthye
në qëndrimin e zakonshëm.

— Mos vallë fytyra ime ka marrë një shpre-
hje aq vulgare?

Iliri iu shmang vështrimit të saj, rrëkëlleu një
gotë me ujë, me ndjesinë sikur po pinte ilaç
dhe tha:

— Zonjë, është e pamundur. Është njëloj si-
kur të më kërkojnë të gjej varrin e Aleksandrit
të madh. Jo vetëm s'e njoh personin që thoni, po
ju s'jepni asnjë të dhënë, qoftë të dorës së dy-
të, për t'u orientuar. Përveç të tjerash, kjo gjë
kërkon kohë dhe ju e dini fort mirë që unë jam
i angazhuar tërë ditën me grupin tuaj.

— E kuptoj, për ju është një angari, prandaj
jam gati t'ju paguaj.

Iliri shtyu zhurmshëm karrigen mbrapa.

— Unë s'jam detektiv privat. Në qoftë se do

të më shtynte ndonjë ndjenjë t'ju ndihmoja, ju siguroj që kjo s'do të ishte kurrësi interesi.

— Maria — Luiza rrëmbeu çantën që e kishte varur te shpinëza e karriges dhe zuri të rrëmonte në të.

Po qe se do të ngulë këmbë që të më japë para, do largohem pa ia zgjatur, tha Iliri me vete.

Ajo nxori një fotografi të vjetër, të zverdhur, të grisur në një cep dhe ia zgjati duke e parë në sy, me një vështrim përgjërues. Fillimisht ai nuk po merrte vesh kurrgjë. Gishtat dhe fotografia vibronin lehtë, ndonëse ajo sforcohej ta kontrollonte veten.

— Kemi dalë ditën që jemi fejuar, — tha ajo zëdrithëruar.

Iliri shtriu krahun pa lojtur nga vendi dhe e kapi fotografinë me majat e gishtërinjve, me një vetëcensurë të përsosur, në mënyrë që asgjë të mos i linte përshtypjen së huajës se ai ishte kureshtar më tepër se ç'duhej, ndonëse e vërteta qe krejt e kundërt. Dhe vërtet, në dukje ai të linte përshtypjen e njeriut që zor se mund të befashohet.

Dikur fotografia ishte prerë mes për mes. Me sa dukej, të dy copat (njëra ishte më e zhu-bravitur se tjetra, «si surrati i ndonjë plaku të rëgjuar», mendoi Iliri) ishin montuar më vonë, me ngjitëse të tejdukshme. Me një farë shprese

të vagullt nisi të hetonte fytyrën e Xhanit, mos haste në të tiparet e ndonjë të njohuri.

— Me Xhanin jam njohur rastësisht në një hipodrom. Deri më atë ditë unë i ndaja meshkujt në tri kategori. Në të parën hynin ata që s'i njihja, në të dytën ata që i kisha frikë dhe i urreja, në të tretën, ata, për të cilët ëndërroja. Përveç disa aktorëve të kinematografisë vendet e tjera në këtë kategori ishin të lira. Kështu që Xhani, me atë taktin e vet të shkëlqyer, më afrohet dhe më thotë: «Zonjushë, po qe se doni të fitoni, vini bast për numrin katër, Luleshqerrën». Dhe a e dini, fitova me të vërtetë. Atëherë, bashkë me një mikeshën time vendosëm ta gostitnim mirëbërësin. Pak të druajtura, — sepse për ne ai qe ende një i huaj, — i bëmë ftesën, të cilën ai e pranoi me kënaqësi dhe pa humbur kohë shkua në një restorant modest, aty pranë, të drekoheshim. Sapo mësuam që ishte shqiptar, ia shkrepëm gazit tok me të njohurën time për atë ko incidencë fantastike dhe me lot ndër sy, duke ndërprerë njëra-tjetrën, i shpjeguam Xhanit të pataksur se ç'ironi e fatit kishte qenë takimi ynë, ngaqë atë ditë isha rrëzuar në gjeografi se në provimin e fundvitit i pata cilësuar shqiptarët fis indigjenësh të Amazonës. Më pas na tregoi që studionte për avokaturë dhe që kishte një pasion të jashtëzakonshëm për hipizmin. Pas një muaji u fejuam. Ishte një dashuri me shikim të parë. Zemra ime ishte mbytur në kaltërsinë e syve të tij. Në qoftë se do

të më lejohej të perifrazoja një shprehje të shenjtë, do të thosha: «S'është femra që e komandon trurin e saj, po mashkulli.»

Maria — Luiza e fotografisë ishte një krijesë e pastër dhe e brishtë, të cilën sikur e paktësonte zbehtësia e fytyrës. Ndonëse mënyra e të krehurit dhe kapela me pupël që mbante në kokë qenë demode, bukuria e saj nuk çenohej nga ai anakronizëm.

— Kushedi sa e shëmtuar që dukem!

Iliri dëgjoji zërin e Maria — Luizës dhe i ngjau sikur vinte nga larg, shumë larg.

— Aspak ... përkundrazi, — tha Iliri, duke e shqitur vështrimin nga fotografia dhe duke parë përballë, si të donte të bënte krahasimin me origjinalin. — Jeni krejt ashtu siç ju përfytyroja ... — dhe në çastin e fundit, mendjeprishur, nuk e shqiptoi fjalën «e mrekullueshme».

— Mbaj mend që për ne vajzat atë kohë ishin në modë tri mënyra të ndryshme të krehuri, gjatë ditës, ndërsa për gratë mbajtja e parukave. Ato më ekstravagantet i ndërronin tri herë në ditë. Në mëngjes mbanin parukë të zezë, mbasdite ngjyrë gështenje dhe në mbrëmje parukë bionde.

Xhani iu duk Ilirit tepër i spitulluar dhe shik. Flokët e krehur lart dhe të lëpirë, që feksnin nga brilantina, mustaqet e holla spic, fytyra e bardhë, e lëmuar si e pudrosur; bënin që të dukej i largët (si në një fotografi varri të vjetër, kishte thënë më vonë Iliri). Por ajo

që i ngeli në mendje, ishte vija ndarëse e flokëve mu në mes të kokës, që ngjante sikur e kishte hequr me vizore. Nga kjo rregullsi e patëmetë Ilirit i lindi përshtypja sikur ai njeri kishte pasur ndonjë tutor të pamëshirshëm, që mëngjes për mëngjes i rrinte mbi kokë derisa të përfundonte ritualin e pispillosjes. Në të vërtetë kjo ndjesi lidhej me fëmijërinë, kur e ëma e «torturonte» me krehrin e saj (Ilirit i kujtohej ende fare mirë, ai krehër me dhëmbët rrallacukë të gjatë e të mprehtë, sikur t'ia kishin shkukur ndonjë përbindëshi). Në lodrat marroke të fëmijërisë krehri do të gjendej gjithmonë ose në arsenalin e armëve luftarake, ose në koleksionin e veglave të xhelatit, shkurt, të mjeteve që shkaktonin dhembje.

— Për fatin tim të mjerë kjo histori dashurie zgjati sa ç'mund të zgjasë një ëndërr. Një femër e bukur është mallkimi i Zotit, thoshte im shoq me cinizëm. Sot, kur i shoh gjërat me binokël, nga lartësia e moshës dhe i gjujoj pa pasionin marramendës të atyre viteve, them që s'mund të ndodhte ndryshe. Dashuria është përjetimi i një çasti, kur ngrihesh nga toka dhe qëndron pezull në ajër, Kohëzgjatja e këtij fluturimi, le ta quajmë kështu, ndryshon, megjithatë do të vijë një kohë kur ti, detyrimisht, do të kthehesh në tokë, për të jetuar si turma të përditshmen, të rëndomtën, vulgaren që të ofron jeta tokësore. Me sa duket, edhe dashuria i nënshtrohet ligjit të gravitetit...

Ajo e ndërpreu ligjëratën sa për t'u mbushur

me frymë. Iliri pati përshtypjen sikur oksigjeni për mushkëritë e saj të lodhura ishte tepër i rraluar në atë vend.

— ... Prindërit e Xhanit ishin të pasur, të paktën sipas fjalëve të tij, por aq më bënte për pasurinë e tyre, që për mua asokohe s'qe veçse një nocion abstrakt. Doja vetëm Xhanin dhe kjo më mjaftonte. Ju dukem pak anormale, ëë?

(Ajo qeshi dhe e pa Ilirin në sy, por menjëherë e shkëputi vështrimin dhe vijoi:)

— Tani që e kujtoj, më vjen turp nga vetja. Vërtet, si mund të dashurojë njeriu ashtu? Dikur kam lexuar që te gruaja gjenden në të njëjtën kohë dy demonë, djalli dhe engjëlli. Kur fle njëri, zgjohet tjetri. Tek unë, me sa duket, engjëlli duhej ta kishte dendur me luminal djallin, se ai nuk zgjohej kurrë. Mbjaj mend që më kishte premtuar se verën e atij viti do ta kalonim në Shqipëri, në vilën e prindërve në plazh. Aty do të kisha rast të njihesha edhe me familjen. Një javë më vonë i erdhi një letër nga shtëpia. Nuk e mora vesh kurrë se çfarë i shkruanin. Xhani më tha vetëm «Duhet të kthehem urgjentisht për disa çështje të ngutshme familjare». Unë zura të qaja e shtyrë nga një parandjenjë ogurzezë, ndërsa ai më betohej e stërbetohej që midis nesh s'kishte ndryshuar asgjë, se do të kthehej shumë shpejt dhe s'do të ndaheshim kurrë më e... kush i mban mend gjithë ato fjalë të bukura. Më kujtohet që e ndërpreva dhe ashtu e ngashëryer siç isha, i

thashë: «Pse bën be të kota? Kjo është një ngasje, ku të shtyn Fryma e Ligë, kështu thotë Zoti ynë Jezu Krishti.» Ai ngeli pa gojë dhe atë moment besova, me të vërtetë besova që Xhani do të kthehej, jo dhe aq nga premtimet e tij sesa nga fjalët e shenjta që thoshin: «Veç për këtë punë ai do të braktisë të atin me të ëmën dhe do t'i shkojë pas gruas së tij, edhe të dy do të jenë një trup e një shpirt.» Dy ditë më pas Xhani u nis dhe që nga ajo kohë nuk e kam parë më. I dërgova disa letra radhazi, po s'mora përgjigje. Më pas filloi lufta, rrugët u mbyllën dhe në shpirtin tim nisi të venitej shpresa se mund ta shihja përsëri.

Kishte nisur dimri polar i dashurisë, tha Iliri me vete.

Maria-Luizës iu ngjir zëri dhe u kollit. Në bebëza i kishin mbetur dy zjarre të vegjël e të largët, që s'ngrohnin prej kohësh.

Iliri e ktheu fotografinë nga ana tjetër dhe lexoi fjalët e shkruara me stilograf boja e të cilit tanimë qe zbardhëlyer.

«J...ni Nelk...

Më pas vijonin ca gërma të shprishura, krejt të palexueshme, si dhe një datë 193... për numrin e fundit nuk qe dhe aq i sigurt, tetë apo nëntë.

Ia zgjati fotografinë Maria — Luizës. Ajo e mori me delikatesë, me gishtat e hollë nervozë dhe e përkëdheli portretin e Xhanit, duke i hedhur një vështrim të trishtëm e të përmalluar. Çuditërisht bashkimi i tyre, sipas një for-

mule të mistershme, jepte një element të tretë, dashurinë, që ajo jo vetëm që s'mundohet ta fshihte, por, përkundrazi, orvatej ta bënte sa më të dukshme. Lëvizjet e saj të ngadalta dhe plot përkushtim iu dukën Ilirit si një rit i lashtë, gjysmë mistik.

Plakë e dashuruar, tha Iliri me vete, ç'të shtyn të ngrihesh dhe të vish nga fundi i botës? Sentimentalizmi yt i mahisur, si apendicit, për të ringjallur një dashuri që varrmihësit vite e kanë groposur dhe as që e kanë çarë kokën t'i vënë një shenjë mbi varrin e mbuluar nga harrësia? Sikur të ma kishin treguar me gisht, do të gajasesha dhe nuk do ta besoja, kurse tani e kam para syve dhe prapëseprapë më duket e pabesueshme, fantastike...

(Nga kumbimi shurdhues perbrenda tij rendi i gërmave u prish dhe fjala mori trajtë e kuptim tjetër, diçka si «fantazmike»).

Me një dyshim që heshtja e Ilirit ia shtonte, Maria — Luiza tha:

— Mos më kujtoni aq naive sa të ushqej ndonjë iluzion se Xhani ka ndenjur beqar për të më pritur. Jo, nuk kam pikën e dyshimit që është martuar. Megjithatë e vërteta është se me atë që dashurojnë, njerëzit martohen vetëm nëpër filma. Dashuria në thelbin e vet është ndjenjë, diçka jotokësore, kësaj është absurditet i pashembullt të thuash që martesë na qenka përfundim logjik i saj, sepse në vetvete, ajo s'është gjë tjetër veçse një akt juridik, pra një

kontratë e përlogaritur me saktësinë e një mendjeje të esëllt dhe e nënshkruar me gjakftohtësinë e një dore që s'di të dridhet kurrë. Ç'llomotis edhe unë kështu! Më falni se ndoshta po ju mërzit, veç kur mendoj që ai ka fëmijët, gruan...

(Ilirit iu duk sikur ajo e griu mes dhëmbëve fjalën e fundit, para se ta nxirrte nga goja.)

— ... në jetën e tij e di që s'kam të drejtë të përzihem, megjithatë dua ta shoh edhe një herë, të vetme. Kohët e fundit kam qenë e përndjekur nga parandjenja se vdekjen e kam pranë si hijen, prandaj kjo është dëshira e fundit ose, më saktë, kërkesa e fundit që kam nga kjo jetë e pafat. S'besoj se jam tepër pretencioze?

Tani duhet të derdh lot që skena të bëhet sa më bindëse dhe veç atëherë madam Kartlandi mund të jetë krenare për mua, ashtu si për çdonjërin prej heroinave të saj, mendoi Maria — Luiza.

Si gjethe vjeshtake, fotografia i rrëshqiti nga gishtat dhe ra në dysheme. Ajo i hodhi një vështrim të trembur dhe lutës. Ai u përkul me të shpejtë sikur të donte t'i shpëtonte shikimit të saj, e ngriti fotografinë dhe e la mbi tryezë, Maria — Luiza e mori dhe e futi në çantë. Paskëtaj ndezi një cigare dhe e thithi me ashk. Lapat e faqeve iu rrufitën dhe iu ngjitën pas eshtrave të fytyrës, duke e treguar tmerrësisht të dobët.

— Më falni që ju shpenzova një pjesë të

kohës. Ndoshta sot në kohët moderne dashuria është një anakronizëm.

S'më duket ashtu, u mat të thoshte Iliri, i shtyrë thjesht nga dëshira për ta qetësuar dhe jo sepse e kishte vrarë mendjen duke medituuar rreth këtij problemi dhe kish formuar ndonjë mendim të tijin, por atë çast dera e barit u hap e hyri ashensoristi.

— Mori Veri në telefon nga parku dhe tha se e kishte rregulluar autobusin dhe po nisej.

Iliri pa nga Maria — Luiza.

— Duhet të ngrihem, — i tha.

Ajo nuk reagoi. Vështrimi i endej si një genie e hutuar që as vetë nuk e ka të qartë ç'kërkon dhe pse e kërkon.

— Mund të nis që sot të interesohem për Xhanin, — tha Iliri. Në nuancat që i dha zërit, kishte diçka nga lutja e dinakëria e të rriturit që bën çmos t'i mbushë mendjen fëmijës kokëfortë që ka ndaluar në mes të rrugës e s'lëviz nga vendi pa ia përmbushur trillin. — Jua them singërisht, — shtoi dhe u skuq.

— E di, — tha Maria-Luiza dhe bëri një përpjekje të mundimshme që të vinte buzën në gaz.

— Juve ju besoj.

Në sytë e saj ishin shuar zjarret e vegjël, të largët që u jepnin shkëlqimin. Orvatja për të buzëqeshur i zhubraviti fytyrën duke rrënuar magjinë e natës.

Në holl Ilirit iu faneps rishtazi ndjesia e harrësës apo e humbjes së diçkaje që kurrësi s'po ia dilte ta ndërmentde. Por e gjithë kjo zgjati fare pak, deri në momentin që iu afrua sportelit, ngriti receptorin e telefonit që ishte mbi banak dhe formoi numrin.

— Alo, Muzeu?

— ...

— Lindën desha pak, ju lutem.

— ...

— Ej, Liro, di gjë si i thonë sallatë marule në anglisht?

— Letis.

— Sii?

— L-e-t-i-s.

— Rrofsh, se më shpëtove. Ej, ej, se desh harrova, po kripanikut?

— Alo, Linda? Liri.

— Ej, ej, edhe këtë fjalë, të fundit, dhe ika.

— Linda, një minutë... E ç'të duhet, anglezët nuk e përdorin kripën. Megjithatë mësoje që ta dish për kulturë, solt — sellë. Tani mbathja se s'kam kohë, pres autobusin, por më parë dua të mbaroj telefonatën.

— Ej, ej, mos u nxeh, se s'i dihet, ndonjë ditë mund të më biesh ti në dorë.

— Alo, Liri, kush është?

— Asgjë, asgjë, një tip që u jep leksione anglisht turistëve anglezë.

— Mos u tall.

— Jo, e kam me tërë mend.

— Kur do të niseni?

— Ja, sa të vijë autobusi.

— Liri, sa ditë kemi pa u takuar?

— Nuk e di, s'e mbaj mend.

— Vërtet?

— Vërtet, por jo në atë kuptimin që mund t'i japësh ti, por ngaqë më duket sikur ka kaluar një shekull dhe llogarite vetë tani, sa vite ka një shekull, po muaj, po ditë, po orë? Prandaj nuk e di. E ke të qartë tani?

— Liri, më fal, je shumë i mirë.

— E di.

— Sa i keq që bëhesh. Ke pirë cigare esëll sot?

— Mos më pyet asnjëherë që mos të të gënjej asnjëherë.

— Kur do të ktheheri?

— Brenda ditës.

— Të të pres? Do vish të më takosh?

— Pse, kur hoqën dorë nga puritanizmi ata të tutë?

— Varet si t'u paraqitesh.

— Me një kusht, po të më sigurosh që ai mjeku yt autopsist s'e merr hanxharin me vete në shtëpi.

— Shtëpia ime s'është morg.

— Mos ma merr për keq, bëra shaka.

(Në çast iu kujtua keqkuptimi që kishte pasur me Maria — Luizën për atë «shakanë e pa-tëkeq».)

— Liri, kam përshtypjen që je i lodhur. Pse nuk kërkon lejen?

— — Kam një ide më të mirë. Nuk do të shoqëroj më turistë, ky është grupi i fundit. Do të merrem me edukimin e fëmijëve. Si të duket si ide?

— Liri, nuk më mban mëri për mbrëmë?

— Pse? çfarë ndodhi mbrëmë?

— Të dua, jam e çmendur, mezi pres të të takoj.

— Të dua, jam i çmendur, mezi pres të të takoj.

— S'ke njeri aty pranë?

— S'ke njeri aty pranë?

— E kam seriozisht.

— E kam seriozisht.

— Të them të drejtën Liri, jam e lumtur, asnjëherë s'kam qenë kaq e lumtur sa sot.

— E çuditshme, edhe me mua po ndodh e njëjta gjë. Ndihmë, Linda, s'po më mbajnë gju-njët!

— Liri, dëgjo diçka të lezetshme. Kur s'të kam afër, bëj me vete kilometra të tëra dia-logësh, të fryrë me fjalë të bukura dhe shprehje të goditura aq sa ngandonjëherë më duket vet-ja si ndonjë heroinë melodramatike. E bukura është se gjithë kjo stërvitje s'më vlen për asgjë, ngaqë, kur puqemi bashkë, i harroj të gjitha dhe më duket sikur nxjerr nga goja vetëm budal-lallëqe...

— Rrofshin budallallëqet!

— Me ty s'bën dot njeriu një bisedë serioze. Një zot e di se ç'gjepura u këput turistëve...

— Ke dëshirë të të njoh me një plakë të lezetshme? Ka një histori fantastike. Kur të ta tregoj, jam i sigurt që ke për t'i derdhur lotët rrëke — rrëke më keq se ç'bën kur sheh filma...

— Vërtet?

— Jo, shoku Limoz, e presim, ende nuk ka ardhur.

— Alo, Liri, më dëgjon?

— Po, po, ju kuptoj shoku Limoz.

— Ëmë dhe ti, lëri këto gjëra tani...

— Sigurisht, do ta kem parasysh... Faleminderit, mirupafshim!

— Alo, Liri, prit...

— Pa diskutim, sa të kthehem, do të vij në zyrë t'ju takoj... Nesër besoj... Mirupafshim, faleminderit.

Iliri e uli receptorin dhe u kthye nga drejtori i hotelit.

— Ç'thoshte shoku Limoz?

— Asgjë. U interesua për punën e autobusit.

— Ëhëë, — ia bëri drejtori dhe mori për nga ashensori. — Kur do të niseni?

— Pas pak.

Me t'u larguar drejtori, ideja e parë ishte që të rimernte Lindën dhe ta sqaronte, por mjaftoi një vështrim i Maria — Luizës e cila po i rrinte kundruall, që Iliri të ndërronte mendje.

Ora 9.30

Sportelisti trokiti në derën e zyrës me të njëjtin respekt dhe seriozitet që e bënte kur ishte brenda drejtorit, ndonëse e dinte që ai nuk ndodhej aty. Trokiti rishtazi, këtë radhë pak më fort, por gjithmonë brenda kufijve të mirësjelljes dhe priti, i shndërruar në një vesh me gjatësinë 1,75 centimetra.

— Hyr!

Zëri që erdhi nga brenda, i ngjau me atë të drejtorit dhe kjo sikur ia dyfishoi sikletin. Me pëllëmbët e djersitura rregulloi flokët, u kollit mbyturazi dhe vetëm kur iu mbush mendja që ishte në rregull me paraqitjen e jashtme, përkuli dorezën, duke u përkujdesur që të mos bënte zhurmë dhe u fut në zyrë. Aty ishte vetëm një person, hetuesi. Ai po shkruante dhe nuk e ngriti kokën sikur ta merrte me mend se kush do të ishte. Sportelisti qëndroi dy hapa larg tryezës. I erdhi inat me veten që i kishin bërë

veshët, por tani s'kishte kohë për të vrarë mendjen, se hetuesi i hodhi një vështrim nga koka te këmbët, sikur ta shihte për herë të parë. Sportelisi i buzëqeshi pafajësisht, mendjeprishur për këtë «gafë» që kishte bërë (siç e quajti ai me vete hyrjen në zyrë) por tanimë ishte tepër vonë për një mbrapakthehu dinjitoze.

— Ah, ti qenke! — tha hetuesi. — Si është puna? Të është kujtuar ndonjë gjë e re?

— Dua të bisedoj me ju, — tha sportelisi, i bindur që po e niste bisedën në mënyrën më të keqe që mund të bëhej. Frazat që kishte parafabrikuar ndërkohë që gatitej të hynte, i harroi në çastin që hapi gojën.

Hetuesi i kishte ngulur sytë dhe po e kundronte duke pritur që tjetri të fliste.

— Ky më shikon sikur të jem ndonjë i pandehur, mendoi sportelisi.

— Po të dëgjoj, — tha hetuesi.

— ...Dua të iki..., të them të drejtën...

Gjithçka u pështjellua në mënyrë të pandreqshme.

— Po nga unë ç'kërkon, fletë-daljen? — tha hetuesi me të qeshur dhe, si hodhi stilolapsin mbi letrat e bardha, u mbështet në shpinëzën e karriges.

— Por ata sikur thanë që të mos largohem nga hoteli pa ju marrë leje juve.

— Mua? Vërtet? Kush?

Sportelisi picërroi sytë. Nuk foli. Iu duk sikur tjetri po e vinte në lojë.

— Unë do të fejohej me atë, vetëm me atë, edhe sikur të më duhet t'i bie mes për mes ferrit, — deklamoi papritur sportelisti.

— Çfarë?

Hetuesi u ngrit nga karrigia dhe tha me vete: «Mos u çmend?»

— Jo, jo, asgjë, — tha sportelisti, duke e mbledhur veten me të parë alarmin e tjetrit.

— Doja të thosha që, po nuk i dola sot në takim, ajo do të mendojë që e kam mashtruar, kështu që do të më duhet ta nis gjithçka nga e para.

— Cila është ajo? — e pyeti hetuesi.

— Më falni, e kam humbur fare, mos ma vini re. Duhet t'jua thosha që në fillim... Është Irena, e fejuara ime... ndonëse, të them të drejtën, ende s'e kemi shpallur... sot e kishim lënë. Nuk e ke idenë se, ç'fat ters që kemi pasur. Ngandongëherë më ngjan sikur na kanë bërë magji. Është turp ta them, po Irena ka shkuar edhe te një plakë, tip fallxhoreje, për t'u yshtur kundër syrit të lig. Ajo seç bëri me ca thëngjij që i shoi në ujë, kush i mban mend të gjitha. Do t'ju tregoj dy ngjarje të shkurtëra që, mos të më keqkuptoni për ato që thashë. — Nuk të mërzit?

— Jo, tha hetuesi. — Ulu! — Dhe i tregoi kolltukun.

— S'ka gjë, mirë jam edhe më këmbë. — Sportelisti heshti një hop dhe vijoi: — Para shumë vitesh me Irenën kam qenë në një pallat dhe në një klasë. Familjet tona kishin hyrje-dalje

dhe ne rrinim gjithë ditën bashkë. Njëherë, në orën e anglishtes, e mbaj mend si tani, ajo më dërgoi një poezi dashurie, që gjoja e kishte përkthyer. Në të vërtetë, mësonte anglisht me profesor në shtëpi, po kush i hante ato, e kuptova menjëherë që e kishte shkruar vetë. Për ta gjetur këtë s'më hynte dhe aq në punë mendja sesa zemra. Si përgjigje, i shkrova nga mbrapa letrës: «I love you» dhe ia nisa. Për dreq, letra i ra në dorë mësueses, një lëneshe të stazhionuar dhe që nga ai çast çdo gjë nisi të na shkojë mbrapsh. Kuptohet, ajo e shpuri në drejtori. Si masë e parë, u thirrën prindërit e të dy mëkatarëve, Adamit dhe Evës, e si përfundim atë natë im atë, që s'më kishte prekur kurrë me dorë, më bëri me rrip, në trup, dizenjon e pizhameve. Po e keqja nuk u vulos me kaq, avazin tamam do t'ia dëgjoja më pas. Pas dy ditësh Irena ndërroi klasën, në përfundim të semestrit ndërroi shkollën dhe në fund të vitit edhe pallatin. Është e kuptueshme, marrëdhëniet diplomatike ndërmjet dy familjeve tona u prenë. Nga çasti në çast pritej shpallja e luftës. Juve mund t'ju vijë për të qeshur, por s'e merrni dot me mend se ç'idiotizma kanë ndodhur atëherë. Prekje e telit të rrobave, thyerja e një xhami nga vëllai i Irenës, ankesa në këshillin e lagjes, kërcënime për hedhje në gjyq, kërkesë dëmshpërblimi e ku ta di unë s'çmund të sajojë fantazia e njeriut në këso rastesh. Që të mos e zgjat, s'kishim veçse pak që ishim puqur sërish me

Irenën. Që e donim njëri-tjetrin, as që diskutohet, por ende s'kishim deklaruar gjë dhe mua, sipas një logjike tipike burokratike, më duhej patjetër, deklarata për të qenë brenda. Një natë po e përcillja për në shtëpi, megjithëse ajo nuk donte, kishte frikë mos na shihnin bashkë. Te shkalla ishte errësirë. Një natë më parë e kisha thyer poçin. Sa hymë, para se të ndaheshim, e tërhoqa lehtë drejt qoshes, e mbështeta në mur dhe sa po bëhesha gati ta puthja, — përfytyroni, ishte puthja ime e parë, — Irena më thotë: — «Po na shohin.» Ktheva kokën dhe pushë një plakë me bastunin e ngritur si skeptër, që m'u shkreh: «Ju ka plasur cipa fare... do na prishni fëmijët». Mua më kishte ardhur në majë të hundës dhe, megjithëse Irena po më tërhiqte nga mënga që t'ia mbathnim, sa pa e njohur, ia ktheva: «Mos ki merak, gjyshe, se, nuk do t'jua njozosim moralin e pallatit. Vetëm më thuaj një gjë, ke bërë ndonjëherë dashuri fshehurazi?» «Lipsu tutje!» m'u kanos plaka me bastun, por ndërkaq ne ia kishim mbathur. Kur kishim dalë jashtë zonës së rrezikshme, me gojën që i merrej nga të dihaturit, Irena më tha: «E di se si m'u duk plaka me shkopin gati për të qëlluar, si ndërgjegja e prindërve të mi, që kishte marrë trajtë antropomorfe.» Nganjëherë, kur më vjen në majë të hundës, më kap një pesimizëm dhe i them vetes: aha, është e kotë, gjithmonë do të ketë diçka që do të dalë mbi forcat e tua, këmbënguljen tënde, kokëfortësinë, çfarëdo gjëje

që të bësh, o qyqar! Shpesh rri dhe e pyes veten: Ecën fati para njeriut apo ndodh e kundërta? Jua thashë këto se ju jeni vetë i ri dhe më kuptoni më mirë se kushdo tjetër,...

— Për mua mund të ikësh, — tha hetuesi dhe i hodhi një sy orës. — Po patëm nevojë, të thërrasim, megjithatë nuk besoj. Vrapo që t'ia kalosh fatit.

Nga hutimi, sportelisti harroi që ta përshëndeste. I ktheu shpinën dhe mori të dilte me ca hapa ngucaqë, të gjatë, si të druhej se mos tjetrit i prishej mendja. Kishte mbërritur te dera, kur...

— Dhe... — Sportelisti ngriu në vend, pa e kthyer kokën. S'po guxonte as të merrte frymë.

— Të trashëgohesh!

— Faleminderit, — tha dhe një buzëqeshje e kapitur, si ndonjë llambushkë e konsumuar, ia ndriçoi për një grimë fytyrën.

Kur hapi derën, mend u përplas me një burrë më të gjatë se vetja, flokëbardhë si në negativin e ndonjë filmi, veshur me kostum blu.

— Më fal, — i bërbëlti atij, — pa e ngritur kokën për ta parë në sy dhe nga dera përjashta, pa e kthyer kokën pas.

Flokëbardhi me kostum blu e ndoqi me sy një valëherë derisa humbi pas kthesës së parë të korridorit, duke thënë me vete, me njëfarë inati në kalim e sipër. Hiq drejt, hiq!

— Ç'qe ai tip, si i çakërdisur? — e pyeti hetuesin.

Dy ditë më parë. Drekë.

Tetori është muaji më kapriçioz; kjo gjë e bën të vështirë, në mos të pamundur klasifikimin e tij në një nga stinët e vitit. Në këtë përfundim mund të mbërrish duke u nisur edhe nga veshjet e njerëzve, mjaft që të bëhesh pak i vëmendshëm dhe t'i shikosh me këtë sy. Gjatë ditëve të tij, po të jesh i ngeshëm, mund të bësh sehir një paradë mode krejt të veçantë dhe, pa zënë ngoje shijet, të krijosh një ide pak a shumë të saktë për gardërobat e stinëve. Mund ta fillosh nga veshjet e lehta verore, me ngjyra të hapura që pak nga pak sikur nisin e marrin diçka nga fluiditeti dhe transparenca e ikjes, për të kaluar te xhakaventot pranverore pastaj te pardesytë elegante vjeshtake, të cilat, me atë hijerëndësinë e tyre, janë padyshim më të fisme se xhakaventot.

Iliri po ecte më nge dhe tani që po e mendonte këtë, iu duk më se e habitshme se si nuk i kishin kaluar kurrë më parë ndër mend të gjitha këto, kur njerëzit që endeshin poshtë e për-

pjetë bulevardit ngjanin po ata, si dje, sot dhe... Jo, jo, nesër nuk i dihet, i tha vetes. Pa orën dhe, sido që e dinte se e kishte disa minuta para, e shpejtoi hapin. Kërcitja gati metalike e këpucëve u bë më e thekshme dhe ia shtoi sikletin. Pas ca mbaronte orari zyrtar dhe shë-titorja përmbajtej prej valës së nëpunësve që dilnin nga ministritë. Deri te Muzeu i Shken-cave të Natyrës i duheshin edhe pesë minuta. Përfytyroi portretin e Lindës së befasuar dhe i erdhi për të qeshur. Pas pak, një imazh tjetër zuri të interferonte me të parin dhe atij iu fa-nitën sytë e mëdhenj të Maria-Luizës, me nuan-cën e ngahershme të trishtimit që endej në ta. Vështrimi i tyre e përndiqte vazhdimisht me përgjërime dhe lutje të heshtur, veç cytëse dhe shpirttrazuese. Kur hyri në oborrin e Muzeut, ndjeu t'i rrëshqitnin puçërzat e djersës që i ki-shin buisur në ballë dhe afshin e nxehtë që hovzoi nga këmbët dhe e kapërtheu të tërin, aq sa iu duk sikur pas një copë here prej tij nuk do të ngelej veçse një tog me hi, si ai që kishin shkapërderdhur te rrënjët e bredhit ku qe mbështetur. Edhe aty, nën hije, nuk ndjeu ndonjë-farë freskie. Duhma përvëluese e ndoqi pas si qen i tërbuar.

Fishkëlleu dhe priti, por më kot. Ktheu ko-kën sikur të qe kujtuar papritmas për diçka dhe pa biçikletën e kyçur, në vendin e zakon-shëm. Ngriti edhe një herë vështrimin, me një siguri që s'e kishte pasur madje as herën e pa-

rë, por kanatat e dritares, në atë palëvizshmërinë e tyre, i ngjallën një ndjesi të vagullt dyshimi, që prania e biçikletës ia përzinte, ndonëse ajo kthehej prapë e prapë, si e cytur nga njëfarë ligësie. Shkoi te dera, uli dorezën, por edhe ajo ishte e mbyllur. Trokiti fort dhe me pëllëmbën e mbështetur si strehëz te balli u afrua për të parë (aq sa mund të shihej) përtej një xhami akulli. Befas iu duk sikur njëri prej trupave të balsamosur zbriti nga platforma ku e kishin vendosur dhe duke ecur rëndë-rëndë, me gjymtyrët e mpira, po vinte drejt tij të hapte derën.

— Ah, ti qënke! — tha plaku që ruante Muzeun, pa i lënë kohë Ilirit të fliste, në të vërtetë, duke i bërë nder që ia shkarkoi në çast, vetvetiu, barrën e pakëndshëm të shpjegimeve: kush ishte, kë kërkonte etj., etj. — Linda është në drejtori. Seç kishin një mbledhje, të shkurtër, ma do mendja.

Sakaq Ilirit iu kujtua që ishte takuar edhe një herë tjetër me plakun. Kur i kishte njohur, Linda kish thënë: «Gjyshi im, punon për vitin 2000.»

— Po deshe, hyr dhe prite këtu brenda, se është freskët...

(Si në varr, tha Iliri me vete).

Atëherë plaku i kishte treguar vetë, pa e pyetur kush, se, ndonëse e kish moshën për të dalë në pension, nuk e fitonte të drejtën, ngaqë i mungonte vjetërsia në punë.

— Nga dera. Nuk e di, në qoftë se keni ndonjë sistem tjetër hyrjeje dhe unë paskam shkelur rregullin, atëhere ju kërkoj ndjesë dhe jam gati ta ndreq këtë çast.

Ajo i hodhi një vështrim mosbesues dhe mbeti një hop në mëdyshje, duke mos ditur si ta merrte gjithë këtë ligjëratë, si cinizëm mizantropi (i kishte rastisur të haste me tipa të tillë që endeshin nga njëra sallë në tjetrën, derisa vinte ora e mbylljes së Muzeut dhe atëherë dilnin pa u ndjerë, ashtu siç hynin, me një pendesë që ndihej në çdo hap të tyre) apo si trill të çastit të ndonjë adoleshenti (mustaqet dhe syzat e tjetrit mbeteshin një orvatje e pasuksesshme për të ngjarë më i madh nga ç'që në të vërtetë) që në atë kotësinë që e ndjek pasi ka lënë orën e mësimin, shfrytëzon çdo rast për të bërë pak humor.

— Jeni student, apo ...?

— Apo...?

— Doja të thosha: në punë?

— Pse, për ata që nuk janë në punë, nuk lejohet hyrja pa qenë të shoqëruar me prindër?

— S'thashë gjë. Isha thjesht kureshtarë të dija profesionin. Megjithatë jeni i lirë që të mos përgjigjeni. Një gjë e tillë nuk përfshihet në rregulloren e muzeut.

— Profesionin im është varrmihës.

Befas ajo filloi të qeshte zhurmshëm sikur rrokulliste gurë (vetëm e qeshur femre nuk

mund të ishte, mendoi ai) dhe Iliri pa gati me frikë nga xhamat e mëdhenj të stendave se mos ishin plasaritur.

— Më falni...

— Po sikur t'ju thosha që jam kloun, kishit për të qarë?

— Ka të ngjarë.

— Që kur kështu ciceronët kanë filluar të pyesin vizitorët, në vend që t'u shpjegojnë?

— Ah, faleminderit që më kujtuat detyrën... Tani, fëmijë të dashur, do të kalojmë në një sallë tjetër, në atë të shpendëve të balsamosur. Kjo që po shihni, është dallëndyshja e natës, emri shkencor i së cilës është Kaprimulus Europaeus. Dallëndyshja e natës, siç mund ta kuptoni edhe nga emri, është një shpend që del vetëm natën dhe ushqehet me insekte. Ky tjetri këtu është hutini me veshë, ose, siç quhet ndrysh, Bubo, Bubo...

— Nga na dolën këta fëmijë të dashur?

— Pse çuditësh, vizitorët më të rregullt janë nxënësit e shoqëruar nga mësueset, që vijnë për të konkretizuar mësimin e biologjisë. Njëherë ka ardhur edhe një çift, po dashnorët e shkretë të përfunduan në rajonin e policisë, se i kapi drejtori në flagrancë duke u puthur, mbrapa skeletit të balenës. Sipas tij, akti i tyre kishte qenë një skandal i pashembullt në historinë e Muzeve, sepse kishin përdhosur tempullin e shenjtë të shkencës...

— Nuk ke frikë që edhe ne të dy mund të

ngjajmë si të tillë dhe kështu të lindë ndonjë keqkuptim?

— Oh, mua, aq më bën.

— Ai kishte ikur, por qe kthyer pas dy ditësh. Po qe se do t'u besojmë fjalëve që i kishte thënë cicerones, nuk kishte mundur t'i vizitonte të gjitha sallat e muzeut dhe, për t'ia dalë mbanë kësaj gjëje, iu desh plot një muaj. Veç, gjatë kësaj kohe ndodhi diçka që jo vetëm nuk përfshihej në programin zyrtar të vizitave, por, përkundrazi, ndalohej rreptësisht. Një ditë, ndërsa ajo po i tregonte një fosil të rrallë, ata qenë afruar ca si shumë, por, kur i patën thirrur mendjes, kishte qenë tepër vonë, tanimë e kishin përdhosur tempullin e shenjtë...

Atëhere ai kishte qeshur dhe shikimit të saj pyetës i qe përgjigjur:

— Ka qenë një kohë kur e vrisnim mendjen vetëm për futbollin, ndërsa vajzat na dukeshin si zogjtë, të pakapshme, ndaj as që e merrnim mundimin t'u afroheshim.

— Të të them diçka ashtu si e mendoj?

— Sigurisht, madje do të thosha se kjo duhet të jetë nyja e lidhjes sonë. Kushdo prej nesh, që zbulon se tjetri nuk e ka respektuar këtë... le ta quajmë kusht, mund ta zgjidhë nyjen a ta presë, si të dojë dhe është i lirë të largohet pa pasur kurrfarë detyrimi.

Ajo duartrokiti.

— Bravo! Nuk ke ç'thua, ja, kësaj i thonë demokraci e kulluar. Qofsha e gabuar, por kam përshtypjen që tipat si ty me femrat që u afro-

hen janë ironikë, të pandreqshëm, ndërsa me femrat që bien vetë në dashuri, sidomos me shikimin e parë, ata i idealizojnë, krijojnë në kokë manekinë, të cilët nuk kanë asgjë të përbashkët me figurën reale, madje ngandonjëherë as aparcencën. Drama e tyre fillon në çastin që e ulin manekinin në tokë dhe me një kokëfortësi që mbërrin deri në absurditet; orvaten ta identifikojnë me personin real. Pas kësaj vjen zhgënjimi, që shpesh ka simptomat e një lëngate, pa shpresë shërimi. Por vjen një ditë dhe, të habitur, ata vënë re që e ndiejnë veten për bukuri dhe pikërisht atë ditë betohen: «Kjo ishte hera e fundit që rashë në dashuri.» Por dihet, premtimet harrohen më kollaj se çdo gjë tjetër dhe pas ca kohësh gjithçka nis nga e para. Trala-la. Ah, edhe një gjë. Mos më pyet se ç'më shtyn te ti, kur i dija të gjitha këto. Kjo është e drejta ime dhe këtu nuk lejoj njeri, kushdo qoftë, të futë hundët.

Është e kuptueshme, ajo që i kishte pëlqyer më pak (për të mos thënë hiç fare) nga fjalët e saj, ishte e vërteta.

Por atë që nuk kishte mundur ta vlerësonte atëherë, po e çmonte tani, fill i vetëm në pavijonin e fosileve dhe të kafshëve prehistorike, duke pritur Lindën.

Ku i dihet, ndoshta ishin ato fjalë që e bënë tokësore dhe jetëgjatë lidhjen tonë, tha Iliri me vete.

Ndërkohë nga korridori, me një intensitet që

sa vinte e rritej, erdhën kërcackat e hapave të Lindës. Ilirit iu duk pak e çuditshme që ajo nuk po e bënte rrugën me vrap, si herët e tjerë, po shumë shpejt e harroi, i ngazëllyer nga ideja që e pushtoi të tërin. Në majë të gishtave, iu afrua platformës ku ishte skeleti i një orangutangu, hipi mbi të dhe mori të njëjtin qëndrim, si mostra. Hapat po afroheshin me rrapëllimën e një regjimenti në marshim. Pas pak Linda u shfaq te hyrja e sallës dhe, kur e pa, përkundër të gjitha hamendjeve të tij, tha:

— Në të vërtetë, në atë pozicion duhej të më gjeje mua. Nuk e ndien që kam filluar të vij era formalinë, si eksponatet e balsamosura? Liri, kam frikë se ke rënë në dashuri me një mumje... më vjen keq për ty, i dashur, se je ende i ri...

Dhe buzëqeshi. Ai kishte ngrirë mbi platformë dhe vështrimi i tij i xhamtë, i dha ngjyrë gazit të saj.

— ... Ngandonjëherë, kur ndihem e vetmuar, pyes veten: ku ndryshoj nga këto krijesa fatkeqe? Vetëm që eci, flas, ha? Vërtetë, mjafton kaq pak për të qenë ndryshe?

Iliri zbriti dhe iu afrua. Një çast nuk u besoi syve, kur vuri re lotët e saj të rrokulliseshin si ortekë të vegjël, por mosbesimi, ai i vërteti, kishte qenë diku thellë, brenda vetes së tij.

Si ka mundësi, tha, duke i zgjatur shaminë, ç'do t'i ketë ndodhur?

Sikur të kishte kaluar një ditë prej asaj gjen-

djeje emotive, Linda tha, me qetësinë më të madhe:

— Isha në drejtori...
(dhe, pa i lënë kohë atij të thoshte «e di», vijoi:)

— ... dhe paraqita një kërkesë me shkrim, të parevokueshme, siç thuhet në këto raste, për t'u larguar nga Muzeu, nga ky «vend pëllumbash», siç thoshte im atë, duke harruar të shton-te: «të balsamosur».

— Çfarë?

— Tani jam e lirë. Të lutem mos më moralizo që do të më kushtojë shtrenjtë, se ia di fort mirë çmimin... Nuk e ke idenë se çfarë mrekullie që është.

— Mezi po pres që ta shijoj edhe vetë.

— Përfytyro sa bukur duhet të jetë, kur e nis gjithçka nga e para...

— Të besoj, se në njëfarë mënyre ne jemi të gjithë njëloj, lindur dhe rritur në klimën artificiale të serrës familjare.

— Unë dhe ti, vetëm...

— S'më pëlqen kjo fjalë. Njeriu s'mund të jetojë dot vetëm...

— Paskam një uri të tmerrshme. Nuk e di ç'do të jepja për një pite dhe një arançatë.

— Mbylli sytë dhe, kur të të them unë hapi, do ta shikosh të realizuar mrekullinë.

Iliri nxori nga çanta dy shishe arançata dhe qesen ku kishte futur pitet dhe ia ngeci ariut

te panxhat. Pastaj e mori Lindën për dore, e shpuri para ariut dhe thirri solemnisht:

— Abrakadabra okus — pokus... Thuaj me vete një dëshirë dhe, kur t'i hapësh sytë, do ta shohësh të realizuar.

Linda ngeli një grimë e pataksur, pastaj u kthye nga Iliri. Nga shprehja që i mori fytyra, ai e ndjeu që ajo i besonte dhe i kishte me tërë mend fjalët që po thoshte.

— Ti je prestidigjitori më i madh në botë, se mund të krijosh atë që nuk mund ta bëjë asnjëri nga kolegët e tu, as ai që e mban veten për më të madhin, ti krijove ose, më saktë, materializove dëshirën.

Dhe për një hop ai e jetoj iluzionin e qënies prestidigjitori më i madh i botës.

Linda e shkulloi shishen e arançatës, e ktheu me grykë poshtë, priti sa pikoi çika e fundit dhe tha:

— Të kujtohet, i dashur? Në këtë vend më ke vjedhur puthjen e parë.

— Si nuk më kujtohet, e dashur! Për atë vjedhje u dënova me burgim të përjetshëm.

— Liri!

— Ë?

— Po më halet një çokollatë...

(Në zhargonin e tyre donte të thoshte: «Dua të bëj dashuri»)

— Këtu? Tani?

— Pse jo? S'ka njeri përveç këtyre kukullave të mjera dhe xha Mistos që me tespihet e tij numëron ditët e daljes në pension.

— Më vjen keq, po shumë-shumë mund të të jap një karamelë... (të puthur).

— Jo, dua çokollatë, — tha ajo, duke u llas-tuar dhe i lidhi duart në qafë e iu kacavar pas trupit.

Në korridor u dëgjua një zhurmë të puthure sikur i hoqën tapën ndonjë shisheje.

Nçë copë udhë e bënë pa folur, të shoqëruar nga dialogu i pakuptimtë i hapave.

— E çuditshme, — tha Iliri me zë të ulët, sikur të fliste me vete. — Ti nuk mund ta marrësh dot me mend se si është tjetërsuar...

— Kush? tha Linda.

— Aq sa shpeshherë më duket sikur kam para vetes tjetër njeri.

— Për kë e ke fjalën? — Linda ndaloi.

— Për Maria — Luizën...

— Për kë?

— Për turistin.

— Ëhëë.

— Përfytyro, sillet si një çupëlinë që ka rënë për herë të parë në dashuri. Përpiqet të duket sa më elegante, e re, tërheqëse. Çdo ditë vishet ndryshe, krihet ndryshe, me një fjalë gjithçka tek ajo tani është ndryshe. Korteve të meshkujeve — dhe më beso nuk i mungojnë se vjen e m'i rrëfen një për një, — u përgjigjet me një shpërfillje të hapur, pothuajse fyese, si një aristokrate që fati e ka hedhur midis një turme

plebejsh të pacipë. Po ta dëgjosh me vëmendje, edhe zërin e intonon ndryshe. Unë që e njoh, ia dalloj nuancat e përkëdhelisë dhe të llastimit. Natyrisht, ky s'është veçse një autosugjestionim, rikthim iluziv në të kaluarën. Ngandonjëherë më kap gazi me qyqaren, por e përmbaj veten, se i ngelet menjëherë hatri sikur të jetë fëmijë.

— Nuk ka bisedë tonën që kjo Maria — Antuaneta...

— Luiza, — e korrigjoi Iliri.

— Ah, po, Luiza, — tha ajo, — që kjo Maria — Luiza jote të mos futë hundët. — Dhe shtoi duke e parë me bisht të syrit: — Është e bukur?

— Ka qenë.

Lindës iu duk sikur shqoi në zërin e tij nota keqardhjeje.

— Nga bukuria e saj tani kanë mbetur vetëm ca rrënoja, që mund të të ndihmojnë deri në njëfarë mase të krijosh një përfytyrim, edhe atë të vagullt.

— Si një qytet antik, — tha Linda.

Iliri ndaloi një hop, ndezi një cigare, ndërkohe që Linda e priti dhe pas pak ata vijuan të ecnin të kapur për dore.

— Po sikur të jetë ndonjë Mata Hari plakushja dhe shtiret si e dashuruar? — tha Iliri dhe befas pati ndjesinë sikur pyetjen e kishte bërë një i tretë.

Linda ktheu kokën nga tjetri për të parë nëse bënte shaka apo e kishte seriozisht. Por në fy-

tyrën e bardhë dhe të lëmuar të Ilirit s'kishte mbetur asgjë kompromentuese.

— Po ai tipi, mos është gjë Xhejms Bondi?

— Sikur ta njihje Jani Nelkën nuk do të habiteshe dhe aq.

— S'besoj të ketë ngelur ndonjë mostër të më çudisë aq shumë sa të më lejë gojëhapur.

— Pse, paska përfunduar evolucioni kështu?

— Për mua, po.

— Megjithatë kam zbuluar diçka që edhe fantazia më e shfrenuar s'do të mund ta trillon-te dot...

(Për herë të parë Linda po provonte me të vërtetë njëfarë interesi nga kjo bisedë).

—... Ky na qenka rasti i dytë që një femër e huaj kërkon të takohet me ish-të fejuarin e saj dhe ky person është i njëjti, i famshmi Jani Nelka.

Linda nxori një fishkëllimë të tejzgjatur.

— Fantastike, një grabitës dhe koleksionist zemrash...

— Përkundrazi, më se reale. Përveç emrit Xhani, atij i njihet edhe një tjetër; Zhan, që, tek e fundit, të dy, s'janë veçse variacione rreth emrit me të cilin e kanë pagëzuar. Me rastin e fundit, hartës së aventurave të tij erotike iu shtua edhe një vend i ri, i panjohur më parë.

— Sipas kësaj logjike tani s'na mbetet veçse të presim që në ardhmen të na prezantohet edhe si Joan...

— Ose Huan...

— Jashar...

— Ivan...

— Cian...

Qeshën. Kishin mbërritur te stacioni i autobusit dhe u përzien me turmën e njerëzve.

— Këtu banon? — tha Linda.

— Kush?... Aa, jo, jo. Në D.

— Punon?

— Në ndërmarrjen komunale. Nesër do të shkoj me turistët në D.

Njerëzit zunë të lëvrinin. Autobusi hyri në stacion. Linda e puthi shpejt në faqe dhe Ilirit iu duk sikur era i pëshpëriti te veshët: «Të dua».

— Më merr në telefon sa të kthehesh... të pres... të..

Kur dëgjoi uturimën e autobusit që u nis, Iliri doli nga shtjella e mendimeve, pa përqark dhe vuri re jo pa një farë habie të lehtë se kishte ngelur fillikat. Ndërmjet gishtave kishte duqin e cigares që qe shuar vetiu. Kjo e bëri ta ndiente më shumë vetminë sesa ikja e Lindës dhe vakuumi i njerëzve përreth.

Ora 9.40

— Një fatalist, — tha hetuesi me të qeshur. Qeshjen e hetuesit mjeku ligjor e quajti «dhëmbëzbardhje axhamiu». Ndryshe nga aparenca, ai s'ishte aspak njeri i rëndë, megjithatë, kur gajasja e ndokujt i dukej pa kuptim, si në këtë rast, atij i ngriheshin nervat. Hetuesi u pre kur pa që mjeku ligjor e kishte marrë tjetër për tjetër të qeshurën.

Kohët e fundit, kishte vënë re që shakatë e tij në rastin më të mirë kalonin në një heshtje, ku të pranishmit shtireshin sikur nuk kishin dëgjuar gjë dhe pas kësaj ndërronin temën e bisedës. Atëherë ai e ndiente veten të tepërt, si në atë lojën «kush e zë i pari karrigen», ku pas vrapit rretheqark do të ngelet gjithnjë dikush në këmbë.

— Sportelisti që njoftoi për vdekjen e turistës, — tha ai me një seriozitet të beftë dhe me ngutjen e njeriut që do të sqarojë me çdo kusht

keqkuptimin e pakmëparshëm. — Kishte ndodhur një ngatërresë që veç për të qeshur të bën kur e merr vesh.

— Ç'kemi ndonjë gjë këndeje nga ty?

— Nga dëshmitë e mbledhura mund të them se e kam krijuar një mendim, sidoqoftë duhet ta peshoj mirë, para se ta kristalizoj. Shefit s'i pëlqejnë romanet.

Mjeku u ul.

— Është për t'u çuditur, tërë kozmetikën e saj e gjetëm të hapërdarë nëpër dhomë. Në lavaman kishte cefla shishkash parfumi të thyera dhe pudër, kurse në WC gjetëm një parukë të grirë me gërshërë. Dhe ajo që e kompletonte këtë skenë, që të linte pa mend ishte pasqyra e shkarrëzyer fund e krye me të kuq buzësh. Dukej sikur kish dashur të linte një mesazh, por pastaj qe penduar dhe e kish shprishur. Për ideal, ca veprime që s'di si t'i shpjegosh, po qe se do të nisemi nga logjika e thjeshtë që kemi të bëjmë me një njeri sagllam nga trutë.

— E përfunduat ekspertizën? — e pyeti hetuesi dhe u kapërdi, sikur fjalët e tij të kishin qenë ca çapa të ndukur me pahir nga një panine bajate. Në të vërtetë, me këtë pyetje hetuesi kishte dashur t'i tregonte mjekut ligjor, se me gjithë diferencën në moshë dhe profesion, ai s'kish asnjë kompleks inferioriteti.

— Unë për vete mbarova punë. Pres të firmos procesverbalin dhe t'ia shkel. Për mua çdo gjë është e qartë, si drita e diellit, pavarësisht

se, sipas fjalëve të ekspertit kriminalist, fjalën e fundit dhe vendimtare e ka autopsia.

— Po eksperti... mbeti lart?

— Mos ma përmend se më zë koka. Ai njeri të çmend me pedantizmin e tij. Është burokrat i lindur.

Hetuesi qeshi, por u kujtua që tjetrit pak më parë i kishte ngelur hatri dhe u tkurr.

— Ndoshta është natyra e punës...

— Ti sa ke dalë nga veza, prandaj mos më trego mua natyrën e punës, se kam një jetë që punoj me të. Edhe në jetën private kështu është, tip maniaku... Ke cigare? Sapo i mbarova të miat.

— S'e pi.

Mjeku i rراسi duart në xhepat e pantallona-ve, pos s'kaloi shumë dhe i nxori. Dukej që s'dinte ç'të bënte me to.

— Ke gjetur biletë për sot?

— Jo. Me thënë të drejtën, nuk jam tifoz.

— S'e marr vesh. Në stadium s'shkon, cigare s'pi, vë bast që edhe gota s'të tërheq, ç'drejqin i shijon kësaj jete?

— Hetuesi mblodhi supet.

— Po dal të blej cigare.

Hetuesi e shoqëroi me sy derisa mjeku doli nga zyra. Paskëtaj, uli kokën dhe nisi të shkruante rrëmbimthi në njërën nga fletët e dosjes së hapur mbi tryezë. Kur hemorragjia e mendimeve i pushoi dhe fjalët iu mpiksën në tru, ndenji një valë herë pa lëvizur, me shikimin të

ngërthyer mbi atë që kishte shkruar. Dalëngadalë pamja iu shfokusua dhe gërmat i shembëllyen me ca insekte të zeza, lëkurëfeksura, që pak më parë gëlonin mbi shkretëtirën e bardhë të letrës. Pas një çasti ato ishin tharë e shndërruar në qenie pa jetë, gjymtyrëngrira e të kapërthyer me njëra-tjetrën. Hetuesi fërkoj sytë dhe pa orën...

dhur një vështrim në mugëtirat e lashtësisë...

Maria — Luiza nxori nga çanta çakmakun bashkë me paketën dhe ndezi një cigare. Ishte ulur në fund të autobusit, vetëm. Surreterit e atyre që kishte pranë (ajo me vete i quante «kope injorantësh») i kallnin krupë. I vinte ndot të merrte frymë në atë «stallë», ndaj e thithi, cigaren me ashk dhe shpërndau rreth e qark vetes një re tymi, si të donte të dezinfektonte ajrin. Fjalët e përkthyesit, sikur të shurdhoeshin gjëkund rrugës (një rrokje, dy a gërma të vetme) i vinin të mangëta. U zgjat pak dhe e mbajti frymën pezull...

— ...sipas dëshmimeve të autorëve të antikitetit, D. është një nga qytetet më të hershme të Ballkanit. Në vizitën që do të bëjmë në Muzeun Arkeologjik dhe në Amfiteatër, do të shihni atë që historianët dhe arkeologët e quajnë elokuenca e lashtësisë. Në shtresëzimet e kohëve antike qyteti ka pasur disa emra...

E ç'na duhet antikiteti, kur nuk njohim botën ku jetojmë!

Maria — Luiza ktheu kokën nga xhami i pluhurosur. Në lëvizjen e saj nervoze kishte një orvatje të dëshpëruar për të vendosur një kontakt sa më konkret, me botën që ndodhej përtej akuariumit, ku qe mbyllur. I hoqi syzet dhe i la t'i vareshin mbi gjoks, sikur ta kishte humbur besimin në to. Ideja e akuariumit dhe e shndërrimit në një qenie që rron në të, filloi ta terrorizonte. Pa mundur dot ta frenonte ima-

gjinatën, ajo zuri të përfytyronte procesin e tjetërsimit, daljen e luspave, rumbullakosjen e syve dhe hapjembylljen idioteske të gojës. Citosi rishtazi shikimin në dritaren e autobusit, duke bërë çmos të fotografonte çdo fytyrë mashkulli që mund të ngërthente kalimthi dhe ndërkojëta krahasonte me klishenë e vjetër të portretit të Xhanit, që e ruante në kujtesë prej pesëdhjetë vjetësh. E dinte fare mirë se kjo që po bënte ishte absurde, megjithatë, sikur të qe hipnotizuar nga marrëzia e vet, nuk hiqte dorë së vëzhguari njerëzit që shfaqeshin për pak sekonda dhe zhdukeshin si të qenë mirazhe. Në të vërtetë, kujtesa e saj nuk fiksonte më hiçgjë, ajo ishte si një xham, mbi të cilin, sado të rrëkëlleje kova me ujë, pas ca, pasi uji të kishte kulluar dhe të qe tharë mbi qelq s'do të kish mbetur asnjë gjurmë.

— ... Pozita strategjike e këtij qyteti, në hyrje të detit Adriatik, ka bërë që atë ta kenë lakmuar superfuqitë e të gjitha kohërave, që nga Roma e lashtë e deri...

Politikë... vetëm për politikë i dëgjon të flasin. Socializëm, diktaturë e proletariatit, imperializëm... Pëh, kotësira që vetëm truri njerëzor mund t'i pjellë. Për mua të gjitha sistemet një turi kanë, dhunën, veç maskat u ndryshojnë.

Çanta i rrëshqiti nga prehri dhe ajo u orvat ta kapte në ajër. Libri që ndodhej në të, i shpëtoi nga duart dhe u rrokullis përtokë. U përkul dhe, si e ngriti, i fryu ta shpluhuroste. Ish-te një metodë e vjetër për mësimin e gjuhës

shqipe, që e kishte blerë atëherë, kur qe fejuar me Xhanin. Nga kapakët e zverdhur prej nikotinės së viteve u shkëput një lule e tharë, petashuqe si fletët e librit, që vinte era myk. Ashtu si një kufomë e paprishur në një varr të vjetër që sapo hapet shpërbëhet menjëherë, lulja iu shkërmoq mes gishtave dhe u shndërrua në hi. Ajo e la të rrëshqiste përtokë, duke e ndjekur sypikëlluar.

«E ç'të duhet? — i kishte thënë Xhani me mospërfillje, kur ajo i kish treguar librin me një gëzim fëmijëror. — Një gjuhë që s'e flet askush në botë, përveç një kopeje fshatarësh. Të lutem, e dashur, a mund të më gjesh një metodë për çmësimin e kësaj gjuhe të shpifur?»

Maria-Luiza e futi librin në çantë.

— ... është interesant fakti se D. sipas statistikave të fundit, sot ka mesataren më të re të moshës së banorëve, kjo nuk është thjesht koincidence, por shprehje e vitalitetit të sistemit shoqëror...

Maria Luiza mbylli sytë sikur donte ta bindte veten se kësisoj jo vetëm që nuk shihte, por as dëgjonte. Në terrin dhe heshtjen artificiale, ajo sforcoi kujtesën dhe imagjinatën, për të sajuar identikitin e Xhanit (jo atij të parit, tani ai pak i interesonte, sepse s'ishte kush tjetër, veçse një i njohur i largët, i cili vetëm sa do ta prezantonte me të tanishmin) kuptohet, me grimin që do t'i kishte bërë koha.

Por, me gjithë përpjekjet e saj, në vend të

një portreti të plotë riprodhoheshin copëza, dhe këto shpesh të përçudura. Befas iu kujtua ëndrra makabre dhe i hapi sytë e tromaksur se mos papandehur i riprojektohej.

Më mirë të sjell ndër mend diçka tjetër, tha me vete.

Sidoqoftë frika e saj ishte e kotë, se prej ëndrrës kishin mbetur vetëm ca rrënoja, të cilat, ishte po aq e vështirë t'i restauroje, sa edhe gërmadhat e një qyteti antik.

As vetë nuk ishte në gjendje ta shpjegonte pse mendja i shkoi te letrat që i kish dërguar Xhanit, pasi ai kishte ikur. Fillimisht, ato kishin qenë ngjyrë rozë, dhe kjo, të thuash të vërtetën, ishte një luks që ajo ia kish lejuar vetes, veç për hir të pasionit. Me një shkrim të përsosur (s'lodhej së kopjuari disa herë me radhë) i përmendte ditët e lumtura që kishin kaluar bashkë dhe i shprehte atë ndjenjë padurimi «që e torturonte natë për natë me ëndrra të panumërta» për ta takuar dhe shtrënguar në krahe përjetësisht, sa më parë të qe e mundur.

Dashuria! (Ç'është kjo fjalë që më bën për të qeshur, u thoshte më vonë, në konfidencë miqve të vet.) I kujtohej që në një nga letrat e para e kishte shkruar tridhjetë e tri herë këtë fjalë. Veç ato kishin humbur si ca kasnecë besnikë që, me gjithë zellin dhe përpjekjet e tyre mbinjerëzore, s'ia dalin dot mbanë dhe nuk arrijnë ta kapërcejnë më të tmerrshmen e të gjitha shkretëtirave, atë të indiferencës njerëzo-

re. Ndërsa ajo rrinte e priste e qerthulluar gjithandej nga heshtja që i pikonte në shpirt dhe e mbushte me një vrer që i paralizonte ndjenjat dhe jo vetëm ato. «Mos kujto se lotët e mi janë më pak të zinj se këto pikla boje mbi letrën që po të shkruaj...». Ndonëse shpresëhumbur, ajo kishte vijuar t'i shkruante. Kjo gjë i qe kthyer në monomani, së cilës i kushtonte tërë kohën. Bashkë me tonin kishte ndryshuar edhe ngjyra e letrave. Më pas përdorte një kartë të verdhë, të blerë lirë te një bakall që e kishte dyqanin poshtë shtëpisë së saj. Në to i përgjerohej të kthehej, të paktën për hir të ferishtes që mbante në bark, përndryshe, do ta diskreditonte në sy të botës, duke u kallëzuar të gjithëve se cili qe surrati i tij i vërtetë, ai i një mashtruesi të fëlliqur vajzash të ndershme. E asaj kohe kishte genë ëndrra që kish parë një natë pasi qe rrëfyer («dëshërimi, si të mbarset, pjell mëkatin, dhe mëkati, me t'u kryer, pjell vdekjen», kishin genë fjalët e priftit).

«Asaj i ngjante sikur diellin e kishte mbi kokë dhe hënë të këmbët, teksa ulërinte nga dhembjet dhe mundohej të lindte. Në këtë kohë, në qiellin e natës qe fanitur një përbindësh, bishti i të cilit i fshihte yjet e i rrëzonte nga qielli. Paskëtaj ai kishte zënë vend pranë saj dhe ruante pjellën që kur të lindte ta hante. Por një engjëll kishte zbritur fluturimthi nga qielli, e kish rrëmbyer foshnjën dhe me të në krahë qe zhdukur, pa harruar që t'i jepte edhe

asaj një palë krahë për të shpëtuar nga përbindëshi.»

Foshnjën e kishte lindur të vdekur. Rreth qafës kishte patur një zorrë dhe mjeku gjinekolog që e kishte pritur, pati thënë: «sikur ta dinte ky engjëll i pafajshëm që ishte fryt i mëkatit dhe ka varur veten.» Paskëtaj ajo pati kaluar një gjendje të rëndë depresioni psikik. Më vonë, sa kish filluar ta ndiente veten më mirë, kish rinisur t'i shkruante në ca letra të bardha, të shqitura nga një fletore e vjetër shkolle, «të akullta si dimri që kam në shpirt», për mizerjen ku jetonte, për vetminë që, si shushunjat i thëthinte çdo ditë lëngjet e jetës, për luftën që s'i interesonte fare si një film i vjetër, aktorët e të cilit kanë vdekur prej kohësh, për ditën e Gjyqit të Shenjtë, kur ai do të përgjigjej deri më një para Zotit, për të gjitha mëkatet etj., etj. Çdo mëngjes zbriste shkallët e pallatit, për të hedhur në kutinë e ndryshkur e të brimosur nga plumbat letrat për Xhanin. Çdo veprim e kryente me seriozitetin dhe përpikërinë, me të cilat një besimtare fanatike kryen ritin, sido që e dinte fare mirë se letrat bëheshin kopicë e kalbeshin bashkë me hardhucat e ngordhura që kalamajtë i hidhnin nga e çara në fund të asaj që dikur quhej «Kuti Postare». Shurdhmemecëria e Xhanit kishte qenë e kobshme, dhe ajo me siguri që do të kishte vdekur shpirtsfilitur. Por ja, një ditë në qytet kishin hyrë amerikanët dhe dikush i kishte thënë se lufta kish

mbaruar, prandaj mund të dilte pa frikë në rrugë. Asokohe kishte nisur një jetë e re që në fillim e hutonte dhe e friksonte me rrëmujën e poteren marramendëse, por vetëm në fillim, pastaj dalëngadalë kish zënë t'i dukej zbavitëse, pa kokëçarje, si një çirk ku hyrja është falas. Konservat amerikane, plaçka amerikane, çokollatat amerikane, filmat amerikanë, muzikë amerikane, çamçakëzë amerikanë, cigare amerikane, pije amerikane dhe sidomos ata që ishin burimi i këtij bollëku, dashnorë amerikanë, të bardhë a të zinj, s'kishte shumë rëndësi.

Ashtu si qelizat kanceroze, që pa përjashtim gjenden në të gjithë organizmat e gjallë, por lulëzojnë vetëm tek ata trupa dhe atëherë kur e ndjejnë që klima është e favorshme, po kështu edhe te çdo femër mikrobi i prostituizmit...

Maria-Luizës iu bë sikur dëgjoi zërin e gërditshëm të burrit të parë.

Plakaruq i mjerë, edhe në varr nuk rri dot pa llapur, tha ajo duke u gërbuzur. Sidoqoftë, vetëm ty, njeriut që kam urryer më fort të mbetem mirënjohëse në këtë botë mosmirënjohësish, ku virtyti s'është veçse pare kallpe. Ç'ironi e fatit!

Disa ditë para se të vdiste (në kundërshtim me logjikën e deriatëhershme të trajtimit si një mbretëreshë sa për sy të botës, të cilën parlamenti jo vetëm që e ka zhveshur nga pushteti, por i numëron edhe çdo kafshatë) papritur, ai

kishte hartuar një testament të ri, ku thuhej (asaj i kujtoheshin ende fragmente, kuptohet se cilat:) ... Ia le gruas sime të dashur dhe besnike tërë pasurinë, të tundshme e të patundshme, duke pasur besim në shpirtmadhësinë e saj kristiane...» etj., etj.

Sipas koncepteve të saj, martesë ishte një vullëzim, ku partneri duhet t'i njohë në mënyrë të përsosur rregullat e kërcimit dhe pa dyshim t'i respektojë ato, përndryshe, po qe se do të nisin t'i shkelin këmbët shoshëqit, qoftë edhe pa dashje, askush nuk mund të garantojë më mbarëvajtjen.

Gjashtë muaj më vonë qe martuar me avokatin e familjes, tetëmbëdhjetë vjet më i ri në moshë se ajo. Sigurisht nuk munguan gojë e liga që e përfojnë martesën e re. (Pse, nuk janë Shkrimet e Shenjta ato që thonë: «Gruaja është e lidhur nga nomi për sa kohë që i rron burri, po në i vdektë, atëhere ajo është e lirë të martohet me cilin të dojë...» Pra, me cilin të dojë, dëgjuat? Me cilin të dojë! Madje duke bërë aluzion edhe për vdekjen e të shoqit, por sidomos, përgojuan autenticitetin e dokumentit të trashëgimisë. Veçse edhe në këtë rast «Fati, kjo pjellë bastarde, qe treguar i pamëshirshëm me të, si dhe herët e tjera», siç qe shprehur në rrethin e miqve më të afërt. I shoqi, i rishmartuari, qe vrarë në një aksident automobilistik jashtë shtetit «në rrethana të jashtëzakonshme dhe misterioze», siç i kishte thënë komi-

sari i policisë, që ishte ngarkuar të merrej me çështjen. Frazë që kishte ngelur përjetë enigmatike, ndonëse kish paguar dy detektivë privatë për të hetuar dhe hedhur dritë rreth ngjarjes. I pari ishte zhdukur e s'qe bërë më i gjallë, ndërsa i dyti ishte kthyer sa për t'i thënë nja dy fjalë që i patën kallur datën, aq sa edhe këtë çast i bëhej sikur i dëgjonte: «Zonjë, në qoftë se doni më shumë veten se një kufomë, mos rrëmoni më në këtë çështje të fëlliqur. Mos harroni një gjë, ne të dy nuk jemi takuar kurrë.»

Atë natë Satanai m'u shfaq i mbuluar me vëladonin e kuq të një kardinali dhe më tha: «Të gjithë ata që lakmojnë pasurinë, bien në lakun e ngasjes... i cili i shpie njerëzit në trupprishje dhe shpirthumbje, sepse rrënja e gjithë të ligave është ardashja.»

Ata që e kishin dëgjuar, e patën marrë si përçartje që vjen pas një vegimi biblik. Asokohe vdekjen e kishte ndier më pranë se këdo tjetër, ndaj kish marrë vendimin për të ndërtuar varrin dhe për të organizuar përshpirtjen e vet.

«Nuk doja kurrsesi që të më shpëtonte pa e parë, epilogu i jetës sime dhe veçmas isha kurreshtare të shquaja atë që, drita e jetës nuk mjaftonte për të ma zbuluar, por do të duhej terri i vdekjes dhe në laboratorin e tij, përmes lëngut opak të solucioneve (temjanit) do të

më fanitëshin fytyrat e miqve dhe armiqve të vërtetë.»

E mbuluar me një mantel të zi, ajo e kishte vëzhguar gjithë ceremoninë e tërhequr në gjysm-errësirën e qoshkës së një ballkoni.

«Për herë të parë m'u duk vetja si Perëndia».

Më pas kishte nisur udhëtimet nëpër botë. «Sikur të shkonin turistë në Hënë dhe në Mars, edhe për atje do të isha nisur», i kishte thënë së motrës, kur ajo i kish folur se po e bënte pasurinë rrush e kumbulla. Udhëtimet, lëvizjet, ngandonjëherë të befta e të pashpjegueshme, si të ndonjë të çekuilibruari, s'qenë për të shëtij-tje turisteje të ngeshme, që orvatet të shpenzojë kohën në mënyrë sa më të këndshme, por ikje, shmangie prej fantazmës së vdekjes që e përndiqte hap pas hapi, natën dhe ditën, zgjuar e në gjumë. Cenotafi i shfaqej në ëndrra si përbindësh tmerrkallës, i cili kërkonte flinë që i kishin blatur, për t'u qetuar.

Në kohën kur kishte filluar të ndiente se si metastazat e lodhjes po nisnin t'i mpinin çdo dëshirë për të jetuar dhe ajo po bëhej gati t'i dorëzohej përbindëshit, u njoh me një shortare të famshme.

«Shoh një shenjë në formë kryqi, e cila dikur të është mohuar, që Fati po ta kthen tani, pas kaq kohësh, veç jo këtu, as në vendin tënd, por diku gjetkë, tepër larg dhe për këtë ti do të ndërmarresh udhëtimin më të dëshiruar të jetës sate».

Atë natë nuk iu faneps në ëndërr cenotafi, po Xhani. Imazhi i tij e kishte zhdukur përbindëshin. Një shpirt i pastër dhe i panjolloshëm, kur ajo iu rrëfye, i tha që «...mos e merr si një ëndërr të rëndomtë, assesi, por si mesazh të Providencës. Më në fund, pas kaq e kaq privacionesh, Zoti po e gjykon të drejtë dhe po të kthen atë që, dikur ta kishte rrëmbyer Djalli. Drejtësia e tij mënon, por s'mungon.»

Pa humbur kohë (tani s'mund të falte as minutin), ajo u interesua në një agjenci turistike për kushtet e udhëtimit, në Shqipëri, bëri pagesën dhe me grupin e parë (për fat të keq, nuk lejoheshin udhëtimet me jahtin privat) u nis drejt vendit, për të cilin kishte ëndërruar ndoshta më shumë se çifutët për tokën e premtuar.

Gjithçka e përfytyronte, — është e kuptueshme —, në rrafshin spiritual, si një proces rigjenerues, që ajo e krahasonte me atë që ndodh në organizmin e femrës pas lindjes.

«Rruga purifikuese për një shpirt fisnik kalon përmes një kalvari vuajtjesh dhe sfilitjesh fizike e shpirtërore...»

Autobusi kishte frenuar krejt papritur. Për inerci, Maria-Luiza u zhvendos vrullshëm përpara. Hapi sytë e trembur dhe një copë herë vijoi të rrinte ndenjtur, me sytë e fiksuar në zbrazëtirën para saj, ndërkohë që turistët po zbrisnin.

— Mos jeni gjë pa qejf? — e pyeti Iliri, duke u përkulur mbi të.

— Pak e tronditur nga rruga, asgjë tjetër, — tha ajo dhe u ngrit me ndjesinë se në vend të këmbëve kishte dy trusgje mbi të cilët gëlonin mizat e dheut. Ndaj iu duk gati-gati një mrekulli kur zuri të ecte.

Jashtë, duke u çapitur nën atë diell magjepsës, i cili seç kishte diçka të vetën, sikur të qe i ndonjë sistemi tjetër dhe jo i atij ku ndodhej globi i tyre, asaj iu tretën si re të brishta mendimet e zymta që kishte pasur pak më parë në kokë. Peizazhi ishte fantastik me ato trille të mrekullueshme të natyrës për të kombinuar ngjyrat dhe ajo, pas një kohe të largët e pothuaj të harruar, ndjeu t'i hovzonte përbrenda dëshira për të pikturuar, siç bënte dikur, pas vdekjes së burrit të dytë, kur nuk dinte si të shtynte kohën dhe të përzinte vetminë. Ndonëse ata që bënin pjesë në rrethin e miqve (midis tyre qe edhe një piktor) i kishin bërë një lumë me komplimente, ajo nuk ishte aq budalloe sa të mos kuptonte se ata vepronin kështu, ngaqë e lypnin rregullat e kortezisë ose arsye të tjera, të cilat s'është vendi as koha t'i përmendim, dhe jo të shtyrë nga ndonjë ndjenjë respekti për talentin e saj.

Krijimtaria është në natyrën e njeriut, ashtu sikurse edhe frymëmarrja, u thoshte ajo miqve për të justifikuar më tepër fandakurinë sesa mungesën e talentit.

Natyra me ngjyrat e hapura e të gëzueshme i injektonte në shpirt eliksirin e rinisë së përjetshme dhe, shendeverë, ajo dëshironte që t'i vinin rrotull, t'i bënin komplimente, të llastohet, t'i përqeshte të gjithë, me pak fjalë, marrëzira pafund që ajo e dinte fort mirë se nuk i përshtateshin moshës dhe për më tepër pozitës shoqërore.

Në kundërshtim me çdo paragjykim social, për një moment turistët iu dukën simpatikë dhe të denjë për t'i bërë shoqëri.

— Panoramë magjepsëse, — i tha atij që i kishte në krah.

— E bukur vërtet, — tha tjetri.

— Do të jetoja me gjithë qejf në këtë vend.

Maria — Luiza vuri buzën në gaz me vetëdijen e femrës që e di mirë çmimin e një buzëqeshjeje.

— Dëshironi të pimë diçka? — tha papritur ajo dhe shtoi: — Ofroj unë.

— Maks, i dashur, ai këndi atje më duket një pikë interesante për të fotografuar.

E shoqja i futi krahun dhe, pa pritur përgjigjen e tij, e tërhoqi me nervozizëm.

— Një lëneshë është si një homoseksual, nuk i humbet shpresat kurrë, — tha ajo me zë të lartë, në mënyrë që ta dëgjonte edhe tjetra.

Maksi, tepër i sjellshëm megjithatë gjeti një grimë kohë sa t'i dhuronte një buzëqeshje Maria-Luizës (si falenderim për ftesën a ndoshta për t'u shfajësuar, këtë askush nuk mund ta saktësonte) dhe burrë e grua u larguan. Një re

e stërmadhe melankonie e mbuloi diellin e ngazëllimit të saj dhe sakaq Maria-Luiza e ndjeu veten të vetmuar më shumë se kurrë.

Hyri në bar. Qëndroi para banakut dhe porositi një aperitiv.

«Aperitivi para drekës është si banja para gjumit.»

Oh, në djall shkofshin këshillat e atij njeriu që edhe nga varri kërkon të urdhërojë, të ketë pushtet mbi mua!

Thirri banakierin dhe e ktheu mbrapsht porosinë. Kërkoi dopio konjak. Pas gotës së dytë njerëzit në bar i shembëllyen me lopë që përtypeshin e ripërtypeshin qetë-qetë. Ndjeu krupë dhe iu përzie.

Iliri nxori nga xhepi i xhakaventos bllokun ku kishte shënuar programin e vizitave dhe oraret e tyre. I hodhi një sy shpejt e shpejt, ndonëse e dinte, përmendësh fjalë për fjalë, gjithë ç'që shkruar në të.

Paradite, vizitë në një kopsht fëmijësh (sipas kërkesës së turistëve a më saktë të plakave të grupit) dhe më pas në Muzeun Arkeologjik.

Pushim i shkurtër.

Ngrënia e drekës në një hotel të plazhit.

Pasdite, shëtitje nëpër qytet dhe, para largimit, ndalesë e shkurtër në rrënojat e amfiteatrit të porsazbuluar.

Koha më e përshtatshme për të kërkuar Jani

Nelkën do të ishte pas drekës, që do të hanin më dymbëdhjetë e gjysmë, kur turistët ende-shin poshtë e përpjetë sikur e bënë enkas për të ndihur tretjen e ushqimit në stomakët e rënduar. Në të vërtetë, ishte i vetmi interval kohe kur mund të bënte pas qejfit ose, siç i pëlqente të thoshte, «i përkiste vetvetes.»

Cigarja që kishte ndezur, nuk e hiqte tymin siç duhej, dhe ai vuri re se karta ishte gërricur në një vend. E flaku dhe ndezi një tjetër, të fundit që kishte pasur paketa.

Pasi kishin mbaruar vizitat e paraditës dhe qenë ulur në restorant për t'u drekosur. Ilirit iu duk sikur koha kishte rrjedhur me një shpejtësi të habitshme, tej ritmit normal. Maria-Luizën nuk ia zunë sytë në asnjërën nga tryezat dhe në njëfarë mënyre kjo e shtiu në merak. Hëngri aq shpejt, madje pa i parë gjellët që i kishin shërbyer, sa, kur u ngrit, pati ndjesinë sikur gjithçka e kishte gëlltitur pa u mblaçitur. Para se të dilte nga restoranti, i pëshpëriti diçka në vesh përgjegjësit të grupit që tundi kokën.

Maria-Luizën e gjeti në bar, vetëm. Mbi tryezë ishin disa gota të zbrazura dhe tavlla cit me bishta cigaresh.

— Një femër e vetmuar dhe alkooli bashkë, a nuk ju ngjan si një skenë adulteri?

Maria-Luiza u ngërdhesh.

— Ju kërkova në restorant...

Iliri tërhoqi karrigen dhe iu ul përballë.

— Do të pini diçka me mua?

— Jo faleminderit, nuk më pihet.

— Ç'hyn në gojë, nuk e ndyn njerinë, ç'del nga goja e ndyn atë, ka thënë zoti ynë Jezu Krisht... Jam e irrituar, mos ma vër re, as vetë nuk e di psenë.

Iliri pandehu që pija do të kish bërë të sajën dhe Maria-Luiza s'do të ishte në gjendje t'i artikulonte fjalët siç duhej, prandaj u befasua kur pa që logjikën e kishte të kthjellët dhe gjuhën brisk.

— Është e kuptueshme, — tha.

— Sesi më ngjan vetja, si një farë kubi që, ngado ta kthesh të shfaq gjithnjë pamje të re; në njërën faqe të tregon një copë budallaçkë, e kthen në faqen tjetër dhe sheh plakën sentimentale, e rrotullon sërish dhe në faqen që ke para të ka shfaqur dashnoren e përvëlur nga pasioni, e rrotullon sërish e sërish dhe spektakli vazhdon, në çdo faqe ke nga një figurinë të ndryshme.

Maria-Luiza heshti me dëshirën që tjetri ta kundërshtonte, por Iliri sikur s'ua kishte vënë fort veshin fjalëve që kish thënë ajo. Xheloze që ai mund të mendonte për ndonjë gjë tjetër në prani të saj, e cyti bisedën në atë drejtim që i interesonte, pa kurrfarë vështirësie.

— Jeni i sigurt, vërtet, që Xhani ndodhet së këtë qytet?

— Pse më pyesni? Apo s'keni më besim në fjalën time?

— Më falni, — Maria-Luiza uli vështrimin.

Befas e ngriti kokën dhe e pyeti; — Më thoni që nuk është ëndërr e gjithë kjo? — Dhe vijoi: — Duhet të më kuptoni, nuk mund ta përfytyroj dot Xhanin në një qytet province, duke u endur midis gërmadhave të një bote të fosilizuar si personazh i ndonjë tragjedie antike, që mbart me vete kushedi se çfarë halli. — Sakaq ia dha së qeshurës dhe veç kur pa që fytyra e Ilirit nuk ndryshoi shprehje, por mbeti e ngurosur nga serioziteti, vuri pëllëmbën e brishtë (Ilirit i shëmbëlleu me një gjethe të fishkur) para gojës së hapur, si të donte të frenonte gurgullimën e gazit. — Ju s'e keni njohur Xhanin, prandaj s'mund të më kuptoni dhe as që jua kërkoj një gjë të tillë, sepse nuk është faji juaj që jeni njeri i rëndomtë. Më falni, nuk dua t'ju fyej, po për krijesa si ai, impulsive, me shpirt praktik e gjithë fantazi, që i përbuzte vjetërsirat, anakronizmin, jeta këtu do të ishte e pahonepsshme dhe e pakonceptueshme. Librat e tij më të preferuar kanë qenë memuarret e Benvenuto Çelinit dhe Xhakomo Kazanovës, ku ai rrëmonte me skrupulozitet, faqe për faqe, dhe bëhej si i lojtur nga kënaqësia që provonte, kur gjente pika takimi me karakteret ose me ndodhi nga jeta e tyre. Si çdo njeri i madh, edhe ai udhëhiqej nga paradoksi: nuk bëj atë që më ofron Fati, por bëj atë që dua unë.

— Më falni, por më duhet të iki, se nuk më premtun koha, — tha Iliri duke u ngritur dhe i çuditur vuri re se si e vërteta mund të shitet edhe si gënjeshtër.

— O zot, askush s'do të më kuptojë! — Maria
— Luiza psherëtiu. — Mos më lini vetëm, ju
lutem, kam frikë.

Tani s'ngjelet gjë tjetër veç të bjerë në gju-
një e përlotur, në mënyrë që kuadri melodra-
matik të bëhet i plotë.

— Jo, — tha Iliri dhe bëri një hap prapa. —
S'ka mundësi. — Është më mirë (për kë? për
mua apo për atë, mendoj në një fragment ko-
he) të prisni këtu. Kini besim tek unë.

U pendua për fjalët e fundit.

Tani do të besojë më pak, i tha vetes.

— Kur nuk ta vë veshin më njeri, atë-
herë s'të mbetet kush tjetër veçse Perëndia; —
tha Maria — Luiza me zë të ulët, sikur të fli-
ste me vete, megjithatë Iliri mundi ta dëgjonte.

Te dera qëndroi dhe u kthye.

— Mos pini më!

Ajo s'denjoy t'i hidhte as një shikim.

— Në djall të shkosh!

Iliri doli nga bari.

Në rrugë ishte një zagushi që të asfiksonte.
Po bëheshin dy muaj që nuk po binte pikë
shiu dhe kjo gjendje veç të tjerash, sipas një
komunikate të Ministrisë së Shëndetësisë, po ndi-
konte negativisht në shëndetin e të gjithë atyre
që vuanin sidomos nga astma dhe nga zemra.
Dielli përcëllonte aq sa Iliri pati ndjesinë si-
kur mbi kokë kishte një lente që e përndiqte

në mënyrë të pamëshirshme ngado që shkonte. Pranë i kaloi një burrë i shkurtër, imcak, tepër i pastër dhe i rregullt.

— Më falni, a e dini ku ndodhet ndërmarrrja komunale?

Burri ndaloi. E panoramoi Ilirin me një shikim të kujdesshëm, që nisi nga këmbët dhe mbaroi te flokët para se t'i shpjegonte pa i shterur durimi, rrugën që duhej të ndiqte. Gjatë kohës që tjetri po fliste Iliri pati përshtypjen sikur çdo fjalë para se t'i dilte nga goja, i aromatizohej me një parfum nga ai më i liri. Ndërkohë iu kujtuan fjalët e shoferit të autobusit kur i thoshte gjithë përçmim për turistët: «Burri duhet të vijë era duhan, raki dhe djersë. Era parfum vijnë gratë dhe ato jo të gjitha, vetëm qejflijet.»

Vendin ku ndodhej ndërmarrrja e gjeti kollaj, krejt ndryshe nga ç'kishin pandehur kur kish dëgjuar shpjegimin e burrecit.

Në anë të portës së madhe prej hekuri, të mbyllur me zinxhir, ishte një deriçkë e çelur përgjysmë. E shtyu dhe ajo u hap, e shoqëruar nga një ciatje veshçjerrëse.

— Ku shkon ti, shoko?

Iliri u kthye andej nga erdhi zëri dhe pa një mesogrua me përparëse të bardhë, nën hijen e çjerrë të një plepi, ulur mbi një arkë që kishte marrë formën e paralelpipedit. Për një çast iu duk sikur zëri s'kishte qenë i gruas, por i shtizave që po kapërtheheshin me njëra-

-tjetrën në duart e saj.. Duke iu hedhur një vështrim shkarazi e me marifet pulpëve të saj si të elefantit dhe belit, në qoftë se mund të quhej ende ashtu ajo masë rrathësh prej dhjami që e bënin të rrumbullakët si vozë, Iliri arriti në përfundimin se ajo duhej të peshonte të paktën 100 kliogramë.

— Mirëdita, — tha Iliri jo pa një farë druajtje para atij mali të mishtë. — Më falni që po ju shqetësoj, desha të pyes për një person... nëse punon në këtë ndërmarrje...

— Si ia thonë emrin? — pyeti gruaja.

— Jani Nelka.

— Uu, qyqja, për Bum Kasollen e ke fjalën? Këtu punon mortjemadhi... Mos je gjë i policisë?

Gruaja picërroi sytë.

— Ûnë? — Iliri buzëqeshi si të donte të zbuste përshtypjen e saj. — Pse, ngjaj si i tillë?

Gruaja uli kokën dhe vijoi punën me shtizat.

— Që thua ti, punon natën si kukudhi. Është me karrocën e plehrave, s'i ndahet shpirti nga ajo. Tani s'ke ku e gjen dambllanë, po shiko këtu, çuno... — gruaja i la në prehër shtizat dhe e pa në sy, — hidhu një vrap te pijetorja, tek ajo që i thonë «Tymi», se mund ta proftasësh atje. Kur ka para, atje e ke, sa bëhet lumë e det dhe katandiset gazi i botës.

— Po shtëpinë ku e ka?

— E kush i vuri dyzet qen nga mbrapa, po

andej nga bregu i lumit sikur thonë, se ç'ka sajuar një kasolle prej qerpiçi.

— Dini gjë a është, i martuar?

Gruaja i hodhi një shikim zhbirues sikur donte të sigurohej më parë në e kishte seriozisht tjetri apo tallej.

— Meazallah, e kush e merr atë palo burrë.

— Ditën e mirë, faleminderit!

— Me nder qofsh!

«Tymi» ishte një birrari e vjetër, ku punën e karrigeve dhe të tryezave e bënë ca fuçi birre të zbrazura. Mbi kokat e klientëve shtrihej një tymtajë e pangjyrë, e cila, me sa dukej, zëvendësonte tavanin dhe jo vetëm që nuk bezdiste kërrkënd, por vetvetiu të krijohej përshtypja sikur pa të, lokali humbiste shumë nga ekzotika dhe kthehej në një vend të rëndomtë, madje të mërzitshëm. Iliri u hodhi një vështrim të gjithëve sa ishin brenda dhe iu afrua banakut. Banakieri po shplante gotat. Gishtat e buhavitur ngjyrë mavi i ngjanin me salsiçe të porsaziera.

— Ç'dëshironi? — pyeti ai.

— Një birrë, — tha Iliri, pa e pasur fare ndër mend.

Teksa po mbushej gota e birrës, banakieri i hodhi një shikim të shpejtë hetues të sapoardhurit. Thjesht shprehi profesionale.

— Doni gjë tjetër? — tha banakieri, tek po i zgjaste krikllën e birrës, me kapuçin e bardhë të shkumës përsipër.

— E njihni Jani Lekën? — Dhe shtoi shpejt e shpejt. — Më thanë që mund ta gjej këtu.

Banakieri ngurroi një hop, para se të përgjigjej. S'po lexonte dot asgjë në fytyrën e atij që kishte përballë. Dhe për këtë gjë, ua ngjiti fajin syzeve. S'i honepste burrat me syze.

— Ja, ai atje është, me kapotën ushtarake...

Iliri ktheu kokën dhe pa andej nga tregonte dora leshtake e banakierit. Në birrari hynë dy policë. Jani brofi në këmbë, nderoi me grusht dhe thirri:

— Rroftë policia popullore!

— Policët blenë cigare dhe dolën pa ia vënë veshin.

— Jani, është hera e fundit që po të them, po ma bën borxh, — iu hakërrye banakieri. — Më duket se të ka marrë malli të thithësh ajër të pastër. — Banakieri u përkul nga Iliri dhe i tha me zë të ulët sikur po i besonte ndonjë të fshehtë. — Po të mos zbrazë ndonjë gotë, s'është në terezi. Kështu bën saherë, vetëm kur lag gurmazin vjen në vete, sikur, thua ti, u bë esëll.

— Mos është i sëmurë që rri ashtu?

Banakieri u zgërdhi.

— S'bie rrufeja në hale.

— Mbush edhe një dopio raki, — tha Iliri, duke parë nga Jani.

— Aha, ka për t'u vardisur keq, se aq do ai, pa për mua bëj si të duash.

Me gotën e rakisë në njërën dorë dhe me krikllën në tjetrën Iliri iu qas fuçisë ku po

rrinte Jani dhe i ndenji përballë. Jani as që mori mundimin t'i hidhte një vështrim duke menduar se do të ishte ndonjë tip që, si zakonisht donte të bënte gallatë me të. Iliri s'po dinte, nga e si ta niste me atë njeri që, rrinte si tutkun.

— Desha që të bisedojmë pak, — tha i sikletosur.

— Jani gjerbi gjysmën e rakisë që mbante gota dhe kërciti gjuhën pas qiellzës.

— Bisedo, — tha, — kush po të pengon.

— Ti je Jani Nelka, apo jo?

— Pse, mos njeh ndonjë tjetër me këtë emër?

— Nuk njoh asnjëri me këtë emër.

— E çë pastaj? — Nga goja i vërshoi një duhmë e qelbur sikur përbrenda atij organizmi po ndodhte një proces i vrullshëm dekompozimi.

— Iliri u zbraps, por vetëm për një çast. Mendimi se neveria për të mund t'i binte në sy dhe e vuvoste përgjithmonë, e shtyu në pozicionin e pakmëparshëm. Por merakun e tij kishte qenë i tepërt. Dukej që atje tutje që Janit s'i bënte përshtypje asgjë.

— Je mirë me shëndet? — e pyeti Iliri, me dëshirën e sigurtë që ta riniste bisedën, këtë herë për së mbari.

Jani ngriti kokën dhe i hodhi një vështrim mosbesues. Sytë i kishte të kuq dhe me sklepa. Jaka e këmishës dhe ajo e kapotës (Iliri s'arriente ta kuptonte se si mund të mbahej ajo

gunë në atë vapë) kishin marrë llustër nga këllira kushedi sa vjeçare. Të njëjtën feksje kishin edhe flokët e tij të zinj, të krehur lart e të lëpirë, që ish-in e vetmja reminishencë me fotografinë që i kishte treguar Maria-Luiza.

— Ç'të hyn ty në xhep? — tha me zë të vrazhdë. — Mos je gjë doktor, zotrote?

Një cërkë pështyme i kërceu nga goja dhe sikur në të të qe koncentruar tërë nervozizmi dhe dyshimi që e kishte kapluar, pejzat e fytyrës iu shtendosën dhe ai u qetua.

— Usta, — i thirri Iliri banakierit, — edhe një dopio.

Janit i xixëlluan bēbēzat e syve sikur diku brenda tij të kishte ndodhur ndonjë qark i shkurtër.

Banakieri e solli nxitimthi gotën e dytë të rakisë dhe u hoq mēnjanë, po nuk u largua, gjoja po mblidhte gotat e pjatat që kishin lënë klientët. Kureshtjendezur, ishte gati të mos u merrte asnjë qindarkë, vetëm e vetëm të merrte vesh se kush qe ai djalosh i veshur mirë dhe ç'punë kishte me një pijanec të degraduar. Ishin dy gjëra, të cilat, sado që mundohej. s'i lidhte që s'i lidhte dot. Sikur t'ia bēnin enkas, ata kishin kyçur gojët dhe rrinin si dy humbamento që s'i bashkonte kurrgjë, përveç tryezës. Banakieri ishte gati të vinte bast se në atë mes do të kishte ndonjë muhabet kontrabande, ndryshe nuk kishte si shpjegohej gjithë ajo fshehtësi dhe sidomos prania e atij tipit që

ia bënte «mu» se nuk ishte nga qyteti i tyre.

Iliri nxori paketën. Ia zgjati Janit, mori edhe për vete.

— Lëre xhentilesën, po fol, si e ke hallin, — i tha Jani vrugtazi. — E di unë, s'i plas bytha kujt të të qerasë kot.

Iliri mbeti i nemitur. Ç'lumpen, mërmëriti nëpër dhëmbë.

— Është një person që interesohet për ty dhe ka dëshirë të takohet, — tha ngadalë, me një neveri të pashprehur, ngaqë atij njeriu nuk i kutërbonte vetëm goja, por i tërë trupi nga ajo erë e padurueshme kalbësire.

— Ej, miko, del gjë? — Befas Jani u shkahtësua dhe i shkeli syrin duke luajtur dy gishtat e dorës së djathtë. Në gishtin e vogël kishte një unazë prej llamarine nga ato që shësin arixhofkat në rrugë për disa qindarka.

— Shoqëria shoqëri, qesja të shkojë e të vijë.

— S'diskutohet, — tha Iliri dhe u sforcua që të nxirrte një buzëqeshje të domosdoshme për të krijuar besim te tjetri. — E mira do të ishte të niseshim menjëherë.

Janin e zbrazti gotën me një të kthyer dhe tha:

— Gati jam!

Iliri u ngrit, pagoi dhe pas ca bashkë me Janin ishte jashtë lokalit. Ecnin pa folur në heshtje si hijet e tyre, të gërmuqura nga zabullima që kishte mbërritur pikun.

— E, Bum Kasollja, pse bën sikur s'na njeh?

— Ke filluar të shoqërohesh me persona të rëndësishëm, ëë?

Iliri ktheu kokën dhe pa një dorë djemsh të ulur te shpinorja e një stoli, që po pinin cigare. Njëri prej tyre kërceu nga stoli dhe thirri:

— Ej, Bumo, tregojë veten që je bankier.

Djali nxori nga xhepi i pantallonave një monedhë dhe e përplasi në trotuar.

— Pesëdhjetë qindarka, — tha Jani, pa e parë monedhën, duke e shquar vetëm nga tringëllima.

Monedha përshkoi një hark dhe i ra para këmbëve. Jani u përkul e mori dhe e rrsi në xhep.

— Po kjo tjetra sa është? — tha djali, duke përplasur një monedhë tjetër.

— Një lek, — tha Jani dhe e priti monedhën që i vërviti tjetri pa e lënë të binte në tokë.

— M'i faroi të gjitha, — tha djali, duke u kthyer nga shokët që po qeshnin. — Ngela pa cigare sot.

— Po e gjete këtë, je më i madhi në botë, pa diskutim, — tha një tjetër dhe, si ua tregoi shokëve monedhën që kishte në dorë, u hodh nga stoli.

Monedha tringëlloi mbyturazi. Jani ndenji një hop pa folur, ndryshe nga herët e tjera, kur përgjigjja e tij kishte qenë e menjëhershme. Asnjëri nga djemtë s'po pipëtinte.

— Po s'qe çerek dollari, të më pështyni në

surrat, — tha Jani dhe u rrotullua për nga djemtë, me pamjen triumfatore të një biznesmeni që sapo ka kryer operacionin më të suksesshëm të jetës së tij në bursë.

Djemtë shpërthyen në brohorima.

— Ti je bos.

— Bum Kasollja.

— Bum Bank and Company.

— Bum Kasollja.

— Ti je garip.

— Bum Kasollja.

— Ti je dora jonë.

— Bum Kasollja.

Iliri e pa me bisht të syrit. Jani krekosej dhe, bënte ç'bënte, u shkelte syrin djemve, ndërsa buzët i qenë çapëlyer nga njëri vesh te tjetri.

— Ky pra, ishte «dashuria e përjetshme» (siç qe shprehur njëherë Maria-Luiza.) Ej, don Jan, i famshmi grabitës zemrash, si je katandësuar kështu.

Iliri ndërtoi me mendje dekorin dhe mizanskenën ku Jani dhe Maria-Luiza takohen në aktin final të dramës së tyre. Të dy janë edhe më të kërrusur e të rrëgjuar nën togat me të cilat janë mbuluar, si dy alkimistë që enden mes mjegullnajës së shumëgjyreshme të avujve që dalin nga poçet dhe epruvetat e laboratorit të tyre dhe orvaten t'i japin formë e frymë një kufome të zhvarrosur që është dekompozuar me kohë.

Ndërkaq, në apoteozën e haresë dhe të ngazëllimit të përgjithshëm, njëri nga djemtë e hipur mbi stol i ktheu prapanicën Janit, lëshoi një pordhë dhe tha:

— Po e gjete, çfarë është?

Shoqëria u gajas.

— Po s'e gjete, ta them unë. Ky është çek që do të të duhet për të paguar udhëtimin, kur të nisësh në botën tjetër.

Jani u tërbua dhe si i dalldisur zuri të kërkonte gurë përtokë. Sakaq djemtë ia kishin mbatthur me vrap.

Iliri iu afrua Janit, e tërhoqi nga krahu dhe i tha me zë të butë:

— Mos harro që po na presin. Kështu po humbasim kohë.

Pothuaj kishin mbërritur, kur Jani ndaloi, pështyu bishtin e cigares dhe tha.

— U lodha, nuk vij më tutje. Ku është ai tipi?

Iliri i zgjati një cigare.

— Mirë, po s'pate fuqi të ecësh, na prit në lulishte. Për dy minuta jemi aty. Do na presësh, ëë?

Jani futi gishtin tregues në hundë sikur po kërkonte aty përgjigjen.

— E ç'punë ka ai me mua? — pyeti papandehur, duke e fshirë gishtin në trungun e pemës ku ishte mbështetur.

Iliri u hutua një çast. T'i tregonte të vërtetën, druhej se Jani mund t'ia mbathte.

— Do të ta thotë vetë, mos ki galje.

— Punë muti, — ia bëri Jani, duke krojtur kokën. — Po pres, s'kam ç'bëj. Kam nevojë për ndonjë lek. Ej, se mos ma dridhni. Prit, mos më ik ashtu si hardhucë, më lër nja dy cigare.

Iliri i vërviti paketën dhe u largua me hapa të shpejtë.

Maria-Luizën e gjeti atje ku e kishte lënë, në bar. Tryeza e saj ishte e pastër sikur sapo të ishte ulur.

— Zonjë...

Maria-Luiza vuri gishtin te buzët dhe tha zëulët:

— Shsh... po meditoj. Më duket se kam bërë një zbulim të njëvlefshëm si në rrafshin spiritual, ashtu edhe gramatikor. Zoti më korrigjofte, në qofsha gabim. Shkencëtarët janë treguar mendjengushtë dhe dritëshkurtër kur e kanë ndarë kohën në të shkuar, të tashme dhe të ardhme. Duke qenë se të treja këto ekzistojnë në shpirtin e njeriut, aty gjendet edhe një e tashme, e cila është e gjithkohshme dhe, duke u bashkuar me to, u jep një përmasë të re, që në të tashmen e së shkuarës është kujtesa, në të tashmen e së tashmes është vizioni dhe në të tashmen e së ardhmes është pritja...

— Zonjë, Xhani po ju pret te lulishtja para hotelit.

Maria-Luiza i hodhi një vështrim të ftohtë,

sikur të qe ndonjë i panjohur që po e bezdi-
ste duke e pyetur për orën.

— Unë kam një jetë të tërë që e pres, kë-
shtu që... le të presë edhe ai ca, se nuk i
bën keq... Kamerier, një uiski, ju lutem.

— Zonjë, ç'keni ndër mend të bëni?

— Ekzorcizëm për nxjerrjen e frymës së ligë.
A e dini se ku qëndron fatkeqësia ime? Me me-
ndje kam qenë shërbëtore e Perëndisë, ndërsa me
trup kam qenë shërbëtore e Mëkatit.

Maria-Luiza e rrëkëlleu njëherësh uiskin, me të
njëjtën vendosmëri e stoicizëm me të cilin Sokra-
ti kishte kthyer kupën me helm dhe, me ca
lëvizje të ngathta sikur çdo pjesë e trupit t'i
që mpirë, krejt si një e sëmurë që pas një
lëngate të tejgjatë për herë të parë mëkëmbet,
edhe ajo u ngrit nga karrigia dhe doli nga ho-
teli, si një somnambul nga dhoma e gjumit.

Atë copë udhë gjer te lulishtja e bënë gojë-
kyçur sikur po merrnin pjesë në ndonjë procesi-
on varrimi.

Vetëm marshi funebër mungon, mendoi
Iliri.

Sido që mendimet gjysmë të paralizuara mezi
çapiteshin me patericat e fjalëve që po thoshte
me vete, Maria-Luiza po provonte të njëjtën
gjë që e kishte ndier edhe ditën kur kishte va-
rrosur burrin e dytë.

O Zot, ju vetë ishit që më sollët kaq pranë
lumturisë, pse largoheni tani dhe më lini fillikat,
kur kam kaq shumë nevojë për ju. Nuk e ndi-

eni se si zemra më është bërë akull dhe nuk rreh më, si një kambanë e plasur? Çfarë po ndodh kështu me mua? Më duket sikur jam verbuar dhe do të rrëzohem. Të betohem, o Jezu Krisht, dhe ty, o Shën Mëri e virgjër, mbi gjithë ç'kam të shtrenjtë, se do të ndërtoj një kishë ku të vijnë e të falen të gjithë shprithumburit, vetëm lutjuni Atit për mua, thojini të më shtrijë dorën e gjithëfuqishme dhe të më ndihmojë t'i bëj edhe këta hapa që më ndajnë nga Xhani im. Ju falem nderit, ja, e shoh, falë jush e shoh se si ka shtrirë krahët drejt meje dhe po pret të më pushtojë... Jam e lumtur, më në fund jam e lumtur, oh, sa e lumtur që jam... Edhe sikur të vdisja, nuk do të më vinte keq, sepse ia arrita asaj që desha, e gjeta shpirtin tim...

— Jani Nelka, zonjë.

Maria-Luiza bëri edhe disa hapa, paskëtaj qëndroi, u rrotullua dhe i hodhi një shikim pyetës Ilirit. As shkarazi nuk ia kishte hedhur sytë vagabondit të ulur në stol. Në të vërtetë, ai dhe gjithë raca e tyre kishin qenë për të gjithmonë objekte që nuk i ngjallnin kërshtëri, aq më pak mëshirë, njëlloj si stoli apo zorra e harruar mbi bar, me të cilën kopshtari ujiste lulet. Jani, tymoste pa e prishur terezinë.

— Ku, ju lutem?

Maria-Luiza hoqi syzet dhe nuk e kuptoi as vetë pse u kthye nga lypsari (kështu e cilësoi herën e dytë) që i kishte ngulur sytë dhe po e këqyrte paturpësisht. Hapi çantën, rrëmoi në të,

nxori një kartëmonedhë dhe ia la në dorë Janit që u zgërdhi.

— Vërtet s'po e njihni? — e pyeti Iliri, me naivitetin e një fëmije.

— Kë? Pse, ky kush është? — tha Maria-Luiza duke e treguar me gisht Janin.

— Ç'është e vërteta, po ta krahasosh me fotografinë, ka ndryshime si nata me ditën, megjithatë, po ta shikosh me vëmendje, do ta zbulosh ngjashmërinë. Mënyra e krehjes së flokëve për shembull...

— Mjaft, — klithi ajo, duke u dridhur e tëra nga ato që Iliri i quajti me vete ethet e tërbimit.

— Mjaft... nuk ju lejoj të talleni me mua. Ky është kulmi i cinizmit, i arrogancës dhe i mungesës së respektit për një zonjë të nderuar. Dhe për këtë do të shpreh indinjatën time pranë firmës turistike.

Fytyra iu mbush me vurrata mavi e të verdha-në-të-gjelbra, sikur një reaksion i menjëherëshëm t'ia kishte ndryshuar formulën e gjakut.

Iliri u habit. Iu afrua Janit dhe, duke mposhtur krupën, e kapi nga jaka e i tha:

— Kur ke qenë në X. ju jeni takuar, fol, mos më rri si mumje? Thuaji zonjës që e njeh, që e ka emrin Maria-Luiza, thuaji. Fol! Fol! Ç'të kujtohet?

Jani Nelka u ngërdhesh si një idiot që s'kupton gjë prej gjëje nga ajo që ndodh rreth e rrotull tij, duke lënë t'i dukeshin dhëmbët (dy poshtë dhe një lart, që për ironi ngjante sikur

sapo i kishte buluar) e shtrembër dhe të kaftë, si hunj të një gardhi që është rrënuar prej kohësh. Papritur u ngrit nga stoli dhe eci në drejtim të Maria-Luizës, që filloi të çapitej mbrapsht me duart të kryqëzuara para gjoksit, sikur ai që po i afrohej të qe vampir dhe ajo shpresonte ta zmbrapste me shenjën e kryqit.

(Më pas Iliri do të betohej që e kishte dëgjuar Janin të belbëzonte në gjuhë të huaj, pa mundur dot ta shquante se çfarë gjuhe kishte qenë.)

— Ndalo! — briti Maria-Luiza dhe në çastin që Jani ngriu në vend fytyrëprishur, ajo u përkul dhe tha zëshuar. — Po më përzihet.

Pas një syshkëmbimi të shpejtë me Janin, çehreja e saj u zbardh. Befas e mbuloi fytyrën me të dy duart, i ktheu atij shpinën dhe u largua nëpër rruginën e shkretë të lulishtes. Pak nga pak silueta e saj u tret prej avujve vibrues që ngriheshin nga asfalti përvëlues. Jani pa nga Iliri, por ai nuk e kishte mendjen, i përpirë nga imazhi dantesk i ferit, që i qe fanitur para syve.

Më pas Iliri nuk do të ishte në gjendje të përcaktonte me saktësi se sa kohë kish ndenjur në atë pozicion.

Pothuaj e kishte harruar praninë e Janit, kur ndjeu një dorë që po e ndukte nga mënga e xhakaventos dhe një fishkëllimë në rrëzë të veshit, të zgjatur e ngulmues, si sirenë e vonuar alarmi.

— Ah, ti qenke?!

— Kësaj i thonë: kalova lumin të dhjefsha kalin. Sikur the që do ta lagnim apo...

Iliri futi dorën në xhep, nxori një kartëmone-dhë dhe, pa e parë, ia la Janit në dorë e iku.

— Ej, fyuu, po pate nevojë tjetër herë për mua, e di vetë ku të më gjesh...

Maria-Luizën nuk e gjeti asgjekundi. I lodhur, i shqetësuar dhe i mërzitur, Iliri hyri në barin e hotelit, porositi një kafe dhe, një çast para se të ulej, u kujtua që kishte mbetur pa cigare: paketën ia kish lënë Janit. Pa pritur që kamerieri t'i sillte paketën, gjerbi kafën e nxehtë që ende nxirrte avull.

— E hidhur si kafe pasvarrimi, — i tha kamerieres.

Maria-Luiza u afrua pa zhurmë dhe u ui përballë tij, duke harruar t'i kërkonte leje, përkundër zakonit të saj.

— Më falni që u solla në atë mënyrë...

Iliri ishte gati të betohej se krijesa që kish pranë, veç prej mishi e kockash që nuk mund të ishte. Dy sumbulla të vetmuara (Ilirit iu dukën si sferat e xhamta të kokërdhokëve, aq të mëdha ishin) u rrokullisën dhe ranë mbi mësallën e bardhë të tryezës. Megjithatë fytyra e saj mbeti çuditërisht e qetë dhe e patrazuar, si e ndonjë kufome, në atë neutralitetin e saj absolut ndaj kësaj bote.

— Ju duhet të më kuptoni dhe të më ndjeni, vetëm nga ju e kërkoj këtë gjë. Nuk më intereson aspak se, ç'mund të mendojnë të tjerët...

(Edhe Xhani yt? — desh tha Iliri, por e përbajti veten.)

— ... As tani nuk jam në gjendje ta shpjegoj atë që ndodhi me mua. Ishte diçka eruptive, diçka afër çmendurisë, diçka që... nuk di se ç'emër t'i vë, në qoftë se i duhet vënë një emër për ta klasifikuar e skeduar edhe atë, si gjithçka tjetër. Kur një njeri të thotë një gjë, ajo akoma nuk mund të quhet e vërtetë, me gjithë pretendimin e tij për ta shitur si të tillë. E vërtetë bëhet vetëm në çastin që hyn te ty dhe zë vend.

— Mund të më thoni se cili është ilaçi më i mirë kundër diarresë? — Iliri foli shqip, me shikimin e fiksuar në bebëzat e syve të saj të ujshëm.

— Më falni...?

— Jo, jo, asgjë.

— E gjithë kjo histori tani po më duket si një ëndërr e ligë, së cilës, ndonëse nuk i beson, prapëseprapë ia ke frikën, si një profecie. Ndoshta gjëja më e mirë është që ta nxjerrësh nga mendja sa më parë. Më thoni, jû lutem, si mund të shfytyrohet njeriu ashtu? Dhe një njeri jo dosido, po Xhani, që njëherë e një kohë, më besoni ose jo, i lejonte vetes luksin t'i ndizte cigaret në qirinjtë e shandanëve të kafeneve, me kartëmonedha. Xhani, motoja e të cilit ishte: «Tallu me botën që të mos tallet ajo me ty.» Kaq shumë i besoja atij njeriu, sa do t'i qeshja para surratit kujtdo që do të vinte të më thoshte

se ai është rrënuar, ka falimentuar ekonomikiisht...

— Ja zonzë, pikërisht këtu ju bëni një lajthitje, le ta quajmë të vockël dhe, për fatin tuaj të keq; vetëm tuajin, nuk po arrini të kuptoni ose nuk doni, megjithëse kjo e dyta ka më pak mundësi, atë që është thelbësore në këtë... si do të preferoni ta quajmë, dramë, tragjedi, romancë; se ai tip ka falimentuar politikisht, më kuptoni po-li-ti-kisht? — tha Iliri me njëfarë pezmi të përmbajtur.

— Pallavra, — tha Maria-Luiza me një grimasë irritimi, që i zhubraviti fytyrën. — A e dini se çfarë më kujton politika? Një cirk ku klounët dhe prestidigjitorët çuditin me truket e tyre mendjet naive e të plogështa, duke i bërë të përjetojnë gojëhapur çaste mrekullish iluzive, në ekstazën e budallallëkut. Por s'kalojnë veçse ca minuta dhe gjithçka zhduket sikur të mos kishte ekzistuar kurrë. Përreth ke vetëm realitetin e shëmtuar dhe një lyshtër bishash njerëzore që shtiren se të duan, por në të vërtetë janë gati nga çasti në çast të të shqyejnë. Mua, për vete, nuk më ka lënë ende mendja që t'u besoj tullumbaceve të bukura shumëgjyreshe, që nxjerrin nga goja politikanët dhe me zemërgjerësi i shpërndajnë falas. Është e vërtetë që ata i hakërrehen shoshoqit në publik, gjoja për të mirën e turmës truatrofizuar që quhet popull. U bënë mijëra vjet që demagogët e mjelin këtë lopë të urtë dhe budallaqe.

Kamerierja iu afrua tryezës së tyre dhe i shërbeu Maria-Luizës kafën, të cilën ajo as që e vuri re.

— Ngandonjëherë rri e mendohem dhe vetja më ngjan si një aktore plakë e harruar, që i ngrys ditët duke kujtuar me nostalgji figurat që ka interpretuar dikur. Por vjen një moment dhe ajo vë re, me një ndjenjë midis çmeritjes dhe llahtarës, se në atë mori personazhesh ajo nuk gjen dot fytyrën, shpirtin e saj (për ekzistencën e të cilit vetëm tani është bërë e ndërgjegjshme) që ua ka huazuar krijesave të huaja dhe pastaj, pak nga pak, diku e ka falur, diku ia kanë vjedhur... Kësisoj edhe ajo vetë është shndërruar në një personazh. Zot, o zot, më trego udhën për të dalë nga kjo skëterrë tokësore dhe për të ardhur te ty, sa pa qenë vonë.

Lëre zotin të qetë në vetminë e tij, plakë e fandaksur, tha Iliri me vete. Mjaft më me këto përçartje.

— Pse tregohem kaq naive? — tha Maria-Luiza, me një zë që sa vinte e shuhej. — Xhani im, ai i vërteti, ka vdekur, ndërsa ky tjetri është një trup pa shpirt, që endet mbi tokë, ashtu siç enden nën tokë shpirta pa trupa.

— Zonjë, — tha Iliri me një ndjenjë të sinqertë keqardhjeje dhe shtriu dorën për ta prekur. — Mjaft më me këto haluçinacione. Hapni sytë dhe kthehuni në realitet. Kështu do të jetë më mirë për ju, më besoni.

— Oh, faleminderit për këshillën! E keni ndje-

njën e mirësisë po në atë dozë që e kishte edhe Don Kishoti...

— Më falni, por kam punë, më duhet të dal.

Iliri u ngrit.

— Pse u fyet?

Maria-Luiza kishte ngelur vërtet e habitur. Iliri nuk i ktheu përgjigje. Vijoi të ecte pa folur. Befas ajo filloi të dëneste pa lot, me gulçe të brendshme, mbyturazi. Iliri kishte mbërritur te dera, kur dënesa e saj u shndërrua në një gaz të shfrenuar. Ai doli jashtë nga bari dhe në korridor mundi të dëgjonte të qeshurën e saj, në mund të quhej e qeshur ajo gurgullimë e ngjirur që i dilte nga fyti. Sakaq një ujëvarë lotësh iu rrëkëllye tëposhtë faqeve dhe ato që nuk i përpinë buzët e thara, pikuan në filxhanin e kafes, së panisur.

— Kam fiks një orë që po vij rrotull, duke ju kërkuar. Më dukej vetja si një fëmijë që ka humbur dhe s'di nga të shkojë.

Turisti qeshi me shakanë që bëri dhe mbe-tti i befasuar, kur pa që përkthyesi nuk reagoi fare.

— Ndonjë problem?

— Tingëllon si fakt paradoksal, sido që është një e vërtetë e pamohueshme.

— S'po ju kuptoj.

— Kam ndër mend të shkruaj një artikull.

Vetëm atëherë Iliri u kujtua që tjetri ishte bashkëpunëtor i gazetës lokale të qytetit të vet dhe që në krye kish shprehur dëshirën të shkruante një reportazh për Shqipërinë.

— Ide interesante.

— Bëra edhe disa fotografi për të ilustruar shkrimin. E di që po flas pak si tepër, por jam i eksituar dhe mezi i sistemoj mendimet. Prandaj ju lutem të më falni.

— Oh, s'ka gjë!

— Gjatë kohës që po shëtisja në qytet, vura re se shumica e atyre që më kalonin pranë, ishin të rinj e të reja, pa përmendur fëmijët. Ndërkohë, duke bërë një përjasje me faktin që përmendët edhe ju në autobus, më lindi ideja e shkrimit. Madje e kam gjetur edhe titullin, që më duket tepër sinjifikativ: «Tokë e lashtë e njerëzve të rinj» Ç'mendim keni?

— Poetik.

— Përveç kësaj, do të përdor si kontrapunkt edhe një fakt tjetër që lidhet me aktualitetin dhe e bën më pikant shkrimin, sipas traditës së kuzhinës ballkanike...

(Ai qeshi.)

— ...Duke iu referuar disa të dhënave të kohëve të fundit, në qoftë se shtimi i popullsisë në vendin tonë do të vazhdojë me ritmin e deritanishëm, atëherë, nga 60 milionë banorë që jemi, pas vitit 2000 do të reduktohem në 12 milionë. Diçka katastrofike dhe antihumane...

— Sigurisht.

— Në konfidencë mund t'ju them se bindjet e mia politike janë të majta, megjithëse nuk bëj pjesë në asnjë parti politike...

— Vajti ora për në amfiteatër, — thirri shoferi nga dritarja e autobusit, duke treguar me gisht orën.

— Trualli ku është ngritur amfiteatri ndodhet në skajin jugperëndimor të qytetit...

Iliri pushoi një hop. Ndërkohë një pjesë e turistëve me aparatet fotografike në duar ishin ngritur nga ndenjëset dhe u qenë afruar dritareve.

— ...Dihet pak a shumë funksioni që kryenin këto objekte social-kulturore të antikitetit. Pavarësisht se romakët mundoheshin t'i përligjnin me motivin patriotik, të mbajtjes gjallë të frymës luftarake të qytetarëve, skenat që shiheshin në to ishin kaq ngjethëse, sa autorë të ndryshëm, si Cicëroni, Seneka, Juvenali i kanë kritikuar si shfaqje të rënies morale dhe shoqërore të Romës së lashtë. Kështu shpjegohet që, me kalimin e kohës, amfiteatrot filluan gradualisht të ndaloheshin dhe vetvetiu, duke dalë jashtë vëmendjes publike, nisën të liheshin pas dore, të rrënoheshin e të ktheheshin në gërmadha...

Autobusi ndaloi. Turistët nguteshin të zbrisnin si një turmë spektatorësh të vonuar, gjithë ankth se mos shfaqja ka filluar.

Iliri i zgjati paketën shoferit dhe të dy nisën të tymosnin në heshtje. Ishte një lëvizje instinktive ai kthim koke për të parë në kishin zbritur të gjithë turistët, prandaj u befasua kur pa Maria-Luizën në ndenjësen e fundit, të vetmuar, në një pozicion që më vonë do ta cilësonte me këto fjalë: «i frikshëm, në atë natyrshmërinë e tij.»

Plaka po flinte me kokën të varur anash. Dikur, në një manastir ku ruheshin punimet e një piktori të famshëm të mesjetës, midis të tjerash, kishte parë edhe një ikonë, ku qe pikturuar fytyra e përvuajtur e një gruaje (kështu e kishte quajtur Shën Mërinë) me një brerore vezulluese. Imazhi që krijonte portreti i Maria-Luizës, në atë pozicion, ishte aq i ngjashëm, sa Iliri ishte gati të betohej se mjeshtri ishte frymëzuar nga e njëjta pamje, po të mos qe thjesht problemi kohë. Mbështeti lehtë pëllëmbën në supin e saj, por në çastin e fundit ndërroi mendje dhe nuk e zgjoi. Maria-Luiza gërhinte, ndërsa një rrëkezë e shndrritshme jarge i varej nga cepi i majtë i buzës dhe kullonte deri te mjekra.

— Plakushe e gjorë, e ç'të duhen ty këto gërmadha të lashtësisë. Ti vetë nuk je gjë tjetër, veçse një relik, si ato. Fli... fli...

Mbi qerpikët e gjatë artificialë të Maria-Luizës prehej një shtresë e zbardhëlleme pluhuri.

— Po ajo? — e pyeti shoferi kur zbritën.

— Po flinte, — tha Iliri.

— S'e kuptoj, — tha shoferi. — Ç'i shtyn të marrin udhët e botës, kur e dinë që i zë gjumi në bythë?•

Përmes portikut të lartë turistët po futeshin në korridoret e amfiteatrit, të nxira nga lagështia, syzhgapërryer jo aq nga errësira sesa prej asaj ndjenje makthi të përzier me kureshtjen për të zhbiruar pllanga gjaku, të mbetura si dëshmi e barbarisë njerëzore apo për të dëgjuar klithmat a grahmat e fundit të ndonjë gladiatori që po jepte shpirt. Por heshtjen e përzishme e prishte vetëm një pikë ujë, që binte diku në thellësitë e errëta të korridoreve të nëndheshme dhe, si një kohëmatës primitiv, u bënte të ditur njerëzve që koha ikën e ikën, pa u ndalur kurrë.

Ora 10.00

— U vonova ca, — tha mjeku ligjor duke hapur derën. Në njërin cep të buzës mbante cigaren e sapondezur. — Telefonova në spital që të nisin autoambulancën për të marrë kufomën. S'besoj të kesh ndonjë kundërshtim...

— Jo, — tha hetuesi.

— Me sa duket, sot mbeta pa biletë në tribunë.

— Shihe në televizor.

— Bah, veç kur të paralizohem. Që nga dita e parë, kur kam filluar ta ndjek futbollin, vetëm një ndeshje më ka shpëtuar pa parë. Do ta dish arsyen? Atë ditë u martova, por, më thënë të drejtën, nuk u bë pengesë dhe aq kjo, sesa një shi i furishëm që përmbyti fushën dhe bëri që të anullohej ndeshja.

— Si thua, ngjitemi?

Mjeku ligjor pohoi me kokë dhe ata dolën nga zyra.

Ëkspertin kriminalist e takuan në korridor.

— Ah, më në fund, — tha ai. — Meqë edhe unë e përfundova ekzaminimin do të ishte e udhës të konkludonim.

U ngjitën me ashensor. Ajri në dhomë ishte i rëndë.

Dritaren mund ta kishin hapur, tha hetuesi me vete, duke rrudhur buzët.

— I thashë profesorit, por nuk ishte i një mendjeje me mua, — tha mjeku, sikur ta kishte pikasur mendimin e tjetrit. — Megjithatë dalëngadalë ke për t'u ambientuar, mos ki merak, apo jo profesor?

Eksperti, që me sa duket nuk i merrte shumë seriozisht spicat e kolegut, u mjaftua me një lëvizje të kokës.

Sytë e turistës ishin ende të hapur dhe shprehnin një shpërfillje të plotë, sikur aq i bënte që po largohej nga kjo botë. Këtë ndjesi sikur e përforconte edhe tualeti që i kishte bërë vdekja. Krahu i djathtë i varej jashtë krevatit dhe pjesa që nga bërryli deri te thonjtë që cakisnin tapetin, ishte mavijosur.

— Shenjat e Rigor Mortis janë padyshim ashtu siç përcaktove ti, — tha eksperti. — Tri orë e pesëmbëdhjetë minuta nga çasti kur dëshmitari ka kumtuar lajmin. Për ta mbështetur këtë, ka disa prima facie të pakundërshtueshme...

— E thashë që në krye, s'luaj asnjë presje nga fjalët e mia, — tha mjeku, pa e fshehur kënaqësinë. — Infarkt i miokardit, këtë s'e luan as topi.

— Ky është edhe mendimi im. Sidoqoftë është autopsia ajo që do ta thotë fjalën e fundit, — tha eksperti, me maturinë e tij të njohur që jo rrallë e interpretonin si pedantizëm.

— Amin, — ia bëri mjeku.

— E deshifrova zhgarravinën e pasqyrës, — tha eksperti, dhe hetuesi e pa për herë të parë atë njeri të buzëqeshte.

— Vërtet? — Mjeku dukej që ishte me të vërtetë i interesuar për fjalët e kolegut. — E çfarë kishte shkruar?

— Të parët do të jenë të fundit dhe të fundit do të jenë të parët.

— E çka dashur të thotë me këtë? — pyeti mjeku ligjor.

— Nuk e di, — tha eksperti. — Mund t'ju them vetëm se janë fjalët e Krishtit, të marrë nga Dhjata e Re.

— Çfarë? Tani po e besoj që plaka me tërë mend paskësh rrjedhur, — tha mjeku ligjor.

— De mortuis nil nisi bonum, — tha hetuesi me të qeshur.

Trumba resh të rimta, të lidhura me shoqen si vagonët e një treni pafundësisht të gjatë, të tërhequra nga lokomotiva-erë po ngutëshin për nga lindja. Mjeku iu afrua dritares.

— Aha, po zuri shiu, e mori djalli ndeshjen, — tha ai.

— Me siguri që poshtë duhet të kenë kohë që po na presin, — tha eksperti.

— Po, kanë ca, — tha hetuesi. — Duhet kryer formalitetet e rastit me përfaqësuesin e ambasadës.

— Natyrisht.

— Po më pihet një kafe e fortë, — tha mjeku.

— Edhe mua — tha eksperti. — Kam dëgjuar që këtu bëjnë kafën më të mirë në Tiranë.

— Kafet do t'i paguaj unë, — tha hetuesi; meqë sot kam pasur punën time të parë të pavarur.

— Aa, urime, urime djalosh, — tha mjeku dhe i ra krahëve.

— Suksese, — tha eksperti dhe i shtrëngoi dorën.

Dhaculyre Dute 12101058

*Teodor Zecëri i
Dequllë
Tutë
veterin Këbunet*

*ujat të mirë
doh me të fal*

Ndërkohë që ata të tre po zbritnin, përmes dyerve të xhamta të hollit panë autoambulancën, para hotelit. Dy infermierë me barrelë hynë në holl, të ndjekur prej vështrimeve të një turme kureshtarësh e punëkotësh, që ishin grumbulluar rreth e qark makinës.

Pika të mëdha shiu ranë mbi asfalt dhe pëllcitën si qelqe. Qielli shungulloi nga bubullimat, që në mënyrë të pabesueshme ngjanë me

K&A
K&A

oshëtimën e largët, të mbytur, të topave, në një ceremoni funebre, që shoqërojnë zbritjen e arkivolit në varr.

— Po varroset vjeshta e këtij viti — tha huetesi dhe rrufiti lëngun e zi të kafesë që kishte filluar të ftohej.

1989

Fizik
Mut
Biology
Eng
Russisht